



Mbrojtja

Viti i 90-të i botimit
Tetor 2022 / Nr. 10

**NËNSHKRUHET KONTRATA
PËR SHËRBIMIN SATELITOR**



**Kryeministri
Rama: Do të
kemi një
kryeinspektorat
në qiell, i cili
nuk ka emër të
përveçëm, por
ka një sy që i
sheh të gjitha**



**Peleshi: Hymë në
një epokë të re**

Përmbajtja

Numri 10

FORCA AJRORE

- 10** Peleshi: Jemi drejt konsolidimit të një flote të vërtetë ajrore me helikopterët më të mirë në botë. Faleminderit partnerit strategjik, SHBA!

KONFERENCA

- 12** Gjeneral brigade Arben Kingji: Do vazhdojmë të mbështesim politikën e "dyerve të hapura" për të gjithë rajonin, për të forcuar më tej marrëdhëniet dhe bashkëpunimin midis vendeve të A-5

FLOTA

- 12** Historia 64 - vjeçare e nëndetëseve shqiptare

LEGJENDA E RINGUT

- 20** Ali Kastrati, sportisti universal, krenari kombëtare

NËNË TEREZA

- 28** Gruaja e jashtëzakonshme, shenjtorja e të varfërve të të gjithë botës, e cila kurrë nuk e harroi origjinën e saj

STAFI

ANJEZA MUSOLLARI
Shefe e Sektorit të Botimeve
& Kryeredaktore

Gazetarë:
Mimoza GOLIKJA

Graphic Designer:
Afërdita HYSAJ

Redaktore / korrektore:
Suela HODA



4 Nënshkruhet kontrata për shërbimin satelitor

Kryeministri Rama: Do të kemi një kryeinspektorat në qiell, i cili nuk ka emër të përcjellur, por ka një sy që i sheh të gjitha

Nënshkruhet kontrata e shërbimit satelitor në fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë për monitorimin me teknologji të avancuar të territorit të Republikës së Shqipërisë...



6 CEREMONIA

57 - vjetori i krijimit të Batalionit të Mbështetjes

Batalioni i Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura ka festuar 57 - vjetorin e krijimit të tij. Me këtë rast, në mjediset...



8 EKIPI I NATO-S NË SHQIPËRI

Ministri Peleshi: Duke qenë një prej aleatëve të NATO-s na bën të jemi të sigurt, por njëkohësisht duhet vigjilencë nga të gjitha institucionet

Një ekip i NATO-s ka mbërritur në Shqipëri, për të asistuar qeverinë në nivel politik dhe teknik pas sulmeve kibernetike. Vizita vjen pas komunikimit të kryeministrit Edi Rama me...



20 Intervistë me Prof. Asoc. Dr. Sybi Musollari

Spitali Ushtarak, institucioni me histori të lavdishme 93-vjeçare

Spitali Ushtarak mbetet referenca e vetme e mjekësisë ushtarake në Forcat e Armatosura (FA). Në memorien e brezave të ushtarakëve...

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

Mbrojtja



Botues:

Qendra e Kulturës, Medias,
Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut
Drejtoria e Kulturës, Medias dhe
Botimeve të Mbrojtjes

Adresa:

Rruga e Dibrës/ Garnizoni "Skënderbej"

REVISTA MBROJTJA

Organ Qendror
i Ministrisë së Mbrojtjes
Viti i 90-të i botimit
Nr. 10/ 2022

© Ministria e Mbrojtjes

Materialet e publikuara në këtë
revistë nuk mund të riprodhohen
elektronikisht apo fizikisht e të
përdoren për qëllime përfitimi, pa
marrë autorizim nga botuesit e saj.

**Revista mund të gjendet në formatin
elektronik (pdf) në adresën:**

[http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/
publikime/revista-mbrojtja](http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/revista-mbrojtja)





NËNSHKRUHET KONTRATA PËR SHËRBIMIN SATELITOR PELESHI: HYMË NË NJË EPOKË TË RE

Kryeministri Rama: Do të kemi një kryeinspektorat në qiell, i cili nuk ka emër të përveçëm, por ka një sy që i sheh të gjitha

Nënshkruhet kontrata e shërbimit satelitor në fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë për monitorimin me teknologji të avancuar të territorit të Republikës së Shqipërisë ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe Operatorit "Satellogic USA Inc." me vlerë 6 milion dollarë.

Në prezantimin e këtij shërbimi të ri, që do të marrin institucionet shqiptare, ministri i Mbrojtjes

Niko Peleshi tha se, kjo kontratë përfaqëson një kapërcim teknologjik për Shqipërinë dhe për institucionet tona.

"Kjo kontratë ka vlerën 6 milionë dollarë. Kjo kontratë konsiston në përdorimin ekskluziv të 2 satelitëve, për një periudhë 3 - vjeçare, për monitorimin e territorit të Republikës së Shqipërisë, zhvillimin e kapaciteteve teknike e profesionale të Republikës së Shqipërisë për përdorimin e shërbimit satelitor, përpunimin e Informacionit Gjeohapësinor si dhe

ofrimin e produkteve të imazherisë dhe komponentëve të tjerë të saj. Shqipëria do të ketë akses prioritar në dy nga satelitët që pritet t'i bashkohen flotës së "Satellogic" në lëshimin e saj të ardhshëm satelitor me 'SpaceX', i cili do të quhet 'Albania-1' dhe 'Albania-2', - sqaroi ministri Peleshi.

Ministri shpjegoi me detaje shërbimet që do të marrin institucionet shtetërore shqiptare. "Së pari Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile do të marrë informacion

mbi rrëshqitjet e tokës, lëvizjen e strukturave të rëndësisë së veçantë si: diga, ura, nivelin e ujit në liqene, basene, lumenj, numrin e godinave të shembura, sipërfaqen e zonave të përmbytura, sipërfaqen e zonave të djegura, densitetin e popullsisë, rrugët e bllokuara, sipërfaqet e mbuluara nga bora, trashësia e borës. Do të marrë informacion mbi peshkimin detar, kontrollin e ujërave, ku në raste që konstatohen shkelje të kërkesave ligjore do të marrë masa administrative nga Sektori i Inspektimit dhe Kontrolli i Peshkimit. Do të monitorohet rrjeti i kanaleve ujëtare, kulluese, kanalet e ujërave specifikisht në situata me reshje intensive, në mënyrë që të analizohet sipërfaqja e prekur në tokat bujqësore apo në zonat e banuara”, - u shpreh ministri i Mbrojtjes. Sipas tij, në fushën e turizmit do të shërbejë edhe duke dhënë informacion për cilësinë e ujërave bregdetare me synim promovimin e zonës bregdetare, si dhe erozionin bregdetar në funksion të mbrojtjes së zonës bregdetare dhe inventarizimin e saj.

Ai shtoi se, shërbimi satelitor do të ketë përdorim të gjerë në fushën ushtarake. “Këtë vit, ne përdorim dronët “Puma” për kontrollin e zjarreve dhe pamë një ndryshim shumë të madh, por sa i përket menaxhimit të situatave të tilla, kursim dhe eficiencë të burimeve financiare për shkak se deri dje na duhej helikopteri për të bërë fotografime e sipërfaqeve me zjarre, që kushtonte, dhe me dronët “Puma” ishte minimal”, - theksoi ministri.

“Një bazë të dhënash është një pasuri e madhe sepse duke instaluar aty inteligjencën artificiale dalin informacione që mund të na ndihmojnë në vendimmarrjen në të ardhme. Nuk e fillojmë nga zero, duhet thënë se është bërë një punë shumë e madhe në kuadrin institucional, ligjor”, - u shpreh ministri. Kryeministri

Rama, i pranishëm në nënshkrimin e kontratës deklaroi se: “Me lëshimin e këtyre satelitëve, ne hyjmë në një epokë tjetër në funksion të zbatimit të ligjit, në funksion të luftës kundër korrupsionit, në funksion të forcimit të shtetit dhe në funksion të barazisë përpara ligjit, por edhe në funksion të së drejtës së barabartë për të përfituar nga gjithë mbështetja shtetërore. Për të gjitha ata që na kanë përqeshur, janë skërmitur për satelitët, sot lajmi është që ne do të kemi një kryeinspektorat në qiell, i cili nuk ka emër të përveçëm, i cili nuk ka kushërinj, i cili nuk ka parti dhe i cili ka një sy që i sheh të gjitha dhe një detaj, që ministri, në gjithë renditjen e gjatë të gjërave që do të bëjë ky kryeinspektorat, nuk e solli në vëmendje është që me satelitët

nuk do të ketë më mundësi të ndërtohen kate pa leje pa u vënë re në momentin kur sapo nisin, sepse satelitët kanë kapacitetin të shohin çdo volum të ngritur mbi sipërfaqen e tokës me një saktësi që mblidhet në një perimetër prej 70 centimetrash”, - deklaroi kryeministri Edi Rama. Me anë të këtij shërbimi edhe Policia e Shtetit do të ketë të mundur marrjen e informacionit për kultivimin e bimëve narkotike, shfrytëzimin apo prerjen e paligjshme të pyjeve, gjuetinë e paligjshme, shkatërrimin e shtratit të lumenjve, shfrytëzimet e paligjshme të burimeve natyrore në zonat e mbrojtura, kalimin e paligjshëm në pikat kufitare, informacione të cilat do të mundësojnë evidentimin në kohë të akteve kriminale.

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile do të marrë informacion mbi rrëshqitjet e tokës, lëvizjen e strukturave të rëndësisë së veçantë si: diga, ura, nivelin e ujit në liqene, basene, lumenj, numrin e godinave të shembura, sipërfaqen e zonave të përmbytura, sipërfaqen e zonave të djegura, densitetin e popullsisë, rrugët e bllokuara, sipërfaqet e mbuluara nga bora, trashësia e borës.





57 - vjetori i krijimit të Batalionit të Mbështetjes

Batalioni i Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura ka festuar 57 - vjetorin e krijimit të tij. Me këtë rast, në mjediset e këtij reparti u zhvillua një ceremoni ku ishin të pranishëm: ministri i Mbrojtjes, z. Niko Peleshi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së gjeneral brigade Arben Kingji, gjeneralë dhe komandantë të njësive dhe reparteve, ish-drejtuës dhe komandantë që kanë shërbyer ndër vite në këtë batalion.

Komandanti i batalionit, kolonel Ardian Lulaj, në fjalën e tij të hapjes, pasi falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen, solli një historik të shkurtër të këtij reparti ushtarak, që nga krijimi deri në ditët e sotme. Batalioni i Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm është një ndër repartet elitë të Forcave të Armatosura dhe përmban në vetvete kontributin e vyer të shumë e shumë brezave të oficerëve/nënoficerëve, ushtarëve e punonjësve civil ndër vite.

Ky repart i ka fillimet e tij në vitin 1955 në nivel kompanie dhe data 24 shtator 1965 shënoi krijimin e Batalionit të Sigurimit të Shtabit të Përgjithshëm. Në vitin 2003 u quajt "Batalioni i Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm", emërtim të cilin e mban dhe sot. Kjo strukturë, edhe pse ka emrin batalion, jo vetëm realizon ruajtjen dhe sigurinë e MM/SHPFA dhe strukturave të tjera që ndodhen në "Garnizonin Skënderbej", por kryen mbështetjen me shërbime, me transport dhe mbështetjen shëndetësore, gjithashtu krijon kushte për akomodim nëpërmjet shtëpive të pushimit të ushtarakëve.

Në fjalën e tij përshëndetëse ministri i Mbrojtjes, z. Niko Peleshi, drejtuar efektivit të këtij reparti, theksoi se 57 - vjetori i krijimit të Batalionit të Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm është një ditë e rëndësishme



për të gjithë ne, ndërsa ka vlerësuar punën dhe arritjet e shënuara prej tyre ndër vite. "Prapa çdo aktiviteti, operacioni, misioni, është puna juaj, e ushtarakëve dhe civilëve, pasi ju jeni pjesë e imazhit të FA-ve, madje pjesë e imazhit të Republikës së Shqipërisë, përmes strukturave si Orkestra Frymore dhe Truproja e Nderit", - tha ndër të tjera Ministri Peleshi.

Në fund të fjalës së tij ministri i Mbrojtjes, ka siguruar edhe njëherë mbështetjen e tij për këtë repart shumë të rëndësishëm të Forcave tona të Armatosura.

Pas përfundimit të fjalëve përshëndetëse në mjediset e batalionit u luajt një pjesë muzikore nga struktura më e re "Orkestra Simfonike", që është bërë pjesë e batalionit së fundmi, e cila do të performojë për publikun e gjerë së shpejti dhe do të afrojë më shumë të rinjtë drejt familjes së madhe të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Batalioni i Mbështetjes do të vazhdojë të demonstrojë shembullin më të mirë në dy shtyllat kryesore të vlerave, atë të qytetarit të klasit të parë dhe profesionistit dinjitoz në përmbushjen e detyrave dhe misionit.

TURQIA DHURON 40 AUTOMJETE PËR USHTRINË SHQIPTARE

Peleshi: Kjo ndihmë, kontribut për modernizimin e FA-ve dhe simbol i marrëdhënieve të shkëlqyera të historisë sonë moderne

40 automjete (Fiat EGEA) dhe autobusë u janë dhuruar Forcave të Armatosura të Shqipërisë nga Turqia. Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, i pranishëm në ceremoninë e dhurimit shprehu falënderimet në emër të qeverisë shqiptare ndaj palës turke për mbështetjen e vazhdueshme që u ka dhënë Forcave të

Armatosura për modernizimin e tyre dhe rritjen e kapaciteteve operacionale.

“Kjo ndihmë është shumë më tepër se një kontribut për modernizimin dhe rritjen e Forcave të Armatosura shqiptare, lëvizshmërinë dhe aftësitë operacionale. Është një simbol i një marrëdhënieje të vazhdueshme themeli të nxitur gjatë viteve të historisë sonë moderne. Dhe në ditët e sotme, trupat tona punojnë së bashku, stërviten dhe edukohen së bashku”, - u shpreh gjatë fjalës së tij ministri Peleshi.

Ai përmendi faktin se një numër i lartë studentësh shqiptarë janë diplomuar në akademitë ushtarake turke, duke e cilësuar këtë një shtyllë të fortë të bashkëpunimit mes dy vendeve që prej vitit 1992. Po ashtu ministri i Mbrojtjes vlerësoi ndihmën e dhënë edhe për emergjencat civile, kryesisht nëpërmjet marrëveshjeve financiare dhe granteve ushtarake, duke përmendur këtu nënshkrimin e dy marrëveshjeve të bashkëpunimit financiar ushtarak mes dy ministrive të mbrojtjeve të dy vendeve. Duke folur për sfidat e sigurisë veçanërisht pas nisjes së agresionit rus në Ukrainë, që prej 24 shkurtit të këtij viti, ministri Peleshi tha se: “Ne kemi qenë kudo ku ishte NATO dhe jemi



të pranishëm sa herë që NATO është. Ne jemi krenarë që ndajmë barrën tonë në Aleancë. Është një sfidë për secilin prej nesh që të përballemi me një mjedis të tensionuar dhe të rrezikshëm sigurie. Përgatitja e modernizimit dhe zhvillimit të aftësisë dhe kapaciteteve ushtarake duhet të jetë në fokusin tonë. Dhe mbështetja e aleatëve dhe partnerëve tanë të NATO-s është e pazëvendësueshme në këtë drejtim”.

Nga ana e tij ambasadori i Turqisë në Tiranë, Tyyar Kağan Atay tha se kjo ndihmë është një manifestim i qartë i marrëdhënieve

vëllazërore mes Turqisë dhe Shqipërisë: “Ne e shikojmë Shqipërinë si një vend kyç për stabilitetin e sigurinë e Ballkanit dhe Europës. Ne kemi mbështetur përpjekjet e Shqipërisë në rrugën e integritimit në BE dhe dëshirojmë sinqerisht ta shohim atë si një anëtare të re të Unionit në përfundim të procesit”. Në ceremoninë e dhurimit të automjeteve morën pjesë edhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA-së gjeneral brigade Arben Kingji, atashu ushtarak pranë ambasadës turke, Muhammed Kelami Kablay si dhe përfaqësues të tjerë të FA-së.

Ekipi i NATO-s në Shqipëri, asistencë mbi sulmet kibernetike

Ministri Peleshi: Duke qenë një prej aleatëve të NATO-s na bën të jemi të sigurt, por njëkohësisht duhet vigjilencë nga të gjitha institucionet

“Aktualisht, pas afro 5 javësh punë intensive, është bërë i mundur rikthimi i sistemeve dhe platformave të ndryshme në shërbim të qytetarëve të vendit tonë”, - sqaroi ministri i Mbrojtjes.

Një ekip i NATO-s ka mbërritur në Shqipëri, për të asistuar qeverinë në nivel politik dhe teknik pas sulmeve kibernetike. Vizita vjen pas komunikimit të kryeministrit Edi Rama me Sekretarin e Përgjithshëm të Aleancës, z. Jens Stoltenberg.

Delegacioni i kryesuar nga Zëvendës Ndihmës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, për Sfidat e Reja të Sigurisë, z. James Appathurai, u takua fillimisht me ministrin e Mbrojtjes Niko Peleshi.

Gjatë konferencës së përbashkët, ministri Niko Peleshi sqaroi qëllimin e vizitës së ekipit të Aleancës në vendin tonë: “Ky ekip vjen në vendin tonë për të dhënë asistencë në lidhje me çështjet kibernetike, njohje me situatën aktuale si dhe nevojat dhe mundësitë për adresimin e këtyre çështjeve në vazhdim. Pas sulmeve kibernetike ndaj sistemeve dhe infrastrukturës

së teknologjive të informacionit të shtetit shqiptar, tashmë të identifikuara për nga origjina, i menjëhershëm ka qenë reagimi dhe përgjigja e strukturave të specializuara të vendit në bashkëpunim të ngushtë me vendet aleate. Këto sulme kishin për qëllim shkatërrimin e plotë të sistemeve dhe platformave të shërbimeve shtetërore, por nuk arritën qëllimin e fshirjes dhe shkatërrimit të të gjithë sistemeve tona të teknologjive të informacionit. Qeveria shqiptare reagoi menjëherë, pasi siguroi prova të pakundërshtueshme për origjinën e sulmit, duke ndërprerë menjëherë marrëdhëniet me Iranin. Aleatët tanë dënuan ashpër sulmet dhe dolën krah Shqipërisë nëpërmjet deklaratave të ndryshme, apo dhe me afrimin e asistencës së specializuar në fushën kibernetike”. “Aktualisht, pas afro 5 javësh punë intensive, është bërë i mundur rikthimi i sistemeve dhe platformave të ndryshme në shërbim të qytetarëve të vendit tonë”, - sqaroi ministri i Mbrojtjes.

Sipas ministrit Peleshi: “këto sulme kanë treguar se nuk mund të jemi të mbrojtur në mënyrë permanente, por duhet të jemi vigjilentë dhe të aftë të mbrojmë infrastrukturën dhe teknologjitë e informacionit të vendit tonë, duke investuar më shumë në drejtim të luftës kibernetike. Investime të shumta janë bërë këto vite, por kjo është një luftë e re që ka marrë tjetër intensitet edhe pas agresionit rus në Ukrainë, që ka prishur ekuilibrat gjeopolitikë dhe ka ndryshuar skemën e sigurisë”.





nivel teknik nga vende të ndryshme të NATO-s, por edhe në nivelin individual nga struktura të ndryshme. Unë dhe ekipi im kemi ardhur këtu për disa arsye të ndryshme, por fillimisht arsyeja kryesore është për të parë situatën dhe për të bërë një koordinim të aleatëve dhe zyrave qendrore të NATO-s në lidhje me sulmin kibernetik që ka ndodhur, për të parë nevojat afatgjata që i nevojiten Shqipërisë, për të ndërtuar një rrjet mbrojtjeje ndaj këtyre sulmeve kibernetike dhe Shqipëria po bën hapa përpara në këtë fushë", - u shpreh z. Appathurai, duke theksuar edhe një herë për mbrojtjen e Aleancës në këtë betejë.

Ekipi i NATO-s do të takohet edhe me përfaqësues të Ministrisë së Jashtme, Ministrisë së Brendshme, si dhe me përfaqësues të AKSHI-t.

Ministri garanoi se sistemet e sigurisë dhe mbrojtjes në Ministrinë e Mbrojtjes kanë qenë të paprekura nga sulmi, sepse janë të shkëputura nga rrjeti i përgjithshëm i komunikimit, por pavarësisht kësaj është rritur gatishmëria dhe niveli i vëmendjes dhe sigurisë për të gjitha këto sisteme.

Ministri Peleshi falënderoi edhe aleatët për qëndrimin e mbajtur menjëherë pas sulmeve, duke ofruar asistencën e tyre për të penguar sulmet kibernetike në të ardhmen: "Vizita e ekipit të sotëm është një dëshmi solidariteti e mbështetjes, e reagimit të menjëhershëm të Aleancës ku ne bëjmë pjesë, NATO-s. Duke qenë një prej aleatëve të NATO-s na bën të jemi të sigurt, por natyrisht duhet më shumë vigjilencë nga të gjitha institucionet", - u shpreh ministri Peleshi.

Ndërsa Zëvendës Ndhmës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, për Sfidat e Reja të Sigurisë, z. James Appathurai, u shpreh se në këtë rrugëtim Shqipëria nuk është e vetme, sepse NATO e mbështet: "Të gjitha vendet e NATO-s e njohin sulmin që i është bërë Shqipërisë dhe sigurisht e mbështesin atë në këtë drejtim. Ky është dhe mesazhi që sekretari i Përgjithshëm i dha kryeministrit Rama në takimin e kaluar. Sigurisht doja të theksoja dhe përpjekjet e shumta që ka bërë shteti shqiptar duke nisur nga

qeveria deri poshtë te niveli i ulët për të përballuar këto sulme që janë bërë. Sigurisht ndihma ka ardhur nga NATO, ka ardhur në

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi merr pjesë në takimin e pestë të Grupit të Kontaktit për Ukrainën

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, i shoqëruar edhe nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Arben Kingji, morën pjesë në takimin e Grupit të Kontaktit të Mbrojtjes për Ukrainën, me ftesë të sekretarit të Departamentit të Mbrojtjes SHBA-ve, z. Lloyd Austin dhe shefit të Shtabit të Bashkuar të SHBA-ve, gjeneral Mark Milley.

Në takimin e pestë, që u mbajt në Bazën Ajrore amerikane në Ramstein, Gjermani, morën pjesë ministri dhe shefa të shtabeve nga mbi 50 vende të botës, përfshi edhe Ukrainën.

Vendet pjesëmarrëse konfirmuan unitetin dhe zotimin në mbështetje të Ukrainës, përballë agresionit rus. Shqipëria nga ana tjetër rikonfirmoi gatishmërinë e saj për të ofruar mbështetjen dhe ndihmën brenda kapaciteteve të saj, për të zbutur pasojat që rrjedhin nga lufta në Ukrainë.





11 pilotë të rinj i shtohen Forcës Ajrore

Peleshi: Jemi drejt konsolidimit të një flote të vërtetë ajrore me helikopterët më të mirë në botë. Faleminderit partnerit strategjik, SHBA!

11 pilotë të rinj do t'i shtohen Forcës Ajrore, pas përfundimit të kursit bazë të oficerit "Pilot ushtarak helikopteri". I pranishëm në ceremoninë e diplomimit, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi deklaroi se kjo është një dëshmi e rritjes dhe fuqizimit të Forcës tonë Ajrore pjesë e FA-së të

Republikës së Shqipërisë.

"Kemi sfida të mëdha përpara, veçanërisht në FA, si në drejtim të infrastrukturës, por dhe rritjes së kapaciteteve njerëzore. FA është duke realizuar disa projekte historike. Baza e parë taktike ajrore e NATO-s, Baza e Kuçovës është tani në ndërtim e sipër dhe ky është një zhvillim historik. Në komponentin e

pasurimit të teknikës ajrore, përsëri jemi në momente historike, sepse duke filluar nga viti që vjen ne do të nisim ndërtimin e flotës ajrore me helikopterët Black Hawk. Dy helikopterët e parë do të vijnë vitin që vjen dhe, më pas ky numër do të shtohet, drejt konsolidimit dhe krijimit të një flote të vërtetë ajrore me helikopterët më të mirë në botë. Ky është



një bashkëpunim i suksesshëm me partnerin tonë më strategjik dhe special, SHBA-të, dhe gjej rastin t'i falënderoj", - u shpreh ministri Peleshi, gjatë fjalës së tij.

Gjithashtu ministri i Mbrojtjes tha se, disa pilotë janë trajnuar tashmë në SHBA për helikopterët Black Hawk, trajnim të cilin do ta kryejnë edhe trupa e pilotëve të sapo diplomuar.

Z. Peleshi shprehu falënderimet për vendet aleate të NATO-s që kanë kontribuar në rritjen e FA-së. "Ne jemi pjesë e së tërës, jemi pjesë e një aleance të fuqishme, e cila sot ka shumë sfida të shtuara për sa i përket skenës dhe sigurisë së mbrojtjes, që kanë ndryshuar pas pushtimit dhe agresionit rus në Ukrainë. Kemi shumë detyra dhe objektiva përpara, ndaj unë uroj suksese të përbashkëta edhe arritje

sa më të mira në këto sfida, ju uroj punë të mbarë dhe gjithë të mirat në karrierën që ju pret", - u shpreh ministri.

Mes pilotëve të rinj janë 10 djem dhe një vajzë, Armela Murati.

Në ceremoninë e diplomimit

morën pjesë edhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneral brigade Arben Kingji, komandanti i Forcës Ajrore gjeneral brigade Ylli Pulaj, atashë të vendeve aleate dhe partnere të NATO-s si dhe ushtarakë të FA-së.

Gjeneral brigade Arben Kingji mori pjesë në Konferencën e 25-të të Shefave të Shtabit të vendeve të Kartës së Adriatikut

Gjeneral brigade Arben Kingji: Do vazhdojmë të mbështesim politikën e “dyerve të hapura” për të gjithë rajonin, për të forcuar më tej marrëdhëniet dhe bashkëpunimin midis vendeve të A-5

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Arben Kingji, mori pjesë në Konferencën e 25-të të Shefave të Shtabit të vendeve të Kartës së Adriatikut (A-5, US - Adriatic Charter), e cila u zhvillua më 21-23 shtator, në Budva, Mal i Zi.

Konferenca u drejtua nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Malit të Zi, gjeneral brigade Zoran Lazarevic, si dhe me pjesëmarrjen e komandantit të Komandës Amerikane në Europë (US EUCOM), gjeneral Christopher Cavoli, kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s admiral Rob Bauer, si dhe drejtuesit e Gardave Kombëtare të SHBA-ve. Fillimin e punimeve të konferencës e përshëndeti presidenti malazez z. Milo Gjukanoviq.

Tema e këtij takimi ishte “Sfidat e sigurisë në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe zhvillimi i kapaciteteve të përbashkëta të FA- e të vendeve të A-5 për t’iu përgjigjur këtyre sfidave”. Shefat e shtabeve shkëmbyen mendime mbi situatën aktuale të sigurisë dhe sfidat që përballet rajoni, duke riafirmuar angazhimin dhe përpjekjet e përbashkëta për një rajon të qëndrueshëm dhe të sigurt. U diskutuan gjithashtu bashkëpunimi i deritanishëm dhe ai i ardhshëm për vendet e A-5, me theks të veçantë në disa fusha, kryesisht kontributin në forcimin e sigurisë rajonale, si dhe iniciimin e projekteve të përbashkëta.

Gjatë fjalës së tij gjeneral brigade Kingji, theksoi se: “Rajoni i Ballkanit vijon të përballet me një sërë kërcënimesh dhe sfidash, si politike, ekonomike, ushtarake apo edhe me sulmet e rënda kibernetike të ndo-dhura së fundmi. Të gjitha këto janë një kërcënim potencial për



rajonin tonë. Pranimi i anëtarëve të rinj në A-5, posaçërisht i Kosovës, është një vendim i duhur dhe ne të gjithë duhet të vazhdojmë të mbështesim “Politikën e dyerve të hapura” për të gjithë rajonin, për të forcuar më tej marrëdhëniet dhe bashkëpunimin midis vendeve të A-5”. Njëherazi, gjeneral brigade Kingji theksoi mbështetjen e fuqishme të SHBA-së për A-5, duke shprehur falënderim për angazhimin e vazhdueshëm në ruajtjen e stabilitetit rajonal dhe perspektivës euroatlantike të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Gjeneral brigade Kingji zhvilloi takim me gjeneral Cavolin, ku u diskutua për situatën e sigurisë në rajon, projektet e modernizimit të FA-së, trajnimet dhe stërvitjet, infrastruktura ushtarake më veçanërisht mbi Bazën detare në Pashaliman dhe Porto Palermo, transformimi i edukimit ushtarak në FA, si dhe vlerësimi dhe mbështetja

e SHBA-ve për Forcat e Armatosura shqiptare nëpërmjet financimi dhe trajnimeve të përbashkëta.

Ndërkohë takime të tjera u zhvilluan edhe me komandanten e Gardës Kombëtare të New Jersey-it, gjeneral brigade Lisa Hou, si dhe Komandantin e FSK-së, gjenerallejtënant Bashkim Jashari. Konferenca e 25-të e A-5 përfundoi me firmosjen e Deklaratës së Përbashkët. Shtetet anëtare riafirmuan përkushtimin e tyre ndaj parimeve të kësaj marrëveshjeje, mbështetur në Konceptin e Rivitalizimit të kësaj Karte. Vendet anëtare të nismës A-5 janë Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Kroacia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe SHBA-të, ndërsa vende vëzhguese Kosova, Sllovenia dhe Serbia. Marrëveshja për formimin e nismës SHBA-Karta e Adriatikut u nënshkrua në vitin 2003, me qëllim që të promovonte dhe fuqizonte bashkëpunimin rajonal dhe sigurinë.



Gjeneral brigade Arben Kingji merr pjesë në takimin e Komitetit Ushtarak të NATO-s

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Arben Kingji mori pjesë në takimin e Komitetit Ushtarak të NATO-s, që u zhvillua në Talin, Estoni.

Konferenca u drejtua nga kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s, Admirali Rob Bauer.

Në këtë takim, krahas shefave të Mbrojtjes të vendeve anëtare të NATO-s, merrnin pjesë edhe Komandanti i Komandës Supreme Aleate për Europën (SACEUR), gjeneral Christopher G. Cavoli dhe Komandanti i Komandës Supreme Aleate për Transformim (SACT), gjeneral Philippe Lavigne.

Gjatë Konferencës së Komitetit Ushtarak të NATO-s, shefat e Mbrojtjes diskutuan gjerësisht zhvillimet më të fundit të situatës gjeopolitike me rëndësi strategjike, jo vetëm për Aleancën por edhe më gjerë, si dhe zbatimin e vendimeve të marra gjatë Samitit të NATO-s që u zhvillua në Madrid në qershor të këtij viti.

Gjatë sesioneve të Konferencës dyditore, shefat e Mbrojtjes theksuan nevojën e ndërmarrjes së veprimeve dhe planeve konkrete në përbashkësi dhe kërcënimeve rajonale, duke synuar rritjen e efektivitetit dhe të shpejtësisë së dislokimit të forcave sa herë që do të jetë e nevojshme. Me vëmendje të veçantë nga drejtuesit e lartë ushtarakë u diskutua edhe për operacionet dhe misionet aktuale të NATO-s NMI, në Irak, KFOR, dhe Kosovë.

Shefat e Mbrojtjes së Aleancës diskutuan gjithashtu edhe për të ardhmen e modelit të forcës, duke synuar promovimin e inovacionit, si dhe për të mbështetur operacionet në sa më shumë fusha dhe "domene", nëpërmjet transformimit dixhital.

Gjeneral brigade Kingji, gjatë takimit rikonfirmoi vijimin e kontributeve të Shqipërisë në misionet, operacionet dhe aktivitetet e Aleancës si dhe vlerësoi në veçanti misionin KFOR të NATO-s në Kosovë si kontribuues i drejtpërdrejtë për sigurinë dhe paqen. Gjithashtu, gjeneral brigade Kingji adresoi një falënderim të veçantë për të gjithë aleatët dhe partnerët, sidomos SHBA-të, për përgjigjen në kohë dhe ndihmën që i dhanë vendit tonë pas sulmit kibernetik iranian.

Gjeneral brigade Kingji zhvilloi një takim pune me Kryetarin e Komitetit Ushtarak të NATO-s, Admiral Bauer, ku u diskutua mbi situatën e sigurisë në Ballkanin Perëndimor, roli i KFOR-it, si dhe kontributi i FARSH në mbështetje të sigurisë dhe paqes rajonale.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Arben Kingji, mori pjesë gjithashtu edhe në takimin e organizuar nga shefi i Shtabit kanadez, gjeneral W.D Eyre, me vendet kontribuuese në grup-batalionin kanadez të Prezencës së Përparuar (eFP), në Letoni.

Komiteti Ushtarak përbëhet nga shefat e shtabeve të vendeve anëtare të Aleancës dhe është përgjegjës për këshillimin e autoriteteve politike të NATO-s mbi masat që konsiderohen të nevojshme për parandalimin dhe mbrojtjen e përbashkët të territorit të NATO-s, si dhe për zbatimin e vendimeve në lidhje me operacionet dhe misionet e NATO-s. Me statusin e të ftuarit, në këtë takim morën pjesë edhe shefat e mbrojtjes së Finlandës dhe Suedisë, vende që janë në rrugën e anëtarësimit në familjen e madhe Euroatlantike.

Gjeneral brigade Arben Kingji priti në takim ambasadorin e Kanadasë, znj. Elissa Goldberg

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Arben Kingji, priti në një takim kortezie ambasadorin e Kanadasë, znj. Elissa Goldberg, e cila shoqërohej nga atasheu ushtarak kanadez, kapiten i rangut të parë Andre Boisjoli.

Në takim u vlerësua bashkëpunimi dy-palësh në fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë në kuadër të misioneve të NATO-s.

Gjeneral brigade Arben Kingji shprehu falënderimet

ndaj Forcave të Armatosura kanadeze për mbështetjen e dhënë në misionin e NATO-s në Letoni, ku FARSH kontribuon me kontingjentin nga kompania EOD në misionin për asgjësimin e municioneve të rezikshme.

Në përfundim, të dy bashkëbiseduesit ndanë të njëjtin qëndrim për thellimin e bashkëpunimit në fushën e trajnimit dhe arsimimit ushtarak, kryesisht në fushën e Emergjencave Civile, CIMIC dhe Barazisë Gjinore, si dhe angazhimeve të përbashkëta në operacionet dhe stërvitjet në kuadër të Aleancës.



AFA, pjesë e aktivitetit "Trail Running Albania"

U zhvillua në Voskopojë edicioni i pestë i "Trail Running Albania" në distancat 21 km, 10 km dhe 5 km.

Në aktivitetin e organizuar nga "Trail Running Albania" dhe Bashkia Korçë morën pjesë mbi 200 garues nga vendi dhe rajoni në disiplinën të ndryshme, ndërkohë që edhe Akademia e Forcave të Armatosura u përfaqësua me ekipin e saj.

Ekipi përbëhej nga major Bledar Mesi dhe major Kastriot Uba.

Përfaqësuesit e AFA-së zunë vendet e para në disiplinën 10 km malor, vendi i parë major Bledar Mesi dhe vendi dytë major Kastriot Uba, në fund të aktivitetit u shpërndanë kupat dhe medaljet për fituesit.



Ceremonia e gradimit në Akademinë e Forcave të Armatosura

Zhvillohet ceremonia e dhënies së gradave në Akademinë e Forcave të Armatosura.

Akademia e Forcave të Armatosura organizoi ceremoninë e gradimit për personelin e saj.

Në këtë ceremoni morën pjesë Komandanti i AFA-së gjeneral brigade Albert Mullai, drejtues të institucioneve dhe personel i AFA-së.

"Marrja e gradës së radhës është shpërblim i kontributit të dhënë në vijimësi për punën tuaj, profesionalizmi, përkushtimi dhe përfaqësimi juaj dinjitoz, shpresoj të shërbejë si motivim dhe për kolegët tuaj që synojnë të përparojnë në karrierën ushtarake në të ardhmen. Suksese!", - u shpreh Gjeneral Mullai



Akademia e Forcave të Armatosura, Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë ofron për herë të dytë në vitin akademik 2022-2023, programin e ciklit të dytë të studimeve: "Master Profesional në Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes".

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, teksa fton të gjithë të rinjtë të aplikojnë shprehet se: "Kjo është një mundësi fantastike për vijimin e studimeve universitare në një nga fushat më prestigjioze dhe më të lakmuara të momentit".

Aplikimi dhe përzgjedhja për ciklin e dytë të studimeve, Master Profesional, do të zhvillohet nga data 3 - 7 tetor 2022, ndërsa pas përfundimit të të gjithë procesit të përzgjedhjes studimet do të nisnin më 1 nëntor 2022.

Ky program studimi ka për qëllim të formojë gjeneratën e re të profesionistëve ushtarakë dhe civilë, të cilët do të përfitojnë njohuritë e duhura dhe eksperiencat për të zhvilluar sisteme më të sigurta kompjuterike.





Operacion kërkim - shpëtimi nga Anija P - 132 “Oriku”

Nga Policia e Kufirit dhe Migrationit në Vlorë u njoftua se një mjet lundruar tip gomone me emrin “BEMIKO”, nisur nga Himara për në Vlorë, me një person në bord, për shkak të një defekti ka qenë në rrezik dhe ka kërkuar ndihmë, pranë rajonit të Karaburunit.

Menjëherë doli mjeti i Rojës Bregdetare, anija P-132 “Oriku”, e cila bëri të mundur gjetjen dhe marrjen e personit në bord, i cili ishte në gjendje të mirë shëndetësore, dhe tërheqjen e mjetit drejt Triportit.

Anijet e Forcës Detare marrin pjesë në operacionin SAR

Anijet e Forcës Detare u angazhuan në një operacion, “Zbatim Ligjshmërie”. Pas një informacioni të marrë për përfshirje në aktivitet të paligjshëm të një anije tregtare, Grupi i Bordingut të Forcës Detare bordoi anijen dhe e shoqëroi atë për në Portin e Durrësit për vazhdimin e procedurave të mëtejshme të kontrollit nga Antikontrabanda Detare dhe Policia Kufitare.

Në mbështetje të operacionit të zbatimit të ligjit nga Forca Detare, u angazhuan Anija P-133 “Lissus”, anija P-118 “Briza” si dhe Grupi i Bordingut.

U mboll “Pema e Marinarit” në Sazan

Komanda e Forcës Detare në bashkëpunim me shoqatën “Detaria shqiptare”, organizuan në ishullin e Sazanit, një ceremoni përkujtimore për kuadrot detarë që kanë shërbyer në këtë ishull, si dhe mbjelljen e “Pemës së Marinarit”.

Në këtë aktivitet të rëndësishëm për marinarët shqiptarë morën pjesë prefekti i qarkut Vlorë, z. Flamur Mamaj, zëvendës presidenti i shoqatës “Detaria shqiptare”, zoti Astrit Aliaj, komandanti i Flotiljes Pashaliman, kapiten i Rangut I Engjëll Sinanaj, veteranë të Flotës Luftarake që kanë shërbyer në ishull, familjarë e fëmijë të detarëve, kuadro të Flotiljes Detare dhe anijes “Oriku”, etj.

Qëllimi i aktivitetit ishte, “Promovimi i vlerave të përbashkëta të kulturës dhe traditave detare në nivel kombëtar dhe njohja me Bazën Detare të Sazanit”. Lundrimi i pjesëmarrësve të aktivitetit nga Vlora në Sazan u bë me anijen “Oriku”.

Para se të bregëzohej në molin e ishullit, Anija “Oriku” bëri një ndalesë, ku pjesëmarrësit hodhën kurorë dhe buqeta me lule, në nderim të të gjithë detarëve që kanë ndërruar jetë. Ceremonia filloi me ekzekutimin e himnit kombëtar, pastaj mes emocioneve veterani Lutfi Gjika, bëri apelin e kuadrove oficerë, nënoficerë, që kanë shërbyer në ishull, por tani nuk jetojnë më.

Më pas përshëndeti prefekti i qar-



kut Vlorë, zoti Flamur Mamaj. Në emër të komandantit të Flotës, kundëradmiral Adnan Agastra, përshëndeti komandanti i Flotiljes, kapiten i Rangut I, Engjëll Sinanaj. Gjithashtu përshëndeti

në emër të Presidencës së shoqatës “Detaria Shqiptare” mbi krijimin e Bazës Ushtarake Detare në Sazan dhe aktivitetin e saj operacional deri në momentin e mbylljes, kapiten i Rangut I (R), Astrit Aliaj, zëvendës presidenti i Shoqatës.

Në vijim, për disa veteranë detarë që kanë shërbyer në ishull, u shpërndanë “Certifikata mirënjohje”, nga komandanti i Forcës Detare dhe shoqata “Detaria shqiptare”.

Mbas këtyre përshëndetjeve u recituan poezi për detarët shqiptarë, trimërinë, atdhedashurinë dhe shpirtin vetëmohues të tyre. Ndërkohë mbjellja e “Pemës së Marinarit”, një pemë ulliri me shënim të veçantë, u shoqërua me duartrokitje nga pjesëmarrësit. Ndoshta është nga të paktat raste në Shqipëri, kur mundi dhe sakrificat e marinarëve shqiptarë vlerësohen kaq simbolikisht. Çdo veteran ndihmoi në mbjelljen e kësaj peme. Për mirërritjen e saj do kujdesen marinarët e FD-së, që shërbejnë në ishullin e Sazanit.

Në vijim të aktivitetit u organizua një koktej për pjesëmarrësit, më pas një foto e përbashkët. Të pranishmit e vlerësuan këtë aktivitet tepër domethënës, dhe dhanë mendime për të organizuar ceremoni të tilla për detarët edhe në të ardhmen.

Përgatiti: Shefqet Kërcelli



Historia 64 - vjeçare e nëndetëseve shqiptare

Më 21 shtator 1958, u krijua Brigada e Nëndetëseve, (BrND).

ND I (Whiski 613 C, Stuhia), ND II (Rrufeja), ND III (Vetëtima), ND IV (Tufani).

Çlirimi i vendit nga pushtimi nazi-fashist e gjeti Shqipërinë pa flotë detare luftarake. Edhe ato pak mjete të thjeshta e primitive, që kryenin detyra mbrojtjeje e patrullimi në vijën bregdetare, u shkatërruan nga lufta.

Në dhjetëvjeçarin e parë të pasluftës, me ndihmën e BS, aleati kryesor i Shqipërisë ato kohë, u hodhën bazat e para për krijimin e një flote luftarake me motoskafe me armatim të lehtë dhe më pas me disa mjete të vogla e të shpejta luftarake, që quheshin "Katër Silurues", pas tyre dhe disa "Dragamina", me të cilat Shqipëria në ato kohë siguronte ruajtjen e kufijve detar të saj.

Shqipëria e vogël në hapësirën

bregdetare kishte vende shumë strategjike për të zotëruar jo vetëm kufijtë detar të saj, por për gjithë hapësirën që përfshin edhe detin Jon e më tej në Mesdhe. Dhe një nga këto pika strategjike ishte Gjiri i Pashalimanit, një vend ideal strehimi, jo vetëm për ato pak anije luftarake që kishte Shqipëria ato kohë, por dhe për një flotë më të madhe e më moderne.

Kjo i tërhoqi vëmendjen aleatit të ngushtë që kishte Shqipëria në atë periudhë, Bashkimit Sovjetik. Në tetor të vitit 1957 erdhi për vizitë në Shqipëri, ish-ministri i Mbrojtjes i BS, Mareshali i shquar i Luftës së Dytë Botërore, G. K. Zhukov, ku midis të tjerave, u vendos që gjiri strategjik i Pashalimanit të kthehej në një bazë të fuqishme luftarake detare jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për aleatët e saj në vitet '50 e '60-të të shekullit që shkoi, siç ishte "Traktati

i Varshavës", Aleanca Ushtarake e vendeve të lindjes komuniste.

Ishte një ëndërr për ushtrinë shqiptare, e veçanërisht për armën e marinës luftarake, ngritja e një flote të madhe e moderne, që nga fundi i viteve '50-të u bë realitet me ardhjen e mjeteve detare luftarake me përmasa të mëdha dhe së fundi grupi i nëndetëseve me bazën përkatëse, që i dhanë emrin "Flota Luftarake Detare (FLD) e Shqipërisë, me atë uniformën e bukur të marinarëve, me pelerinën ngjyrë deti mbi supë dhe shiritat e zinj në kapele shkruar me germa të mëdha: "Gjiri i Pashalimanit", nga një strehës e thjeshtë e mbrojtjes së anijeve peshkarexhë nga erërat e stuhishme detare, në vitet 1957-'58, u kthye shpejtë në një port modern luftarak për ankorimin e mjeteve mbi dhe nën ujore të Flotës së Re Detare Shqiptare të porsa ngritur.



Madhështinë e kësaj flote e plotësoi dhe ardhja e nëndetëseve në gushtin e vitit 1958, me lundrimin e tyre të gjatë nga baza e Kaliningradit në brigjet e Baltikut verior të BS, të udhëhequra nga baza e tyre lundruese, "Njemçinova", që në Shqipëri mori emrin "Tomori", e drejtuar nga Admirali rus Jorgorov, i cili vite më vonë në betejat politike ruse-shqiptare, u personifikua me personazhin e "Zheliznovit" në filmin shqiptar të viteve '60-të, "Ballë për Ballë", të shkrimtarit Ismail Kadare.

Emra të argjendtë, "Flota Luftarake Detare". Kapiteni i Rangut të Parë, Xhemal Shani, që u bë komandant i Brigadës së Nëndetëseve, si dhe komandantët Dashamir Ohri, Spiro Kote, Shyqyri Çukaj dhe Beqir Gërbi.

Teknika e re dhe e vështirë për efektivat shqiptarë, u përvetësua në një kohë rekord, në saje të vendosmërisë e përkushtimit, duke marrë në dorëzim postet dhe mjetet luftarake, që kohë pas kohe realizuan stërvitje me nivel të lartë luftarak. Një shembull të tillë tregoi ekuipazhi i nëndetëses së dytë të Brigadës së Nëndetëseve, me lundrimin e parë të saj të gjatë e të vështirë prej 21 ditësh, në thellësi të ujërave të Adriatikut, Jonit dhe deri në Mesdhe. Ishte

një stërvitje e vështirë, për faktin se i gjithë lundrimi dhe fazat e stërvitjes prej 21 ditësh u zhvilluan nën ujë me nivele të ndryshme thellësie, pa dalë në sipërfaqen e ujit. Nëndetësja drejtohej nga komandanti, toger Shezai Kasa, zëvendëskomandanti, toger Skënder Doçi, inxhinieri mekanik, toger Korab Mejdani e detarë të tjerë.

Ky lundrim u realizua në korrik të vitit 1959, pothuaj një vit pas ardhjes së kësaj teknike të re për flotën tonë luftarake. Lundrimi ishte i detyrueshëm për t'u realizuar në thellësi të ujërave detare, për shkak jo vetëm të kërkesave të stërvitjes në kushte lufte të vështirësive maksimale, por dhe të situatës që përjetonte vendi ynë në atmosferën e "Luftës së Ftohtë", që zhvillohej midis dy kampeve kundërshtarë dhe kur Flota e 6-të Amerikane ishte e pranishme në ujërat e Detit Mesdhe.

Brigada e Nëndetëseve përbënte atë kohë armën dhe teknikën më moderne të Flotës sonë Luftarake Detare dhe kjo detyrë, sa e rëndë dhe e vështirë, kërkonte angazhim e sakrificë maksimale, për të cilat ekuipazhet përkatëse me komandantët e tyre në krye, i realizuan me sukses. U shquan



mjaft nga këta kuadro drejtues të arsimuar në shkollat ushtarake detare në Baku, Sevastopol dhe Shën Petërsburg të BS.

Të tillë ishin: Xhemal Shani, Stavri Çika, Dashamir Ohri, Muharrem Lulolli, Shezai Kasa, Spiro Kote, Shyqyri Çuko, Beqir Gërbi, Skënder Doçi,

Aleko Pojani, Petrit Myftiu e shumë të tjerë. Flota Luftarake Detare, përveç Brigadës së Nëndetëseve në Portin e Pashalimanit, me bazën lundruese të përmasave të mëdha, "Tomori", me komandant Stavri Çika, kishte dhe brigadën e anijeve luftarake mbiujëse të ishullit të Sazanit, me "Gjuajtësit luftarak", "Dragaminat" dhe "Katër-Siluruesit" e shpejtësisë së lartë, po ashtu dhe detashmenti i anijeve ndihmëse mbiujëse siç ishin: anija e "Dragës", që thelloi portin e Pashalimanit me komandant Izet Velçanin, anija e "Çmagnetizueses", që shkarkonte nëndetëset dhe anijet e tjera luftarake nga ngarkesat elektromagnetike kundër fushave të minave detare, me komandant Xhevit Selimullari, anija cisternë, që furnizonte anijet luftarake me ujë e karburant me emrin, "Linda", "Rimorkjatori" me fuqi të madhe tërheqëse, me komandant detarin e vjetër, Dulla, anijet e vogla "Hidrografike", "Polumbarja" me grupin e palombarëve, e shumë e shumë anije të tjera ndihmëse. E gjithë ajo flotë luftarake, ishte një garanci për ruajtjen e kufijve detar të Shqipërisë, sigurisht e mbështetur dhe

nga një artileri e fuqishme bregdetare e instaluar në pikat më dominante të bregdetit, në ato kushte izolimi e rrethimi që përjetonte Shqipëria komuniste, shtu këtu dhe klimën e nderë të presionit që krijonte "Lufta e Ftohtë" midis dy kampeve rivale botërore.

Ngre siparin stërvitja e Grup-Batalionit të Këmbësores së Lehtë, "Biza-22"

Stërvitja më e madhe e Forcave të Armatosura, e koduar "Biza-22", ngriti siparin e saj, ku për rreth 10 ditë, mbi një mijë trupa dhe mbi 200 mjete, do të stërviten në poligonin kombëtar të Bizës.

Nëpërmjet kësaj stërvitjeje, synohet vlerësimi dhe certifikimi i Grup Batalionit të Këmbësores së Lehtë (GBKL), e cila do të jetë dëshmia më e mirë e përpjekjeve që janë bërë deri tani nga të gjitha nivelet e komandimit dhe të drejtimit të Forcave të Armatosura, për të përmbushur me sukses këtë objektiv madhor kombëtar.

Objektivat e stërvitjes "Biza-22" parashikojnë vlerësimin e shtabit të GBKL për zbatimin e procedurave standarde të planëzimit dhe vendimmarrjes ushtarake; testimin e procedurave të Komandim-Kontroll-Komunikimit, taktikave dhe teknikave gjatë planëzimit dhe zhvillimit të operacionit; vlerësimin dhe certifikimin kombëtar "Mission Ready" i GBKL, në përputhje me sistemin e vlerësimit CREVAL të NATO-s etj.

Stërvitja "Biza-22", është konceptuar për t'u zhvilluar si një stër-



vitje, e cila do të integrojë brenda saj kapacitetet e luftimit, mbështetjes me luftim si dhe të mbështetjes me shërbime të GBKL, ku parashikohen të aplikohen një sërë skenarësh të bazuar në manualët më të mira në përdorim nga NATO.

Kjo stërvitje, e cila përfundon më 21 shtator 2022, do të monitorohet nga ekspertët e dërguar nga Komanda e Komponentit Tokësor të NATO-s, si dhe do të ndiqet nga afër edhe nga një grup vëzhguesish nga Garda e New Jersey-it.



Kontingjenti KFOR-2, i trupave Komando me mision në Pejë, Kosovë, zhvilloi me sukses trajnimin "Freedom of Movement Detachment" (Detashmenti i lirisë së lëvizjes), duke treguar aftësi dhe profesionalizëm të lartë.

Përdorimi i dronëve në fushën e luftimit, tashmë është një faktor me ndikim esencial për fatin e betejës. Efektivët e Grup Batalionit të Këmbësores së Lehtë, gjatë kësaj jave u trajnuan nga ekspertët amerikanë të Gardës Kombëtare të New Jersey-it, për perfeksionimin e aftësive individuale, në përdorimin e tyre





Mbyllet në Gjermani stërvitja “Saber Junction 22”

Stërvitja e koduar “Saber Junction 22”, u zhvillua në bazën “Albertshof” në Hohenfels, Gjermani. Në këtë stërvitje morën pjesë rreth 4 500 trupa nga 8 shtete të ndryshme. Shqipëria u përfaqësua në këtë eveniment me një skuadër EOD prej 6 vetash me komandant toger Klejdis Plaku. Skuadra EOD ishte e atashuar pranë Batalionit Parashutist Xhenier të Brigadës 173 amerikane të stacionuar në Vicenza, Itali. Gjatë stërvitjes dhe sidomos gjatë fazës së ekzekutimit, skuadrës EOD iu dhanë në total 6 detyra për identifikimin dhe çaktivizimin e pajisjeve eksplozive të improvizuara (IED) dhe asgjësimin e municioneve konvencionale (UXO) të paplasura. Falë përgatitjes, trajnimeve, pajisjeve dhe eksperiencës, skuadra EOD tregoi nivelin e lartë profesional. Në përfundim të stërvitjes toger plaku dhe skuadra EOD morën përgëzime dhe inkurajime nga drejtuesit më të lartë të kësaj stërvitje.

Batalioni i Xhenios, në ndihmë për përmirësimin e infrastrukturës dhe eliminimin e rreziqeve

Efektivët e Batalionit të Xhenios për më se 1 muaj janë angazhuar në dy fronte për të ardhur në ndihmë të komunitetit në qytetet Korçë dhe Librazhd. 9 efektivë me 7 mjete po punojnë për heqjen e bimësisë dhe mbetjeve inerte në nivelin e “Aerodromit të Lumalazit” në qytetin e Korçës. Kjo sipërfaqe e madhe e mbuluar nga bimësi e dendur paraqiste rrezikshmëri për zjarre. Puna e deritanishme ka bërë të mundur eliminimin e rrezikut për zjarrin si dhe vënien në efijencë të këtij aerodromi.

Ky aerodrom do t’i shërbejë bashkisë Korçë për të kryer aktivitete të ndryshme si dhe fluturime sportive.

Prej datës 05.09.2022, për katër ditë me radhë, 11 efektivë të



Batalionit të Xhenios me dy mjete dhe një agregat po punojnë për eliminimin e rrezikut të shembjes të disa shtëpive në fshatin Vehçan, nga rënia e një masivi shkëmbor.

Edhe pse në kushte jo të favor-



shme teknike u arrit që ky operacion të arrihej me sukses. Gjatë gjithë ditëve të kryerjes së operacionit efektivat kanë pasur bashkëpunimin e bashkisë Librazhd, Policisë Bashkiake dhe asaj të Shtetit.



INTERVISTË ME PROF. ASOC. DR. SYBI MUSOLLARI

SPITALI USHTARAK, institucioni me histori të lavdishme 93-vjeçare

INTERVISTOI:
Shefe e Sektorit të Botimeve,
ANJEZA MUSOLLARI

Spitali Ushtarak mbetet referenca e vetme e mjekësisë ushtarake në Forcat e Armatosura (FA). Në memorien e brezave të ushtarakëve, ky institucion është i një rëndësie të veçantë. Ai është dhe mbetet një nga institucionet mjekësore më të rëndësishme në Shqipëri për traditën, eksperiencën e krijuar në vite. Dhe pse emërtimet e tij kanë ndryshuar në dekada, ai në kujtesën e njerëzve mbetet me emrin e njohur popullor, Spitali Ushtarak.

Për shumë vite, ai në pjesën dërrmuese u shërbente vetëm ushtarakëve por duke parë profesionalizmin dhe cilësinë e shërbimit, aty filluan të vizitohen personalitete

nga të gjitha fushat e jetës. Ndoshta mbetet spitali me histori të lavdishme në historikun e spitaleve shqiptare. Pozicioni i tij, hapësira, skajshmëria, rëndësia në vite e bëjnë atë një legjendë me vete. Por ajo që e ka ngritur lart madhësinë e tij, është se për nga rëndësia, cilësia e shërbimit, profesionalizmi i mjekëve dhe infermierëve, ka bërë që në vite të mbahet si spitali më me autoritet. Këtë vit, në shtator, Spitali Ushtarak mbushi plot 93-vjet nga krijimi i tij. Një Spital me shumë histori, shumë ngjarje, shumë zhvillime. Në atë spital janë shëruar mijëra njerëz të të gjitha profesioneve.

Por për të na dhënë një panoramë më të detajuar të zhvillimit në vite të Spitalit Ushtarak, mbi aktivitetin, drejtuesit dhe arritjet në fushën mjekësore, si pjesë e kontributorëve të tij, për lexuesin e shtypit ushtarak do të na flasë Prof. Asoc. Dr. Sybi Musollari.

Doktor Sybi Musollari: në shtator 1968, filloi si ndihmësmjek në regjimentin e ndërlidhjes Tiranë deri në vitin 1971, më pas me urdhër të ministrit të Mbrojtjes vishet oficer ndihmësmjek dhe punon në të njëjtin repart. Ndjek fakultetin e mjekësisë në degën Mjekësi e Përgjithshme, duke mbaruar me rezultate të shkëlqyera.

Nga viti 1978 deri 1981 punon si mjek i përgjithshëm në brigadën e Tankeve.

Në vitin 1981 transferohet në Spitalin e Përgjithshëm Ushtarak Tiranë, në repartin e sëmundjeve të mushkërive.

Në vitin 1984 fillon po në Spitalin Ushtarak si shefi repartit pneumologjisë dhe pneumolog e alergolog.

Në vitin 1988 vazhdon punën si shefi i repartit të terapisë dhe pneumolog.

Në vitin 1990 mbron temën shkencore për Kandidat i Shkencave Mjekësore për sëmundjet e mushkërive.

Gjatë ushtrimit të profesionit të tij me arritje të larta, është dekoruar për punë shkencore 2 herë nga Kuvendi Popullor i R.P.SH.

Ka botuar shumë artikuj në organet shëndetësore, sidomos në vitet 1985 -1990. Ka marrë pjesë në kongrese ndërkombëtare për sëmundjet e mushkërive organizuar nga Lofarma Milano, në Lisbonë, më pas në Venecia, Itali etj.

Cilat ishin prioritetet e Spitalit Ushtarak, sipas etapave të zhvillimit të mjekësisë ushtarake?

Prioriteti kryesor në kohën e luftës ishte të përballonim me sukses fluksi i madh i të sëmurëve dhe të plagosurve në fushën e luftës. Kjo detyrë u realizua me sukses në sajë të punës së palodhur të personelit mjekësor dhe dijeve shkencore që kishin marrë mjekët në shkollat perëndimore. Është një fakt interesant që të gjithë mjekët që u aktivizuan në luftë, dhe që ishin mbi 100, patën mbaruar shkollën në perëndim.

Prioritet i spitalit qendror të ushtrisë nga vitet 1944 e deri në vitin 1958 kanë qenë në dy drejtime: i pari të përmirësonte nivelin e shërbimit mjekësor në mjekimin e të sëmurëve, të mjekoheshin dhe rehabilitoheshin të plagosurit dhe invalidët e kohës së luftës; dhe orientimi i dytë ishte lufta kundër sëmundjeve infektive si tifo abdominal, tifo ekzantematike, fruthi, malaria dhe veçanërisht tuberkulozi. Theksoj se në ato vite këto sëmundje ishin në formë epidemie dhe shkaktonin shumë dëme në shëndetin e popullit dhe të ushtrisë.

Cilët kanë qenë disa prej drejtuesve të tij ndër vite?

Në vitin 1945 u ngrit sanatoriumi i parë në Tiranë, me 720 shtretër, ku mjekoheshin të sëmurët me TBC dhe Spitali Ushtarak në kuadër të luftës kombëtare kundër TBC organizoi nëpërmjet Qendrës Radiologjike nën drejtimin e Dr. Ismail Tartari, Dr. Lavdim Gjoncaj dhe Dr. Manxhar Qendro, depistimin masiv në radhët e ushtrisë për të zbuluar dhe mjekuar rastet e reja me TBC. Kjo betejë vazhdoi deri në vitin 1990, duke shkruar në çdo cep të Shqipërisë, ku ishin vendosur efektivat ushtarakë dhe duke bërë radiografi të selek-



sionuar të të sëmurëve për t'i dërguar për mjekim të mëtejshëm në spital.

Mjekët që kanë punuar në spitalin qendror ishin Dr. Sinan Imami, Dr. Osman Jonuzi, Dr. Hiqmet Dibra, që më vonë u bë Dekan i Fakultetit të Mjekësisë dhe shef i Neurologjisë Kombëtare.

Dr. Nazmi Shehu, që më pas u emërua shef i Traumatologjisë në Spitalin Ushtarak, Dr. Koço Gliozheni, që më vonë u emërua shef i Maternitetit të Tiranës, Dr. Grigor Daiu, i cili u emërua më pas shef i Shërbimit Infektiv në Spitalin Ushtarak, Dr. Petro Cani, kirurg që më vonë u emërua shef i Kirurgjisë së Spitalit Civil, Dr. Petraq Progri, që më pas u emërua shef i Shërbimit në Poliklinikën e Spitalit Ushtarak etj.

Për herë të parë në traumatologji nga Dr. Nazmi Shehu u hap dhomë reanimacioni për të sëmurët e shokuar.

Në vitin 1947 u bë urografia e parë dhe në vitin 1951 u bë bronkografia e parë. Po këtë vit, Dr. Petro Cani kreu operacionin e parë në mushkëri.

Spitali ushtarak u bë njësi bazë e organizimit të veprimtarisë shkencore në fushën e mjekësisë ushtarake. Po në vitin 1953 u mbajt dhe një sesion shkencor me tema kryesisht klinike, që i shërbenin punës së përditshme.

Në vitin 1973, drejtor u emërua Dr. Veli Toto, që ishte diplomuar në Çekosllovakia për kirurg urolog dhe qëndroi në këtë detyrë deri në vitin 1991.

Më vonë drejtorë të Spitalit Ushtarak kanë qenë Dr. Perlat Hodo, Dr. Ëngjell Mastori, Dr. Ilir Kajo, Dr. Mihal Kerçi, Dr. Luan Nikollari, Dr. Bedri Muho.

A mund të na bëni një rrugëtim nëpër historinë

dhe zhvillimin e tij?

Nga viti 1958 deri në vitin 1968 spitali qendror i ushtrisë u transferua në Laprakë, në ndërtesën ku është dhe sot.

Spitali kishte një kapacitet prej 400 shtretër. Zhvendosja e spitalit në këtë ndërtesë krijoi kushtet për një punë shumë të kualifikuar mjekësore sepse kishte infrastrukturë të një spitali perëndimor me të gjitha repartet e duhura.

U emërtua si Spital i Përgjithshëm Ushtarak dhe sfida kryesore ishte rritja e nivelit shkencor të mjekimit të të sëmurëve të shtruar dhe ngritja e spitaleve ushtarake nëpër rrethe sipas vendosjes të reparteve të ushtrisë. Nën kujdesin e spitalit u ngritën rreth 14 spitale ushtarake të reparteve të cilët u kompletuan me mjekë kirurgë, mjekë të përgjithshëm, farmacistë, dhe dentistë, si dhe disa raste radiologë.

Për rritjen e nivelit shkencor të mjekimit të të sëmurëve, në spital u ngrit reparti i kirurgjisë së përgjithshme me Dr. Ismail Feta, një kirurg i talentuar që i dha emër Spitalit Ushtarak. Dr. Ismaili ishte personalitet në fushën e mjekësisë, ai u bë i njohur në gjithë vendin për punën e tij shumë cilësore, sjelljen shembullore dhe nivelin e lartë shkencor të trajtimit të të sëmurëve. Dr. Ismaili punoi deri në vitin 1990 dhe gjithë jetën e tij ia kushtoi të sëmurëve.

Në repartin e traumatologjisë u kryen operacionet e para me osteosintezë nga Dr. Petraq Xoxe.

Në këtë repart punoi Dr. Spiro Dede, kirurg i diplomuar në Leningrad dhe që bëri operacionin e parë në zemër me ndihmën e Prof. Petrit Gaçes, gjithashtu bëri operacione në mushkëri në mënyrë të vazhdueshme, sidomos pas kthimit nga specializimi në Kinë.

U ngrit reparti i Reanimacionit me shef Dr. Mihal Prifti, specializuar në Rusi. Reparti i Urologjisë, me shef Dr. Veli Toto.

Në vitin 1962 u krijua reparti Kardiologjisë me shef dr. Hajro Shytin.

Reparti Okulistikës me Dr. Skënder Sinojmerin, i cili bëri operacione shumë të ndërlikuara për kohën.

Reparti Otorinolaringologjisë, me Dr. Besnik Budo, që bëri operacione plastike të membranës së veshit që nuk ishin bërë deri atëherë.

Reparti i Nefrologjisë, me Dr. Thoma Mele, kardiolog i specializuar në Rusi.

Reparti Neurologjisë, me shef Hiqmet Dibrën, që më vonë do të bëhej Dekan i Fakultetit të Mjekësisë.

Reparti i Sëmundjeve Infektive, me shef Dr. Qatip Kapllanin, specializuar jashtë.

Reparti i Dermatologjisë, me shef Dr. Vasil Gjylame-tin.

Reparti i Laboratorëve, me shef Dr. Vaskë Mukin.

Reparti i Traumatologjisë, me shef Dr. Nazmi Shehun.

Periudha nga 1968 deri 1974 kishte prioritet rritjen e nivelit shkencor të mjekëve dhe organizimin e punës mjekësore shkencore në funksion të perfeksionimit të shërbimit shëndetësor në kohë lufte, punën eksperimentale me kafshë për dhënien e ndihmës së parë, në të sëmurë me dëmtime nga armët e dëmtimit në masë, si arma radioaktive dhe lëndët helmuese luftarake. Për këtë qëllim, nën kujdesin e shtetit, u dërguan në Kinë

2 grupe mjekësh nga 10 veta për specializim njëvjeçar, ku gjithsej shkuan 22 mjekë.

Sa shërbime janë ofruar dhe cilat ishin ato?

Me ardhjen e mjekëve nga Kina, Spitali Ushtarak u bë spitali me pothuajse të gjithë personelin e studiuar jashtë, kjo e rriti shumë nivelin e mjekimit të pacientëve. U vunë në zbatim metoda të reja të mjekimit.

Kështu u rrit cilësia e operacioneve të përgjithshme, u hap reparti i Djegieve-Plastikës me Dr. Gëzim Pepin, ku aplikohesh plastika e të sëmurëve me djegie. Reparti i Reanimacionit me Dr. Agron Egro, u vu në përdorim narkoza endotracheale dhe u rrit cilësia e reanimacionit.

Reparti i Traumatologjisë, me Dr. Petraq XoXen dhe Halo Kërrin, ku realizoheshin operacione të cilësisë të lartë, me ndërhyrje në nerva e tendina.

Reparti i Neurologjisë, me shef Dr. Agim Kolasi, reparti i Okulistikës dhe i Otorinolaringologjisë, me Dr. Shkëlqim Kushova, bënë operacione të vështira në vesh.

Reparti i Kardiologjisë, me Dr. Kristaq Roko, kardiolog, i cili me vonë hapi Reanimacion Kardiologjie me 5 monitorë, një shërbim që deri atëherë nuk ishte në vendin tonë, reparti i Neurologjisë, me Dr. Rexho Kardhashi, që përmirësoi mjekimin e epilepsive.

Reparti i Gastroenterologjisë, me shef Dr. Shefki Guma, i cili vuri në jetë metoda të reja të mjekimit të ulcerës.

Dhe mbi të gjitha, u ngrit reparti i mbrojtjes nga armët e dëmtimit në masë, si ai i Radiobiologjisë dhe Toksikologjisë, këto dy reparte bashkëpunuan shumë me Qendrën Eksperimentale me kafshë, të spitalit duke i rrezatuar me lëndë radioaktive dhe më pas duke i mjekuar për të formuluar protokolle të mjekimit për kohë lufte. Po kështu dhe reparti i toksikologjisë punoi shumë në eksperimentimin e mjekimit nga lëndët helmuese luftarake.

Reparti i Radiobiologjisë u drejtua nga Dr. Gjergji Aleksii dhe Dr. Spiro Mëhilli. Reparti i Toksikologjisë u drejtua nga Dr. Bexhet Refatllari, mendoj të ndalem tek ky personalitet dhe shkencëtar i mjekësisë ushtarake që punoi me devocion për të vënë në jetë prodhimin në vend të Paketës Individuale Kundër-kimike. Kjo ishte një paketë që përmbante medikamente që neutralizonin lëndën helmuese – luftarake, në rast helmimi nga këto lëndë. Me këto paketa do të pajiseshin të gjithë efektivët e ushtrisë e populli në rast të një agresioni kimik. Këto paketa në vitin 1971 skaduan dhe nga Këshilli i Mbrojtjes iu vu detyrë repartit të Toksikologjisë dhe Institutit të Kimisë Ushtarake për t'u prodhuar në vend. Ishte shumë e vështirë por shumë e domosdoshme. Këtë detyrë e kreu i palodhuri Dr. Bexhet Refatllari. Ai punoi 1 vit së bashku me inxhinierët e kimisë dhe e prodhoi. Në eksperimentet që u bënë me kafshë rezultoi e suksesshme. Dr. Bexheti më ka treguar se, kur ishte në Kinë, teknologjinë e prodhimit të paketës nuk e jepnin sepse ishte sekret, por unë, thoshte ai, për ditë e pyesja profesorin që punonte me mua për probleme që në mënyrë indirekte kishin të bënin me prodhimin e paketës. Profesori si dashamirës i vendit tonë më dha shumë të dhëna, të cilat kur u ktheva më shërbyen për



të zgjidhur një problem të madh shtetëror që kishte të bënte me gatishmërinë dhe shëndetin e Forcave tona të Armatosura.

Çfarë ndryshimesh solli periudha mes viteve 1973 -1991?

Në vitin 1973, spitalit i jepet emri Institut i Kërkimeve Mjekësore Ushtarake IKMU, me drejtor Dr. Veli Toto, doktor që kishte bërë shkollën dhe specializimin në Çekoslovaki, qëndroi deri në 1990.

Cilat ishin sfidat kryesore dhe sa e vështirë ishte, duke ditur problematikat e kohës?

Sfidat e Institutit ishin: Të fuqizohej puna shkencore, eksperimentale në funksion të mjekësisë. Krijimi i Institutit kërkonte një organizim të ri, kërkesa më të larta të punës kërkimore shkencore, me metoda të reja diagnostikimi e mjekimi dhe bashkëpunimi më të gjerë me të gjitha institucionet shkencore të vendit. Vendimi i Këshillit të Ministrave përcaktonte drejtimit kryesore të punës së Institutit, ku më kryesoret ishin trajtimi i mjekimit, ku vendin kryesor e zinte profilaksia, puna kërkimore dhe organizimi dhe përgatitja e strukturave për kohë lufte. Duhet nënvizuar fakti që, puna kërkimore shkencore dhe ajo kurative zhvilloheshin paralelisht të gërshetuara me njëra - tjetrën.

Sipas vendimit të Këshillit të Ministrave, efektivi i spitalit përbëhej nga 438 punonjës dhe kapacitet shtrimi prej 400 shtretërish, numri i shtrimeve arriti deri 11 000 në vit. Në sektorin e Kirurgjisë, pas vitit 1980 janë kryer 1 400 operacione në vit.

U ngrit Spitali Qendror i Luftës me të gjitha pajisjet e nevojshme në Bizë- Martanesh, u krijua Këshilli Shkencor i Institutit, shumica e mjekëve të rinj që kishin ardhur

nga Fakulteti i Tiranës mbrojtën tema shkencore pranë Këshillit Shkencor të Institutit dhe në bashkëpunim me Këshillin Shkencor të Fakultetit të Mjekësisë, të gjitha temat i përshtateshin mjekësisë së kohës së luftës.

Të kualifikoheshin dhe t'u jepeshin detyra studimore shkencore klinike e eksperimentale mjekëve të rinj që kishin ardhur nga Fakulteti i Tiranës. Kështu në kirurgji erdhi Dr. Xhafer Qamirani, reanimacion Dr. Mihal Kerci e Dr. Viktor Kotoni, Dr Islam Dauti, në djegie Dr. Dilaver Bajrani, në ORL Dr. Kujtim Karafili e Dr Ndue Bardhi, në okulistike Dr. Thanas Kulo, në kardiologji Dr. Anila Ligaci, kardiologji Dr. Vaso Alimerko, në neurologji Dr. Qamil Koni, në neurologji Dr. Sybi Musollari, në pneumologji Dr. Zini Sula, në toksikologji Dr. Zija Jace, në laborator Dr. Sulejman Mena, në infektiv Dr. Ismet Hasko.

Shumica e këtyre mjekëve kanë mbrojtur tema shkencore pranë Këshillit Shkencor të Institutit dhe Fakultetit të Mjekësisë.

Për të rritur më tej nivelin shkencor të mjekëve të rinj u mor Urgjenca e të sëmurëve e Tiranës, një herë në javë nga kirurgjia dhe një herë në javë terapia. Kjo ndikoi në rritjen e nivelit tekniko - shkencor të trajtimit të të sëmurëve rëndë dhe u përballua me sukses.

Dr. Sybiu, a pati mes bluzave të bardha të atyre viteve dhe pjesëmarrje të vajzave? Dhe a mundën ato të arrijnë sukseset e mjekëve të nderuar?

U rrit shkalla e emancipimit të gruas në ushtri, sepse erdhën 5 mjekë gra si Dr. Mejte Bogdani në pneumologji, Dr. Hiqmete Dini në reumatologji, Dr. Tatjana Milo në gastroenterologji, Dr. Violeta Ristani në okulistike dhe Dr. Haxhire Eshja në fizioterapi.

Spitali Ushtarak ka pritur pacientë vetëm nga Forcat e Armatosura, apo dhe civilë?

Spitali i Përgjithshëm Ushtarak gjatë gjithë viteve ka qenë në pararojë të mjekimit të pacientëve, jo vetëm nga radhët e ushtrisë, por dhe popullsisë civile.

Sa nga pritshmëritë e pacientëve përmbusheshin nga shërbimet e ofruara në spital?

Mendoj se spitali i ka përmbushur të gjitha kërkesat, si në volum dhe cilësi. Spitali ka bërë asistencë vetëm për forcat e armatosura apo dhe civilë, sepse në vitin 1965 me urdhër të ministrit të Mbrojtjes u lejua mjekimi i veteraneve të luftës, ish-ushtarakëve, familjet e ushtarakëve.

Me marrjen e urgjencës, kontingjenti i të sëmurëve civilë u rrit shumë. Unë jam krenar që kam qenë pjesë e atij kolektivi dhe kam dhënë kontributin tim në sukseset e trajtimit të të sëmurëve dhe rritjen e nivelit shkencor të mjekësisë ushtarake.

Jam i ndërgjegjshëm se për sa kam përshkruar më sipër është vetëm një pjesë e vogël e asaj veprimtarie të shuman-shme, sa humanitare aq edhe e suksesshme në fushën e mjekësisë ushtarake.

Doktor Sybiu, si pjesë e elitës së mjekëve dhe drejtuesve të Spitalit Ushtarak, ju falënderoj për këtë intervistë, mes të cilës sollëm për lexuesin më të ri pak histori nga jeta dhe rrugëtimi i Spitalit Ushtarak, si një prej institucioneve më të rëndësishëm të kohës.



“Nëse nuk mund TË JESH LAPSI QË VIZATON

buzëqeshjen, atëherë bëhu goma që fshin vuajtjet e tyre”

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Tek ecja trotuareve të Tiranës, zënë dorë për dorë me tim bir, në krahun tim të majtë një ndërtesë me shumë dritare, por pa silueta njerëzish në të, me një derë dykanatëshe por gati statike

dhe një kokë e vogël me flokët e përdredhura zgjatur lehtas me një shikim të hutuar.

Një emër i madh shkruar jashtë në një tabelë “Zyber Hallulli”.

Im bir, kureshtar nga natyra, më pyet, - mami kush punon këtu?!

Fëmija i vogël gjysmë i fshehur, vazhdonte kundronte natyrën e bukur, mes dy kanatave të derës së madhe dhe një zë i fortë që vjen

brenda mureve të godinës, - hyr brendaaaa! Kurioziteti i tim biri u bë dhe më i madh pas këtij reagimi, - mami pse i bërtiti fëmijës nëna i tij?

- Biri im, “Zyber Hallulli” është shtëpia e fëmijëve që nuk i kanë prindërit pranë për shumë arsye.

Arsye?!...

Po çfarë arsye mund të justifikonin këtë fakt në sytë e djalit tim të vogël!?



Si mund të kuptojë ai se të rriturit dhe bota e nesërme për të, është plot të papritura dhe shpesh të pakëndshme!

“Jetim”, “fëmijë i braktisur”, jo, krijesë e pafajshme, është individi, prindërit e të cilit kanë vdekur, janë të panjohur, ose i kanë braktisur përkohësisht ata.

Të jesh kjo “krijesë e pafajshme” do të thotë të rritesh nga duart e dikujt tjetër, ndoshta, me shumë fat, rritesh në familje të bekuara e ndoshta të përplasesh dyerve të institucioneve, sofrave të të afërmeve, ose rrugëve të qytetit.

Ndoshta, nëse do ndërjegjësoheshim më shumë, nuk do i konsideronim këto krijesë si një barrë apo si një përgjegjësi që na ka mbetur në dorë, por si engjëj të pambrojtur që meritojnë dashuri dhe përkujdesje.

Nëse çdo mbrëmje i puthni fëmijët tuaj, dijeni se këto krijesë të pafajshme kalojnë vitet duke mbajtur sytë nga dritarja, duke prituri në pragun e derës, duke ëndërruar

që nëna ose babai të shfaqet sikur për një moment, edhe sikur për një puthje. Sa e madhe ëndërra e tij, ah... sa e madhe, as një përqafim, as një puthje, asgjë nga ato që prindërit iu falin fëmijëve çdo ditë, vetëm se prindërit e tyre nuk janë, thjesht nuk janë për cilëndo arsye, ata janë vetëm.

Në gjithë këtë botë të madhe ata janë vetëm, dhe ne, miliona njerëz, mund të japim vetëm pak, aq pak sa për ne mund të mos jetë asgjë dhe ajo pak për këta fëmijë është jetë, është një dritë e pashuar shprese, është dashuri, dhe është përkujdesje, në këtë mënyrë ata mund të gjejnë një familje, një buzëqeshje, një ngrohtësi, një fjalë të mirë tek secili nga ne.

Ëndërra më e madhe e tyre është të mos jenë vetëm, të kenë dashuri e përkujdesje, ...sa ëndërr e madhe për ta dhe sa lehtë mund ta realizojmë ne...

Miliona fëmijë në mbarë botën jetojnë në rrugë dhe në varfëri. Shumica e këtyre fëmijëve janë të privuar nga kujdesi shëndetësor dhe arsimi. Ka shumë faktorë që mund t'i shtojnë fëmijët e rrugës duke përfshirë varfërinë, ndarjen e familjes, dhunën, luftërat, fatkeqësitë natyrore dhe martesat të detyruara. Të ndjekur nga dhuna, abuzimi me drogën dhe alkoolin, vdekja e një prindi, shkatërrimi i familjes, lufta, fatkeqësia natyrore ose thjesht kolapsi social-ekonomik, shumë fëmijë të varfër janë të detyruar të dalin në rrugë, të fshihen, të lypin. Shpesh në jetën e përditshme të gjithë shohim në rrugë një kategori të tillë fëmijësh. Ajo që na bën të ndjehemi keq është pamundësia jonë për ta ndryshuar këtë fakt. Shohim çdo ditë fëmijë të moshave të ndryshme që dalin në rrugë kush duke lypur, kush duke u bërë shitës ambulant për të fituar bukën e gojës.

Varfëria dhe pasiguria sociale në vendet tona dhe në mbarë botën i detyron shumë familje të heqin dorë nga prindërimi. Ata fëmijë duhet të rriten, edukohen, kulturohen dhe zhvillohen, si gjithë të tjerët.

Këta fëmijë nuk shkojnë në

shkollë apo e kanë braktisur atë, sepse përdoren nga familja si faktor ekonomik apo shfrytëzohen nga “tutorët e rrugës”. Çdo ditë në rrugë dhjetëra fëmijë janë të detyruar të lypin dhe të shesin diçka për shkak të disa detyrimeve. Disa prej tyre janë të detyruar të punojnë.

Në fakt, në të gjithë botën ka një numër të madh fëmijësh që mbijetojnë në rrugë, në disa vende ata janë më të njohur si të pastrehë. Duke ecur nëpër rrugët, qendrën e qytetit ku jetojmë shohim njerëz që kërkojnë lëmshë nga ne, të mbështjellë me një batanije, në sytë e tyre dhe fytyrat e tyre nuk sheh gëzim, këmbëzbathur verë e dimër. Nga çantat ose xhepat tanë gjithmonë iu japim monedha edhe pse ata nuk i mban gjallë. Shumë njerëz janë kundër dhënies së parave për lypësit rrugës. Ne shohim shumë fëmijë duke lypur në rrugë në gjendje të vështirë dhe të pambrojtur. Ndihe mi të trishtuar, ndonjëherë neglizhojmë duke menduar përtej qëllimit tonë. Është vërtetë shumë trishtuese...

REZULTATI I TRISHTUAR

Dhe në shtëpitë e fëmijëve, në dukje të sigurt, ku disiplina është ruajtur, ka raste të vëzhguara flagrante të abuzimit. Tek këta fëmijë, nëpër këto qendra duhen dhënë të paktën konceptet themelore të jetës në shoqëri.

Shumë fëmijë nga shtëpia e fëmijës, të cilët rriten pa thelbin shpirtëror dhe moral, janë të prirur drejt egoizmit dhe degradimit.

Për t'u bërë anëtarë të plotë të shoqërisë është pothuajse e pamundur.

Qenia jetim i një fëmijë lë pasoja të pariparueshme psikologjike, të cilat mund të riparohen apo reduktohen vetëm në një mjedis të ngrohtë familjar dhe shoqëror, i cili e pranon dhe e sheh atë të barabartë në çdo aspekt. Në shumë raste nga studime të shumta psikologjike që i janë bërë kësaj kategorie, tek fëmijët pa prindër apo edhe vetëm me një prind, nga ana e shoqërisë vihet re një qëndrim injorues, neglizhues, ku shfaqen hapur emocionet negative që manifestohen

ndaj këtij fëmije. Ky qëndrim përbën edhe shkakun fillestar që tek fëmija të lindë agresiviteti ndaj atyre që e refuzojnë, lënë pas dore, apo edhe që duan "ta heqin qafe". Një fëmijë i tillë nuk ka fatin e pasjes së një jete normale. Ai ndjen peshën e një damke të dhimbshme sociale, refuzuese dhe dyshuese ndaj tij. Kur fëmija rritet ndjen psikologjikisht se është ndryshe nga bashkëmoshatarët e tjerë. Gjendja e një jetimi vështirësohet në stadin e adoleshencës, kur krizës së identitetit të moshës i bashkohet kriza personale që ky individ mbart në vetvete, kjo pasi origjina e identitetit personal dhe familjar nuk ekziston, duke i munguar kështu edhe objekti i identifikimit. Pikërisht identiteti i paqartë, i çrregullt dhe i shfityruar e bën fëmijën psikologjikisht të ligshat dhe të deformuar. Për këto arsye, këta individë kanë çrregullime emocionale dhe të sjelljes.

NUK ËSHTË NJË ALTERNATIVË...

Përfundim i trishtuar: shtëpitë e fëmijës, si një formë e edukimit të jetimëve tërësisht e provuar, janë të paefektshme.

Por çfarë mund të ofrojmë në këmbim?

Ka familje strehuese që mund të zëvendësojnë familjen biologjike.

Gjithashtu interesante është përvoja e SOS, Fshatrave të Fëmijëve.

Qëllimi i tyre: sa më shumë që të jetë e mundur për të sjellë kushte të rritjes dhe edukimit të kësaj kategorie, kthimi në familje (birësuese), përkujdesje shëndetësore, avokati (për mbrojtjen e fëmijëve).

Birësimi, ky i fundit, si alternativa më e mirë e mundshme dhe në interesin më të lartë të fëmijës.

Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve përbën një nga drejtimit më të rëndësishme, të politikave të mbrojtjes sociale. Në themel të tyre, pasqyrohen parimet themelore të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve, e ratifikuar nga Shqipëria në vitin 1992, detyrimet që dalin nga objektivat e mijëvjeçarit të ri dhe instrumentet e tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar, të cilat theksojnë se: fëmijët, për shkak të veçorive të moshës, të

mungesës së pjekurisë fizike dhe intelektuale, kanë nevojë për mbrojtje dhe vëmendje të veçantë nga familja dhe institucionet shtetërore. Një nga zhvillimet aktuale sot në botë, është angazhimi i të gjithë shoqërive dhe mekanizmave të tyre qeverisës, për një botë të denjë për fëmijët, ku ata e nisin jetën në mënyrën më të mirë të mundshme, ku të gjithë ata kanë mundësi të shumta për zhvillimin e aftësive të tyre individuale në një mjedis të shëndetshëm dhe inkurajues.

jetojmë janë çështje të prekura përditë, por që çdo ditë nxjerrin nevojën e ndërhyrjes shumëplanëshe shtetshoqëri, ku shtresa dhe kategori të ndryshme sociale të cënueshme, kërkojnë më shumë barazi dhe integritet me pjesën tjetër të shoqërisë.

Udhërrëfyes të pazëvendësueshem në këtë përpjekje jetike globale për shoqëritë demokratike, mbeten parimet e interesit më të lartë të fëmijës, të mos diskriminimit, pjesëmarrjes, mbijetesës dhe zhvillimit.



Pikërisht ky mjedis, duhet të shërbejë si nxitës për zhvillimin fizik, psikologjik, shpirtëror, shoqëror, emocional dhe kulturor të fëmijëve, si një çështje që tashmë është prioritet global. Shoqëria shqiptare, është bërë pjesë e këtij angazhimi global, në realitetin e hidhur, ku një numër i konsiderueshëm fëmijësh jetojnë në kushte të rënda dhe shpesh pa mbështetjen e prindërve të tyre.

Realiteti shqiptar prezanton një shoqëri ku problemet sociale janë të mprehta, ku mirëqenia dhe mjedisi ku

Për një shoqëri të shëndetshme të së nesërme, që këto "krijesa të pafajshme" të ardhur në këtë jetë nga një raport dashuror i çastit apo jo, të rriten pranë kësaj shoqërie si pjesë e saj, me dashuri dhe vlera humane. Duhet përkushtim maksimal i institucioneve, por edhe i gjithë organizmave të tjerë, që e nesërmja mos të na përballë me të papritura të pakëndshme, pikërisht prej mos respektimit të vlerave dhe dinjitetit të kësaj pjesë të shoqërisë.

Dimri, Donacionet, "Dritharmët" - 3D në "Operacionin special"



KOLONEL HYSNI GJERGJI

“**O**peracioni special” nuk është aspak i kufizuar, ai është drejtuar jo vetëm në një rajon të Ukrainës, jo vetëm në Ukrainë, madje jo vetëm në Europë.

Rreziku i përdorimit të armëve bërthamore është akoma opsion, për faktin se rusët e kanë të vështirë të pranojnë humbjen dhe të tërhiqen nga operacioni i tyre “special”. Egoja dhe “lëndimi” i sdrës së fituesit të përjetshëm u shfaq edhe në fjalën e tij, më 20 shtator, e cila nuk i lejon liderët autoritarë të pranojnë se po humbasin. Për të përmbysur rezultatin, diktatorët do të përdorin edhe armën e fundit të dëmtimit në masë. Më 21 shtator, Putin kërcënon se nuk po bën bluf, lidhur me përdorimin e çdo arme dhe mjeti për të mbrojtur sovranitetin dhe integritetin e kërcënuar territorial të Rusisë. Mobilizimi i “pjesëshëm” i 300 mijë rezervistëve për ditët në vazhdim, tregon se paqja është larg. Megjithëse opsioni i kërcënimit bërthamor në duar të rusëve ekziston, Moska ka shpalosur edhe një spektër të gjerë armësh dhe rreziqesh hibride, për doktrinën e të cilave me gjasa, ka

punuar kohë më parë.

“Dimri”, “Donacionet” dhe “Drithi” aktualisht janë etiketuar me armët sovjetike dhe aleatët më besnikë të “ushtrisë së kuqe”, në luftën e dytë botërore. Pas 80 vjetësh, ironikisht edhe një herë tjetër acari rus është drejtuar kundër Gjermanisë paqësore dhe demokratike, por jo vetëm kundër saj. I ashtuquajtur “operacion special”, me armët 3D i ka dhënë efektet negative nga Europa deri në Lindjen e Mesme, Afrikë dhe vende të tjera, të cilët janë bazuar me burime energjie dhe drithi te Rusia dhe Ukraina. I bindur se i ashtuquajtur “Operacioni special” po funksionon, Putin deklaroi, më 6 shtator 2022, se Europa, nëse nuk bën marrëveshje me Rusinë, këtë dimër do të ngrijë si “bishti i ujkut”, duke kujtuar një përrallë të vjetër ruse. Ndërkohë që planifikonte skenarët e krizës energjetike, Putin vazhonte donacionet për mbështetjen e partive politike pro ruse në Europë; si dhe të kërcënohte me urinë e bukës; pikërisht tani para dimrit që po afron 2022-2023.

Koha kur Putin zgjodhi ta pushtojë Ukrainën është e mirë planifikuar, një moment i vështirë për njerëzimin, kohë kur Europa dhe Bota po rimëkëmbej nga efektet ekonomike të pandemisë COVID 19. Pikërisht në këtë moment ai vendos të sulmojë, duke besuar se ekonomitë perëndimore nuk do të jenë në gjendje t'i përballojnë pasojat e vendosjes së sanksioneve kundër Rusisë. Ai shprehet i bindur se BE edhe kësaj radhe do të jetë e butë në dënimin e agresionit rus, ashtu siç ishte në vitin 2014 për Krimenë. Në ditët e para të agresionit, ai është përpjekur të “përkëdhelë” Gjermaninë, nga njëra anë, ndërsa të fajësojë Anglinë për pasojat në luftën e dytë botërore, me qëllim “subversion” në mes vendeve të BE-së dhe NATO-s.

Putin në strategjinë e tij është përpjekur që mbështetjen ndërkom-

bëtare ta fitojë duke përdorur tre strategji të përshkallëzuara. E para, është pa pagesë nëpërmes “fuqisë së butë”, duke u bazuar kryesisht në patriotizmin, glorifikimin dhe kontributin sovjetik në luftën e dytë botërore. Për këtë qëllim përdoren nostalgjikët dhe “idiotët e dobishëm” të organizuar në shoqata miqësie dhe organizata veteranësh. Bursat e studimit për studentë nga vendet e ish-traktatit të Varshavës, janë një grup interesi për të rekrutuar mbështetës dhe fanatikë pro rusë.

Metoda e dytë është me blerje, sipas parimit që “një problem që nuk zgjidhet me para, zgjidhet me shumë para”. Paratë ruse në ekonomi vadisin politikën europiane dhe japin fryte të manipuluar dhe pamerituara në zgjedhje. Kremli nuk ka kursyer të paguajë për të arritur interesat e tij strategjike, qeveri, shoqata, personalitete, individë me interes, etj. Pagesa të majme jepen për spiunazh, sabotazh dhe subversion drejt vendeve të Ballkanit, si objekti kryesor i interesit rus. Në fushën e financimeve të huajve, nuk ka ligje, moral dhe mëshirë, nuk ka regjime autoritare apo demokratike, por ka “një marrëveshje” të heshtur, ku mbizotëron interesi kombëtar i çdo vendi. Afërsisht këtë e bëjnë të gjithë shtetet kundër të gjithëve. Çdo shtet kërkon të ketë epësi dhe kontroll mbi tjetrin. «Skandali» i fundit i financimeve ruse në Europë shpërthen në një moment vendimtar të fushatës së zgjedhjeve në Itali. Matteo Salvini është politikani i vetëm evropian që shëtiste me një bluzë me figurën e Putinit, në kohën e aneksimit të Krimesë nga Moska në 2014. Në 2018, Partia e Salvinit mori vetëm 4%, dhe sot kjo parti ka 25% të votuesve. Me strategji të mirë menduar, duke joshur me çmimet më të ulëta të gazit për Europën për 10 vitet e fundit, Moska arriti të “vërë në gjumë” sigurinë energjetike euro-

piane në 10 vitet e fundit dhe arriti të zotërojë pa konkurrencë, i vetëm, rubinetet e gazit për disa shtete kryesore të Ballkanit dhe Europës.

Pjesë e "kurthit" të krizës së planifikuar të energjisë, ishte edhe përfshirja në bordero të ish-kryeministrave të shteteve kryesore të Europës si Schröder i Gjermanisë, Fillon i Francës, Renzi i Italisë, Aho i Francës, Kern ish-Kancelar dhe Kneissi ish-ministre e jashtme e Austrisë; Kjo e fundit, madje e ftoi presidentin rus në dasmën e saj.

Mbështetja politike e këtyre figurave, përmes profilit, lobimit dhe aksesit të lartë politik, ishte e nevojshme për Moskën. Vetëm prezenca e emrave të tyre në forumet dhe bordet botërore të energjisë, i bëri "vetting" Putinin në sytë e opinionit botëror dhe e largoi nga dyshimi për "dyshimet" e përhapura ndaj tij. Siç mund të vlerësohet tani, ia vlejti pagesa e "pensionit të majmë" për këto ish-liderë të Europës. Të gjithë këto elita europiane, Putini i bleu me anë të kompanive ruse që i pajtonin si administratorë. Asnjëri nga këto liderë të Europës nuk foli apo dënoi agresionin rus në Ukrainë.

Ndërhyrjet me mjete financiare të një shteti në fushatat elektorale të një shteti tjetër, janë të njohura, aq më tepër kur bëhet fjala për fuqi antidemokratike si Rusia, të cilat nuk e kanë problem të ndërhyjnë edhe me armë në një vend tjetër. Në Francë, sipas shtypit, janë financuar nga Rusia partia e Le Pen-it, e cila në dy zgjedhjet e fundit presidenciale arriti në vendin e dytë, fare afër fitores. Kina bën të njëjtën gjë në shumë vende të Afrikës dhe padyshim në Europë, ashtu si dhe Turqia në Azinë Qendrore. Vetë shtypi francez i ka përfolur disa metoda lidhesh financiare në Afrikë me shprehjen «Francafrika» për të denoncuar mbështetjet elektorale ndaj liderëve diktatorë afrikanë. Aq larg shkon ironia e këtij "sporti" botëror të ndërhyrjes në lojën politike të vendeve të tjera, sa dhe vetë vendet që «sulmojnë» por edhe «sulmohen» si rasti i Francës, në të cilin Maroku që kishte arritur të fuste software spiunë për të përgjuar celularin e presidentit Makron. Serbia në 2015 bleu «shërbimet këshillimore» të Tony Blair, atij që u akuzua pareshtur për vite me radhë, se kishte bombarduar Beogradin me 1999?! Deklarimet e fundit zyrtare të SHBA-së për donacione rreth 500 mijë dollarë për të manipuluar zgjedhjet, në drejtim të Ballkanit dhe Europës, janë bërë edhe nga vetë sekretari Blinken. "Ne jemi angazhuar

me vendet në mbarë botën për të ndarë atë që dimë për ndërhyrjen e Ruisë në sistemet zgjedhore gjere-sisht, por edhe në raste specifike. Kur kemi informacion, përfshirë informacion inteligjence në lidhje me ndërhyrjen e Ruisë, ne shpesh e ndajmë atë informacion të klasifikuar me qeveritë partnere", - thotë zëdhënësi i Departamentit të shtetit, Ned Price, më datë 17 shtator 2022.

Mënyra e tretë është bllokada ekonomike dhe fushata e armatosur ushtarake. Kjo aplikohet nëse me "soft power" ose me "para të zeza" nuk është arritur rezultati i dëshiruar. Kjo metodë duket qartë se po ndodh në Ukrainë. BE-ja dhe SHBA-të po e fitojnë luftën në drejtim të fushatës ushtarake, por në dy elementët e tjerë: ushqimet dhe energjia, situata është kthyer në të kundërt. Rusia dhe Ukraina në tregtinë botërore për sa i përket eksporteve në drejtim të drithit, ofrojnë 29 % të eksporteve të grurit respektivisht: 17 % Rusia dhe 12 % Ukraina dhe rreth 20 % të eksporteve të misrit. Ato zhvillojnë më shumë se 50 % të eksportit të vajit të lulediellit (29 % Rusia dhe 21 % Ukraina). Në momentin kur eksporti i produkteve të rëndësishme jetësore ushqimore u ndërpre si pasojë e luftës, në Europë çmimet e grurit, misrit dhe vajit ushqimor u rritën në mënyrë të paparashikueshme. Ukraina ka një popullsi sa 5% e popullsisë botërore dhe furnizon me ushqim rreth 400 milionë banorë (e përafërt me popullsinë e SHBA-ve) si dhe rreth 80% të drithit të nevojshëm për BE-në, e cila ka rreth 500 milionë banorë. Rusia në vitin 2020 eksportonte 40 % të energjisë në Europë, e cila transportohej nëpërmjet gazsjellësit "Nord Stream 1". Ky gazsjellës është ndërtuar krejtësisht nën ujë në Detin Baltik, me gjatësi 1224 km dhe ka kushtuar 7.4 bilion euro. Është financuar së bashku nga kompania shtetërore ruse "Gazprom" me katër kompani europiane, shumica e gazit shkon në Gjermani dhe prej aty shpërndahet në të gjithë Europën.

Për të kuptuar këtë element të luftës hibride të Ruisë, duhet të krahasojmë çmimin e gazit nga muaji janar 2022 deri në shtator 2022. Çmimi i energjisë për këtë periudhë në SHBA është rritur me 37 %, në Britaninë e Madhe me 142 % dhe në BE me 144 %. Gjatë vitit 2020 vendet e BE-së kishin këto vartësi nga gazi rus: Maqedonia e Veriut 100 %, Finlanda 94 %, Bullgaria 77 %, Sllovakia 70 %, Gjermania 49 %, Italia 46 %, Polonia 40 % dhe Franca 24 % vartësi nga gazi rus. Rusia e kishte

gati skenarin, sapo BE-ja vendosi sanksione ekonomike, dhe mori menjëherë dy vendime të rëndësishme: Ndalimin e eksportit të gazit në vendet e BE-së me 60 % dhe vendosjen e kushtit ata duhet të paguanin me rubla. Meqenëse Rusia ndaloi 60 % të eksportit të gazit në tregun evropian, menjëherë çmimet e gazit u rritën për shkak të kërkesës së lartë dhe rënies së ofertës me 40%. SHBA-të, Katari, Norvegjia dhe Australia, janë në gjendje të ofrojnë sasinë e nevojshme të gazit për BE-në, por ata nuk e kanë aktualisht në dispozicion infrastrukturën për transportin dhe shpërndarjen e gazit në vendet e Europës. Ndërtimi i tubacionit "Nord Stream 1" nga Shën Petërburgu në veri-lindje të Gjermanisë zgjati rreth gjashtë vite. BE-ja duhet që në bashkëpunim me fuqitë botërore të gazit si SHBA-të, Norvegjinë, Katarin, etj., të fillojnë ndërtimin e infrastrukturës, me qëllim shpërndarjen e gazit nëpër Europë dhe heqjen e vartësisë një herë e përgjithmonë nga burimet energjetike të Ruisë. Sipas EuroStat inflacioni në BE është rritur me 9.6 % në muajin qershor 2022, çmimet e prodhimeve industriale janë rritur me 36 %, çmimet e ushqimeve janë rritur me 7.5 % dhe energjia me 144 %, duke arritur shifrat më të larta të 20 viteve të fundit. Pakënaqësia e europianëve është objektiv i Moskës, pasi Ruisë i intereson të ulë mbështetjen e votuesve pro perëndimorë dhe të rrisë trazirat, mosbesimin, koston e jetesës dhe pakënaqësitë e brendshme të BE-së.

Mediat europiane, ndër të cilat "Berlin policy journal", i janë kthyer analizave të deklaramëve dhe botimeve strategjike ruse para agresionit mbi Ukrainë, ndër të cilat është doktrina "Gerasimov", një ese prej 2 000 fjalësh, e botuar në shkurt 2013 nga gjenerali Gerasimov - shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Ruisë. Në këtë dokument kryesor strategjik të ushtrisë ruse, u theksua roli i mjeteve jo-ushtarake për arritjen e qëllimeve politike dhe strategjike. Në konfliktin aktual në të vërtetë ndikimi i gazit, naftës parave të pista dhe ushqimit, në shumë raste ka tejkaluar fuqinë e forcës së armëve në efektivitetin e tyre. Gerasimov njihet si një komandues, tankist i aftë dhe i ashpër, por karriera e tij nuk ka treguar asnjë provë se ai është edhe një teoricien ushtarak apo edhe i interesuar për studimin e artit të luftës. Doktrina konsiderohet nga shumë studiues si artikulli i strategjisë moderne të Ruisë dhe një vizion i luftës totale, që e vendos

War, Not Sanctions, Causes Food Insecurity

U.S. sanctions do not apply to:

- Food
- Medicine
- Humanitarian aid

Putin's war has left:

- Fields shelled
- Grain silos damaged
- Warehouses bombed
- Ports blocked
- Transport systems destroyed



politikën dhe luftën brenda të njëjtit spektër aktivitetesh - filozofikisht, por edhe ekonomikisht. Doktrina duket se është një nocion themelor i luftërave, që Rusia planifikon të kryejë dhe fitojë, duke nxitur propagandë, operacione të fshehta të ndikimit, kërcënime me urinë dhe ngricën dhe "para të zeza" për të manipuluar zgjedhjet në Europë.

Është e qartë për të gjithë se motori i zhvillimit të ekonomisë, që ndikon koston e tij kudo në ekonomi, për çdo komb është energjia. Deri në muajin gusht të vitit 2022, furnizimi i Europës me gaz nga Rusia ka rënë me 80%. Kriza energjetike në Europë, ka filluar të mbyllë fabrikat një nga një. Efektet e luftës ekonomike po ndihen çdo ditë e më shumë. Afërsisht gjysma e fabrikave të aluminit dhe zinkut në Europë janë mbyllur në këtë fillim shtatori 2022. "Nyrstar" është fabrika më e madhe e prodhimit të zinkut në botë, me qendër në Holandë, që zotërohet në pjesën më të madhe nga "Trafigura", ndaloi prodhimin në shtator. Fabrika e aluminit "Damco Aluminium Delfzijl Coöperatie U.A." (ALDEL) në Delfzijl, Holandë, u mbyll javën e kaluar. Fabrika e "Damco" në Farmsum, e cila prodhon alumin me cilësi të lartë, është mbyllur nga data 1 Shtator 2022, për shkak të çmimeve të larta të energjisë. "Norsk Hydro" ASA, me qendër në Norvegji, planifikon të mbyllë fabrikën e saj të aluminit në Sllovakia në fund të muajit. Kompania sllovene e aluminit "Talum" uli prodhimin në një të pestën e kapacitetit të saj. "Alcoa" gjithashtu, një kompani me qendër në USA, do të reduktojë një linjë në fabrikën e saj Lista në Norvegji.

Kompania më e madhe në botë e plehrave kimike që ndikon në rritjen e koston së drithit drejtpërdrejt "Yara", me seli në Norvegji, bëri një ulje prej 50 për qind në prodhimin e plehrave azotike me bazë ure dhe

amoniak në Europë. Prodhuesi më i madh britanik i plehrave "CF Fertilizers UK" ka njoftuar gjithashtu se do të ndalojë përkohësisht prodhimin në fabrikën e tij në Billingham. Dy prodhues të mëdhenj të plehrave në Poloni njoftuan se do të ndalojnë aktivitetet e tyre. Në fillim të gushtit, filiali Belg, "Aperam", reduktoi prodhimin në Genk dhe Charleroi. Kompania spanjolle "Acerinox" njoftoi se do të shkurtojë prodhimin dhe do të kalojë rreth 85 % të punonjësve të saj, në punë me kohë të shkurtuar. Duhet pranuar se linja e arritjes së objektivave strategjike, që ndjek Putini deri tani po funksionon. Që nga fillimi i konfliktit, Europa po vuan nga rritja e madhe e çmimeve, ndërkohë që inflacioni në drejtim të energjisë është në nivelin 41.9 %, inflacioni i ekonomisë së BE-së në muajin gusht u rrit 10.8. Me qëllim që të kuptojmë strategjinë e luftës hibride të Putinit, duhet të analizojmë konceptin e luftës moderne së bashku me elementët e tjerë të saj hibridë, të përfshirë në këtë konflikt: Ushqimin, paratë dhe energjinë. Ndërkohë që objektivi i sanksioneve ekonomike financiare të perëndimit, është shkatërrimi i ekonomisë ruse, në fakt gjatë këtyre 7 muajve, Rusia ka grumbulluar më shumë para nga shitja e naftës dhe gazit. Kjo ka ndodhur për këto arsye se, pas ndalimit të eksportit me gaz nga Moska me rreth 60 %, BE-ja ishte e gatshme ta paguante atë me çfarëdo çmimi, sepse mungesa e energjisë do të shkatërronte ekonominë e BE-së. Çmimet e naftës që ishin 65 \$ për fuçi në 2021, në kohë rekord shkuan 100 \$ për fuçi. Rusia përfitoi 50 bilionë dollarë në 2021, ndërsa gjatë vitit 2022 nën sanksione, gjatë të njëjtës periudhë kohe ka përfituar 90 bilionë dollarë ose rreth dyfish. Në raport me vitet e tjera, nën sanksione eksporti i sotëm i energjisë së Rusisë me të gjithë partnerët e tjerë është

rritur tri herë?!

Kina dhe India nuk kanë pranuar t'i bashkohen sanksioneve ekonomike, sasia e importit të tyre edhe për shkak të një çmimi preferencial në raport me tregjet botërore, ka bërë që Rusia të shtojë volumin e eksportit me tri herë, jo vetëm duke kompensuar humbjet ekonomike me Europën, madje duke shtuar të ardhurat në buxhet. Pikërisht kjo ka qenë një nga arsyet pse SHBA-të dhe BE-ja po ushtrojnë presion mbi Indinë, që të ndalojnë blerjen e energjisë nga Rusia. India është përgjigjur se është në interesin e tyre kombëtar që ta blejë energjinë sa më lirë të jetë e mundur. Shtrirja e tubacioneve në të gjithë Europën, do t'i kushtonte SHBA-ve, jo vetëm miliarda dollarë, por edhe disa vite për tu ndërtuar. Arabia Saudite nën drejtimin e Princit të Kurorës Muhammed bin Salman (MBS), vendi që eksporton më shumë naftë në botë, për shkak të marrëdhënieve të mira me Putinin, ka kundërshtuar gjithashtu kërkesën e amerikanëve për të shtuar prodhimin e naftës, ndërkohë që me rritjen e çmimit të saj gjatë këtyre pesë muajve sauditët kanë shtuar më shumë se dyfish përfitimet financiare.

Si përfundim, pavarësisht sanksioneve të forta ekonomike ndaj Rusisë, përsëri Europa edhe këtë dimër do të jetë në "mëshirën" e Rusisë sa i përket burimeve energjetike dhe ushqimore. Për këtë arsye, gjykoj se dimri i vitit 2022, urojmë të jetë dimri i fundit i raundit të fundit të kësaj lufte ekonomike midis: SHBA-ve dhe BE-së nga njëra anë dhe Rusisë nga ana tjetër. Putin nuk e pushton me armë Europën, por me mjete të tjera hibride 3D (dimër, donacion, drithë) dhe 3S (spionazh, subversion, sabotazh). Ai po vazhdon dhe nuk ka gjasa ta ndërpresë asnjëherë këtë luftë, sa kohë është në drejtimin e Federatës Ruse.

NËNË TEREZA,

gruaja e jashtëzakonshme,
shenjtorja e të varfërve të të gjithë botës,
e cila kurrë nuk e harroi origjinën e saj

Anjezë Gonxhe Bojaxhiu (zyrtarisht Mary Theresa Bojaxhi), lindur më 26 gusht 1910 në Shkup, ndërroi jetë më 5 shtator 1997 në Kalkutë, e njohur si Nënë Tereza e Kalkutës dhe e nderuar në kishën katolike si Shën Tereza e Kalkutës, ishte një murgeshë dhe misionare katolike indiane me prejardhje shqiptare.

Pasi jetoi në vendlindje për tetëmbëdhjetë vjet, ajo u shpërngul në Irlandë dhe më pas në Indi, ku jetoi pjesën më të madhe të jetës së saj.

Nënë Tereza themeloi Misionarët e Bamirësisë, një kongregacion katolik, i cili në vitin 2012 kishte më shumë se 4 500 motra dhe ishte aktiv në 133 shtete. Ato ofrojnë shtëpi për njerëzit që janë duke vdekur nga HIV/AIDS, lebra dhe tuberkulozi, ofrojnë ushqime, klinika të lëvizshme, programe këshilluese për fëmijët dhe familjet, jetimore, dhe shkolla. Anëtarët duhet t'i përmbahen betimit të "dëlirësisë, varfërisë dhe bindjes", si dhe një kusht të katërt, për të dhënë "shërbime falas e me gjithë zemër për më të varfrit e të varfërve". Nënë Tereza është nderuar me çmimet dhe nderimet më të larta, duke përfshirë: më 1962 Çmimin e Paqes "Ramon Magsaysay" dhe 1979 Çmimin "Nobel" për Paqe. Më 19 tetor 2003, ajo u lumturua dhe u quajt "Tereza e Bekuar e Kalkutës". Për t'u kanonizuar në shenjtorë, asaj duhej t'i njihej një mrekulli e dytë, në bazë të rregullave të kishës katolike. Një mrekulli e dytë i është njohur nga Papa Françesku, në dhjetor të vitit 2015, duke hapur rrugën që ajo të shpallet e shenjt nga Kisha Katolike e Romës. Kanonizimi i saj është bërë më 4 shtator 2016.

Një figurë e diskutueshme si gjatë jetës dhe pas vdekjes së saj

Nënë Tereza u admirua gjerësisht nga shumë njerëz për veprat e saj bamirëse. Ajo u vlerësua

dhe u kritikua për akuza të ndryshme, të tilla si për pikëpamjet e saj për abortin dhe kontracëpsionin. Ajo gjithashtu ka marrë kritika për kushtet në shtëpitë që ajo ofronte për të sëmurët në gjendje terminale. Biografia e saj e autorizuar u shkrua nga Navin Chawla dhe u botua në 1992, ajo ka qenë subjekt i filmave dhe librave të tjerë. Më 6 Shtator 2017, Tereza dhe Shën Françesk Saver u emëruan bashkë-mbrojtës të Arqipeshkvisë Katolike Romake të Kalkutës.

"Misionarët e Bamirësisë", e themeluar në vitin 1950 nga Nënë Tereza, e njohur si Shën Tereza e Kalkutës. Në vitin 2012 përbëhej nga mbi 4 500 motra fetare. Anëtarët e urdhrat caktojnë përkatësinë e tyre, duke përdorur inicialet e urdhrat, "MB" Një anëtar i kongregacionit duhet t'i përmbahet premtimeve të dëlirësisë, varfërisë, bindjes dhe betimit të katërt, për t'i dhënë "shërbim me gjithë zemër falas njerëzve më të varfër".

Misionarët kujdesen për ata që përfshihen si: refugjatë, ish-prostituta, të sëmurë mendorë, fëmijë të sëmurë, fëmijë të braktisur, të sëmurët nga lebra, njerëz me SIDA, të moshuar dhe konvulsion. Ata kanë shkolla që drejtohen nga vullnetarë të cilët kanë si qëllim për të mësuar fëmijë të braktisur në rrugë dhe për të drejtuar kuzhina ku shërbehet ushqim, si dhe shërbime të tjera sipas nevojave të komunitetit. Këto shërbime u ofrohen njerëzve pa marrë parasysh fenë ose statusin e tyre shoqëror.

Më 7 tetor 1950, Nënë Tereza dhe komuniteti i vogël i formuar nga ish-nxënësit e saj u etiketua si Kongregacioni Dioqezian i Dioqezës së Kalkutës, dhe kështu mori lejen nga Dioqeza e Kalkutës për t'u identifikuar si një organizatë katolike. Ato kanë 19 shtëpi vetëm në Kalkutë, të cilat përfshijnë shtëpi për gra, fëmijë jetimë dhe shtëpi për të sëmurët në gjendje terminale dhe për ata që vdesin nga SIDA; një shkollë për fëmijë të rrugës dhe një koloni të sëmurësh lebrose.



“Kam lindur në Shkup, jam shkolluar në Londër, jetoj në Kalkutë dhe punoj për të gjithë njerëzit e varfër në Botë. Atdheu im është një vend i vogël me emrin Shqipëri”.

Në vitin 1990, Nënë Tereza kërkoi të jepte dorëheqjen si kreu i Misionarëve, por shpejt u votua përsëri si Eprore e përgjithshme. Më 13 Mars 1997, gjashtë muaj para vdekjes së Nënë Terezës, Motra Mary Nirmala Joshi u zgjodh re Eprore e re e Përgjithshme e Misionarëve të Bamirësisë. Motra Mary Prema u zgjodh për të pasuar Motrën Nirmala gjatë një kapitulli të përgjithshëm të mbajtur në Kalkutë në prill 2009.

Më 10 shtator 1946, Tereza përjetoi atë që ajo e përshkroi më vonë si “thirrje brenda thirrjes”, kur udhëtoi me tren për në manastirin “Loreto” në Darjeeling nga Kalkuta për tërheqjen e saj vjetore. “Unë do të largohesha nga manastiri dhe t’i ndihmoja të varfrit ndërsa jetonim në mesin e tyre. Ishte një urdhër. Të dështosh do të ishte të prishësh besimin. Joseph Langford më vonë shkroi: “Megjithëse askush nuk e dinte atë kohë, Motra Terezë sapo ishte bërë Nënë Tereza”.

Ajo filloi punën si misionare me të varfrit në 1948, duke zëvendësuar zakonet e saj tradicional në “Loreto” me një sari të thjeshtë pambuku të bardhë me një skaje blu. Tereza mori nënshtetësinë indiane, kaloi disa muaj në Patna për të marrë trajnim bazë mjekësor në Spitalin e Familjes së Shenjtë dhe u fut në lagjet e varfra. Ajo themeloi një shkollë në Motijhil, Kalkutë, para se të fillonte të kujdeset për të varfrit dhe të uriturit. Në fillim të vitit 1949 Tereza u bashkua në përpjekjet e saj nga një grup i grave të reja dhe ajo hodhi themelet për një bashkësi të re fetare duke ndihmuar “më të varfrit midis të varfërve”.

Përpjekjet e saj shpejt tërhoqën vëmendjen e zyrtarëve indiane, përfshirë kryeministrin. Nënë Tereza

shkroi në ditarin e saj se viti i saj i parë ishte i mbushur me vështirësi pa të ardhura, ajo lypte për ushqime dhe furnizime dhe përjetoi dyshim në vetminë dhe tundimin për t’u kthyer në komoditetin e jetës së manastirit gjatë këtyre muajve të hershëm.

“Zoti ynë dëshiron që unë të jem një murgeshë e lirë e mbuluar me varfërinë e kryqit. Sot, mësova një mësim të mirë. Varfëria e të varfërve duhet të jetë aq e vështirë për ta. Ndërsa kërkoja një shtëpi, unë eca dhe eca derisa mu acaruan krahët dhe këmbët. Mendova se sa duhet të dhembin në trup dhe shpirt, duke kërkuar shtëpi, ushqim dhe shëndet.

Misionarët e Bamirësisë në sari-t tradicionale

Më 7 tetor 1950, Tereza mori lejen e Vatikanit për kongregacionin dioqezan, i cili do të bëhej “Misionarët e Bamirësisë”. Sipas fjalëve të saj, do të kujdesej për “të uriturit, të zhveshurit, të pastrehët, të gjymtuarit, të verbrit, të sëmurët nga lebra, për të gjithë ata njerëz që ndihen të padëshiruar, të pa dashur për të gjithë shoqërinë, njerëz që janë bërë barrë për shoqërinë dhe janë të turpëruar nga të gjithë”.

Në 1952, Tereza hapi bujtinën e saj të parë me ndihmën e zyrtarëve të Kalkutës. Ajo shndërroi një tempull Hindu të braktisur në Shtëpinë Kalighat, për të sëmurët në gjendje terminale, falas për të varfrit, dhe e quajti atë Kalighat, Shtëpia e Zemrës së Pastër (Nirmal Hriday). Ata që u sollën në shtëpi morën kujdes mjekësor dhe mundësinë për të vdekur me dinjitet në përputhje me besimin e tyre: Myslimanëve iu lexua Kuran, hindutë morën ujë nga Ganga dhe katolikët morën vajosje ekstreme. “Një vdekje e bukur”, - tha Tereza, - është për njerëzit që kanë jetuar si kafshë të vdesin si engjëj, të dashur dhe të kërkuar”.

Misionarët e Vëllezërve të Bamirësisë u themeluan në vitin 1963, dhe një degë lëvizëse e Motrave pasoi në 1976. Katolikë dhe jo katolikë u regjistruan si Bashkëpunëtorët e Nënë Terezës, Bashkëpunëtorët e të Sëmureve dhe Vuajtjeve, dhe Misionarë të Bamirësisë.

Deri në vitin 1997, kongregacioni 13-anëtarësh i Kalkutës ishte rritur në më shumë se 4 000 motra që menaxhonin jetimore, strehimore të të sëmureve me SIDA dhe qendra bamirësie në të gjithë botën, duke u kujdesur për refugjatët, të verbrit, njerëzit me aftësi të kufizuara, të moshuarit, alkoolistët, të varfrit, të pastrehët dhe viktimat e përmytjeve, epidemive dhe krizave të urisë. Deri në vitin 2007, Misionarët e Bamirësisë numëruan rreth 450 vëllezër dhe 5000 motra në të gjithë botën, duke operuar 600 misione, shkolla dhe strehimore në 120 vende.

Nënë Tereza ka thënë: "Me gjak, unë jam Shqiptare. Me nënshtetësi jam indiane. Me besim unë jam një murgeshë katolike. Sa i përket thirrjes sime, unë i përkas botës. Sa i përket zemrës time, unë i përkas plotësisht zemrës së Jezusit".

Ajo fliste rrjedhshëm pesë gjuhë: Bengalisht, Shqip, Serbisht, Anglisht dhe Hindisht, ajo bëri udhëtime të rastit jashtë Indisë për arsye humanitare.

Në kulmin e Rrethimit të Beirutit në 1982, Tereza shpëtoi 37 fëmijë të bllokuar në një spital, duke ndërmjetësuar një armëpushim të përkohshëm midis ushtrisë izraelite dhe guerileve palestinezë.

E shoqëruar nga punëtorët e Kryqit të Kuq, ajo udhëtoi nëpër zonën e luftës për në spital për të evakuuar pacientët e rinj.

Kur Europa Lindore përjetoi një rritje drejt hapjes me Perëndimin, në fund të viteve 1980, Tereza i zgjeroi përpjekjet e saj drejt vendeve komuniste që kishin refuzuar.

Misionarët e Bamirësisë

Ajo filloi dhjetëra projekte, e pavendosur nga kritikët për qëndrimet e saj kundër abortit dhe divorcit: "Pavarësisht se kush thotë çfarë, duhet ta pranosh me një buzëqeshje dhe të bësh punën tënde".

Ajo vizitoi Armeninë pas tërmetit të vitit 1988 dhe u takua me Nikolai Ryzhkov, Kryetar i Këshillit të Ministrave.

Tereza udhëtoi për të ndihmuar të uriturit në Etiopi, viktimat e rrezatimit në Çernobil dhe viktimat e tërmetit në Armeni. Në vitin 1991 ajo u kthye në Shqipëri për herë të parë, duke hapur një shtëpi të Misionarëve të Bamirësisë në Tiranë.

Deri në vitin 1996, Tereza ka operuar 517 misione në mbi 100 vende. Misionarët e saj të Bamirësisë u rritën nga dymbëdhjetë në mijëra, duke u shërbyer "më të varfërve mes të varfërve", në 450 qendra në të gjithë botën. Misionarët e parë të shtëpisë së bamirësisë në Shtetet e Bashkuara u krijuan në rajonin e South Bronx të New York City dhe më 1984 kongregacioni operoi 19 institucione në të gjithë vendin.

Ndarja nga jeta e Nënë Terezës

Nënë Tereza pati një sulm në zemër në Romë në 1983, ndërsa ajo ishte duke vizituar Papën Gjon Pali II.

Pas një sulmi të dytë në zemër në 1989, ajo mori një stimulues kardial artificial.

Në 1991, pas një periudhe me pneumoni në Meksikë, ajo pati probleme të tjera me zemrën. Edhe pse Tereza ofroi të jepte dorëheqjen si kreu i Misionarëve të Bamirësisë, me një votim të fshehtë motrat e kongregacionit votuan që ajo të qëndronte dhe ajo ra dakord të vazhdonte.

Në Prill 1996 ajo u rrëzua, duke thyer klavikulën e saj, dhe katër muaj më vonë ajo u sëmur me malarie dhe pësoi Infarkt në zemër. Edhe pse Tereza kishte bërë një operacion në zemër, shëndeti i saj ishte në rënie...

Më 13 Mars 1997 Tereza dha dorëheqjen si kreu i Misionarëve të Bamirësisë, ajo vdiq në 5 Shtator. Në kohën e vdekjes së saj, Nënë Tereza u shtrua në një repart në një arkivol të hapur në Shën Thomas, Kalkuta, për një javë para funeralit të saj. Asaj iu bë një funeral shtetëror nga qeveria indiane në shenjë mirënjohjeje për shërbimin e saj për të varfrit e të gjitha feve në vend. I ndihmuar nga pesë priftërinj, Sekretari i Kardinalit të Shtetit Angelo Sodano, përfaqësuesi i Papës, kreu ritet e fundit.

Vdekja e Nënë Terezës hidhëroi komunitetet laike dhe fetare. Kryeministri i Pakistanit Nawaz Sharif e quajti atë "Një njeri të rrallë dhe unik, e cila jetoi gjatë për qëllime më të larta. Përkushtimi i saj gjatë gjithë jetës për kujdesin ndaj të varfërve, të sëmureve dhe të pa favorizuarve ishte një nga shembujt më të lartë të shërbimit për njerëzimin."

Sipas ish-Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara Javier Pérez de Cuéllar, "Ajo është Kombet e Bashkuara. Ajo është paqe në botë".

Çmime dhe vlerësime ndërkombëtare

Tereza mori çmimin "Ramon Magsaysay" për Paqen dhe Mirëkuptimin Ndërkombëtar, dhënë për punë në Azinë Jugore ose Lindore, në 1962.

Bota katolike filloi ta nderonte Terezën publikisht. Papa Pali VI i dha asaj çmimin e Paqes "Gjoni XXIII" në 1971, duke lavdëruar punën e saj me të varfrit, shfaqjen e bamirësisë së krishterë dhe përpjekjet për paqen. Ajo mori çmimin "Pacem in Terris" në 1976.

Pas vdekjes së saj, Nënë Tereza përparoi me shpejtësi në rrugën drejt shenjtërimit. Ajo u nderua nga qeveritë dhe organizatat civile dhe u emërua një "Shoqëruese Nderi e Urdhrit të Australisë" në 1982, "për shërbimin ndaj komunitetit të Australisë dhe njerëzimit në përgjithësi". Mbretëria e Bashkuar i ka akorduar Nënë Terezës dekoratën më të lartë civile "Urdhrit të Meritës" nga vetë mbretëresha Elizabetë. Shtetet e Bashkuara të Amerikës e kanë dekoruar Nënë Terezën me tre medaljet më të larta: "Medaljen Presidenciale të Lirisë", titullin "Qytetare Nderi e Amerikës" dhe "Medaljen e Artë të Kongresit Amerikan". Ajo është Qytetare Nderi e Uashingtonit, Nju Jorkut, San Franciskos, Ohaios, Toledo, Bostonit dhe e shumë qyteteve të tjerë.

Në Shqipëri është krijuar Urdhri "Nënë Tereza", me të cilin janë dekoruar mjaft personalitete botërore si

ish-Presidenti amerikan Bill Clinton, gjenerali i NATO-s Ueslli Klark, Hillari Clinton etj. Nga Shqipëria Nënë Tereza është dekoruar me çmimin "Nderi i Kombit" dhe "Urdhri i Klasit I". Me emrin e shenjtores është emëruar aeroporti i Rinastit, Qendra Spitalore Universitare dhe sheshi para Universitetit Shtetëror të Tiranës.

Edhe në Kosovë janë ngritur tre përmendore të Nënë Terezës: Prishtinë, Gjakovë dhe Novoselë të Epërme. Në vitin 1990, ajo është shpallur Anëtare Nderi e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës.

India e ka dekoruar me titujt më të lartë të nderit si: "Margaritari i Indisë", "Lotuesi Madhështor", "Rair Gandhi" dhe çmimin "Nerhu" për paqen dhe mirëkuptimin ndërkombëtar.

Çmime të tjera civile përfshijnë çmimin "Balzan", nga Italia, për promovimin e njerëzimit, paqes dhe vëllazërimit midis popujve (1978), dhe Çmimin ndërkombëtar "Albert Schweitzer" (1975).

Në prill të vitit 1976 Nënë Tereza vizitoi Universitetin Scranton, në Pensilvaninë veriperëndimore, ku mori medaljen "La Storta" për Shërbimin Njerëzor nga presidenti i universitetit William J. Byron. Ajo sfidoi një audiencë prej 4 500 vetash për të "njohur njerëzit e varfër në shtëpitë e tyre dhe lagjen ku jetojnë", duke

varfërve", duke u thënë atyre "të bëjnë gjëra të vogla me shumë dashuri".

Por çmimi më i madh tokësor është Çmimi Nobel. Me 16 tetor 1979 i akordohet medalja e artë e Çmimit Nobel për Paqen dhënë nga Mbreti Olef V i Norvegjisë, në prani të 800 të ftuarve.

Ajo e refuzoi një banket ceremonial konvencional për laureatë, duke kërkuar që kostoja e tij prej 192 000 dollarësh t'u jepej të varfërve në Indi, dhe duke thënë se shpërblimet tokësore ishin të rëndësishme vetëm nëse e ndihmojnë atë për të ndihmuar nevojtarët e botës. Kur Tereza mori çmimin, ajo u pyet: "Çfarë mund të bëjmë për të promovuar paqen botërore?". Ajo u përgjigj: "Shkoni në shtëpi dhe duajeni familjen tuaj". Duke u bazuar në këtë temë në ligjëratën e saj për Çmimin Nobel, ajo tha: "Rreth botës, jo vetëm në vendet e varfra, por e gjeta varfërinë e Perëndimit shumë më të vështirë për t'u hequr. Kur marr një person nga rruga, të uritur, i jap një pjatë oriz, një copë bukë, e kam kënaqur. Unë e kam hequr atë uri. Por një person që është i mbyllur, që ndihet i padëshiruar, i padashur, i tmerruar, personi që është dëbuar nga shoqëria, se varfëria është aq shumë e lëndueshme, e shoh shumë të vështirë". Nënë Tereza veçoi abortin si "shkatërruesin më të



madh të paqes sot, sepse është një luftë kundër fëmijës, një vrasje e drejtpërdrejtë e fëmijës së pafajshëm, një vrasje nga vetë nëna. Nëse pranojmë që një nënë mund të vrasë edhe fëmijën e saj, si mund t'u themi njerëzve të tjerë që të mos vrasin njëri-tjetrin?"

Në Konferencën e Katërt Botërore për Gratë në Pekin, Tereza tha: "Sidoqoftë ne mund ta shkatërrojmë këtë dhuratë të amësisë, veçanërisht nga e keqja e abortit, por edhe duke menduar se gjërat e tjera si punët ose pozicionet janë më të rëndësishme se sa të duash".

Gjatë jetës së saj, Nënë Tereza ishte 18 herë mes 10 grave të para në sondazhin vjetor më të njohur "Gallup", duke rezultuar e para disa herë

ushqyer të tjerët ose thjesht duke përhapur gëzim dhe dashuri, dhe u shpreh: "Të varfrit do të na ndihmojnë të rritemi në shenjtëri, sepse ata janë Krishti në maskën e shqetësimit".

Në gusht 1987, gjatë një vizite në Scranton, Nënë Tereza mori titullin e nderit "Doktor i Shkencave Shoqërore", në njohje të shërbimit të saj për të ndihmuar të varfrit dhe të sëmurët. Ajo foli përpara 4 000 studentëve dhe anëtarëve të Dioqezës së "Scranton", për shërbimin e saj ndaj "më të varfërve mes të

në vitet 1980 dhe 1990. Në vitin 1999 ajo kryesoi Listën e Njerëzve më të Admiruar të Shekullit XX, duke lënë pas të gjitha përgjigjet e tjera vullnetare me një diferencë të gjerë, dhe ishte e para në të gjitha kategoritë kryesore demografike.

Një grua me trup të vogël por me madhështi dhe forcë të jashtëzakonshme për të çuar botën drejt së mirës, paqes dhe dashurisë.

Shenjtëruar emri dhe vepra jote Nënë Tereza, misionarja me fjalën e "rëndë si guri"!

“Ne ishim të parat”: Hapi ynë ushtarak u ndje në gjithë Tiranën

Intervistë me Vasilika (Babo) Topi, ish-oficere,
pjesë e kursit të parë të vajzave të FARSH

Intervistoi: MIMOZA GOLIKJA

Tashmë kanë kaluar 55 vjet, nga koha kur për herë të parë 70 vajza u përfshinë në Ushtrinë shqiptare. Ishte pikërisht viti 1967, kur ato kapërcyen portën e rëndë të Shkollës së Bashkuar, për t'u bërë pjesë e kursit të djemve 1967-1969. Duke thyer çdo tabu, çdo paragjykim dhe mentalitet të kohës ato përfaquan një nga profesionet më të veçanta dhe të vështira, të pa ushtruara më parë nga femra shqiptare, duke shënuar kështu historinë moderne të FA-së. Ne kontaktuam me njërin prej tyre, Vasilika (Babo) Topin, për ta sjellë atë në një intervistë në shtypin ushtarak.

Ajo, ashtu si shoqet e saj të kursit, sot është në pension, por nuk ka reshtur së ushtruar profesionin tjetër të dashur që e zhvilloi gjatë jetës. Ajo është një shkrimtare, që numëron në bibliotekën e saj 8 libra të botuar, ndërkohë që po punon për librin e saj të 9-të. Më poshtë intervista me znj. Vasilika (Babo) Topin ish-oficere, njëra prej 70 vajzave të kursit të parë të Shkollës së Bashkuar të oficerëve.

Znj. Vasilika, si ndjeheni sot, kur ktheheni pas 55 vjetësh këtu, në ambientin e garnizonit “Skënderbej”, ku keni kaluar vitet më të rëndësishme të jetës suaj? Çfarë e bëri të veçantë formimin tuaj ushtarak?

Jam vërtet shumë e emocionuar sa herë që vij në ambientet e garnizonit “Skënderbej”, por sot, pas 55 vjetësh emocioni është më i veçantë, në këtë aktivitet jubilar të organizuar. Ky emocion bëhet edhe më i madh kur kthen kokën pas dhe shikon që edhe pse vitet kanë kaluar dhe mjedisi këtu ka ndryshuar, kjo s'të pengon të ndjehesh si në shtëpi. Jeta është një dhuratë, të cilën na u dha mundësia ta shijojmë. Natyrisht ajo ka kënaqësitë e disfatat e saj. Jo të gjithëve ajo mund t'u dhurojë një jetë normale dhe jo të gjithë mund të vuajnë prej saj. Ndoshta është dhe fati që të ndjek pas dhe shqisat tona më të vjera janë luftëtare përkrah saj për t'i paraprirë gjithmonë së mirës.

Pra për mua dhe shoqet e mia pas viteve të shkollës, midis gjithë momenteve të bukura, që na dhuroi jeta ishte dhe bukuria e një profesioni të veçantë, pjesëmarrja në Forcat e Armatosura të vendit tonë, si një nga ndjesitë më të jashtëzakonshme, për brezat tanë, por dhe për ata që ishin para nesh, që e jetuan dhe kaluan në radhët e saj me uniformën e përkryer dhe aq të dashur ushtarake. Veçoria më dalluese qëndron në faktin se, jeta ushtarake përmban në brendësi të saj, jo vetëm përkushtimin, forcën, solidaritetin e ndërgjegjen e pastër, por ajo është një vazhdimësi e ruajtjes së këtyre virtyteve, dashurisë e miqësisë të lindur me njeri-tjetrin, në jetën e momente të përbashkëta që kalojmë. Dhe sot është kënaqësi kur sheh vajzat e reja që ndjekin këtë shkollë, por është kënaqësi gjithashtu kur ndjen respektin dhe dashurinë e tyre për ne, brezin e parë të femrave ushtarake.

Si vendosët të ndiqnit në atë kohë, një rrugëtim jo të zakonshëm, siç është ai ushtarak, për një vajzë që do të vazhdojë studimet e larta?

Të them të vërtetën unë nuk e dija për shkollën ushtarake atëherë, nëse do të pranoheshin vajza ose jo. Kisha kërkuar të studioja në një nga tre degët, që ishin letërsia, gjuhë e huaj ose mjekësi. Më doli letërsia. Por ishte babai im ai që kishte dëshirë të shkoja me studime në Shkollën e Bashkuar, si veteran i luftës që ishte, ku dhe ishte plagosur. Ai më tha se “në vendin tim ka shumë profesione, por ky profesion ishte i veçantë dhe trajtimi juaj do të jetë i veçantë. Unë mendoj të shkosh të provosh këtë sfidë të jetës”.

Kështu Shkolla e Bashkuar u bë ëndrra ime. Atdhëdashuria, historia e popullit tonë dhe trimëritë e heroinave shqiptare më frymëzonin. Prandaj e quajta veten me fat që më doli e drejta e studimit për shkollën e lartë që e doja, kështu u bëra pjesë, unë vija nga Korça. Ne, 70 vajzat e para ushtarake, u gjendëm në radhët e ushtrisë, si një gjerdan i bukur që zbukuroi këtë fushë të blertë të historisë sonë me edukimin e përsosur ushtarak, politik e shoqëror të saj por dhe me thyerjen e mjaft koncepteve të vjetra të asaj kohe. Ishte ky edukim, që na mbajti të lidhura ngushtë në gjerdanin e saj të artë, me bukurinë, mirësinë, dashurinë e sinqeritetin reciprok, jo vetëm midis nesh, por edhe me gjithë kuadrot dhe eprorët tanë të asaj



kohe, por dhe me gjithë ata bij e bija që me mish e me shpirt u përkushtuan dhe u betuan për të falur dhe jetën për atdheun dhe popullin. Kjo ishte një nga vlerat e parimet më të mëdha të asaj kohe, ndërgjegjësimi absolut për të mirën e popullit dhe të kombit, vlera për të cilat ka nevojë jeta, duke edukuar çdo brez të rinjsh dhe gjithë gjeneratat e saj edhe në ditët e sotme.

Si ishte të studioje në një shkollë që për traditë ishte e dominuar vetëm nga djemtë, por dhe aq më tepër për mentalitetin shqiptar, dhe jo vetëm?

Sot, mendoj se ishte një transformim shumë i rëndësishëm, ajo që ndodhi në ushtrinë shqiptare, por edhe me ne. Në atë kohë po ndodhnin shumë transformime për femrën shqiptare. Ne, ishim 70 vajzat e para në vitet 1967-1969, vajza që thyem tabutë, çdo mentalitet të huaj shqiptar, duke përqafuar një nga profesionet e pa ushtruara më parë nga femra shqiptare. Pranë nesh qëndruan kuadro nga instanca të larta të kohës, për të na shërbyer e edukuar ashtu si duhet. I kujtoj me respekt të gjithë pedagogët e asaj kohe, të cilët nuk po i përmend dot të gjithë, por shumë pranë nesh qëndruan komandanti Jani Spiro, si një drejtues por dhe një prind i vërtetë dhe zëvendëskomandanti i Kompanisë, oficer Robert Topi. Më kujtohen vazhdimisht fjalët e këtij të fundit, i cili u mundua të flasë para kamerës dy ditë para vdekjes, në një gjendje shumë të rëndë me respektin më të madh për ato vajza, të cilat i mësoi e mbajti pranë për mbarëvajtjen sa më të lartë të tyre në çdo drejtim, duke kryer kështu një nga detyrat më të vështira dhe më serioze të asaj kohe, përgatitjen e femrës shqiptare në çdo standard të jetës ushtarake. "Unë, - theksoi ai, - kalova jetën time në

shumë funksione në radhët e Forcave të Armatosura deri në gradën kolonel, por funksioni më i bukur që kam kaluar në jetë, është bashkëpunimi me vajzat e para ushtarake. Ato erdhën si zana malesh nga bjeshkët shqiptare, nga malësitë e veriut apo dhe si trimëreshat e kështjellave legjendare të Shqipërisë së jugut. Erdhën si flutura të bukura e të qeta, me dashuri e ëmbëlsi shpirtërore, me guxim, vendosmëri e krenari, për të kryer gjithë detyrat që u caktoheshin, deri në dhënien e jetës në rininë e tyre". Ti vendosje këto vajza, - shton ai, - nën diktatin e jetës ushtarake, do të thoshte të ndryshojë pak a shumë karakterin e tyre femëror, në një karakter të fortë burrëror, do të thoshte t'i vendosje nën një disiplinë të padiskutueshme të pa zbatuar më parë në qenien femërore, për zbatim të çdo urdhri ushtarak me orar dhe pa orar, duke ndryshuar kështu delikatesën femërore, por njëkohësisht duke ndikuar dhe në anën fiziologjike, fizike e shpirtërore të tyre. Veshja e uniformës ushtarake, e cila do të mbahej veshur gjatë gjithë kohës dhe jashtë ambienteve të shkollës, për t'i dhënë popullit të kuptonte se Shqipëria po ecte në një rrugë që ishte pasardhëse e Ushtrisë Nacionalçlirimtare, por më efektive, femra në pjesëmarrje, ishte një subjekt më vete. Ajo në atë kohë zëvendësoi fustanin e bardhë të nusërisë të atyre vajzave, që u ndalua të vishej, duke ia dhuruar atdheut këtë dukuri e simbol të bukur të jetës së tyre. Të gjitha këto ishin barriera të forta për t'i bërë ballë forcës e shpirtit të tyre femëror. Por pavarësisht nga këto pengesa dhe pavarësisht se ne vinim nga krahina të ndryshme e mentalitete të ndryshme, secila prej nesh pasqyrore një veti karakteri më të mirë se tjetra.

Si ishin orët e stërvitjes për ju? A ishte e vështirë që 70 vajzat të stërviteshin e përgatiteshin njëlloj si djemtë, duke pasur parasysh kushtet fizike specifike që kërkon kjo shkollë?

Ne ishim në krah të shokëve, në krah të studentëve djem, kur bëhet fjalë për stërvitjen dhe orët e taktikës. Ne nuk donim privilegje, kishim sedër dhe donim që rezultatet tona të ishin reale. Ne përpiqeshim të pasqyronim një shpirt luftarak më të pamposhtur në rreshtat ushtarakë e detyrat e ngarkuara dhe kjo na bënte të dallonin nga femrat e tjera që ndodheshin jashtë këtij profesioni, në fakultetet civile, e them këtë pasi ato nuk provuan të mbajnë këtë peshë mbi supet e tyre jo vetëm delikate, por edhe me shpirtin e brishtë, që janë karakteristikat e një femre. Një forcë e çuditshme, por edhe e bukur dhe magjepsëse ekzistonte në shpirtin tonë pavarësisht se kujt toge i përkisnim, duke mbajtur deri armatime të rënda mbi supe e mbi trupin delikat, por që ishte stërvitja e vazhdueshme që do të na bënte të mos e ndjenim këtë peshë fizike. Tashmë jeta jonë nuk i përkiste vetëm familjes së prindërve tanë por, nëpërmjet betimit ushtarak, jeta jonë i përkiste Atdheut, popullit, i përkiste gjithë Shqipërisë dhe kjo ishte sa sublime por dhe aq frymëzuese. Ne u munduam të ruanim virtytet më të mira të prindërve tanë, si pastërtinë femërore, sinqeritetin, dashurinë, modestinë, besnikërinë, bashkëpunimin midis eprorëve, por veçanërisht me njëra-tjetrën, duke i bërë ballë me krenari e vendosmëri e papërkulshmëri, kudo në poligonet e qitjes, në transhe, në lojërat më të vështira në shi, breshër e borë, që lagu trupin tonë deri në palcë. Shpesh na mbeteshin shenja nga pesha e armës, gjerdani me fishekët e rëndë në krah, apo dhe me kundërgazin në fytyrën e bukur e të freskët, por asnjëherë nuk u ankuam se ne e kishim zgjedhur vetë rrugën tonë. Hapi ynë ushtarak u ndje në mensë, bujtinë e në sheshet e Shkollës së Bashkuar, në gjithë Tiranën nga



mëngjesi deri në mbrëmje, në kthimet nga marshimet me këngë në gojë si zogjtë me ligjërimet e cicërimat e tyre. Çdo ditë ndjeheshim më të forta e më të gjallëruara dhe e shprehnim këtë në këngët e marshet kur ktheheshim nga stërvitja. Ishim ne, vajzat me zë më të fortë e të bukur që i jepnim energjinë tonë këngëve të bukura ushtarake me intonacione të forta por zërin e ëmbël shpirtëror të vajzës shqiptare.

Znj. Vasilika, kemi parë se disa nga 70 kursantet e para, kanë shkruar poezi, madje disa nga ju vazhdojnë ende të shkruajnë. Nga buronte gjithë ky frymëzim? Ishte një peng i mbetur nga përzgjedhja që kishit bërë për studimet, apo çfarë?

Çdo ditë e jona ishte një ditë frymëzuese. Kështu ishte atëherë për ne, me gjithë moshën e re që kishim, por edhe sot tekta kujtoj të njëjtë gjë them. Gjithçka ishte frymëzuese, që nga zgjimi në mëngjes dhe gjithçka në atë që ishte e programuar, siç mund të jetë një shkollim ushtarak. Këto e gjithçka që i përkiste jetës sonë në ushtri, ishin pjesë e krenarisë sonë të përbashkët, ishin pjesë e një jete në një familje të madhe, me vuajtje e sakrifica të përbashkëta, me ëndrra e vitalitet të paparë, me dashuri pa urrejtje, pa hipokrizi, por me një buzëqeshje të pastër e të dëlirë, me forcë e kurajë, pavarësisht konditave të asaj kohe, të pa krijuara plotësisht për ne.

Ja pra këto ide, këto ideale na frymëzuan dhe ruhen akoma dhe sot në shpirtin tonë, duke i trashëguar dhe në moshën tonë me njëra-tjetrën në profesionin që ndoqëm me funksionet tona personale nëpër rrethe ku shërbyem. E vërtetë, disa nga ne e hodhën në letër, në vargje e poezi, atë eksperiencë unike që po kalonim, eksperiencën e një rruge që po e hapnim ne të parat. Madje një pjesë e mirë e jona ndoqën edhe më lart degë universitetesh dhe njëkohësisht çuan më lart karrierën e tyre ushtarake, deri në gradën "Kolonel", më të cilën krenohemi. Një pjesë tjetër e rrëmben rryma e letërsisë edhe pa studiuar letërsi si Merita Caci, Julia Naci, unë e Lida Rapo (Grazhdani) me librin e saj të bukur e të veçantë me titullin "Pesha e uniformës ushtarake", e cila përmban jo vetëm peshën fizike të saj, por mbi të gjitha peshën shpirtërore të femrës, të përballur me jetën e asaj kohe, ku u shkrua shumë pak, pothuajse fare për sakrificat e tyre.

Po më tej, si vazhduat ju pas proceseve demokratike të viteve '90, që sigurisht u përfshi dhe ushtria? Ju kemi parë shpesh të përfshirë në aktivitete të ndryshme, si ecët më tej me profesionin, pasionin për të shkruar?

Pas proceseve demokratike dhe reformat që pasuan në ushtri, disa nga vajzat, si shumë ushtarake të tjerë, dolën në lirim. Disa u larguan jashtë vendit. Unë dhe im shoq, të dy oficerë, dolëm në lirim dhe si shumë prej ushtarakëve provuam edhe emigrimin. Kjo ishte një peshë tjetër e dyfishtë, me më shumë vuajtje të tjera, me dhimbje e lot, të cilën jam munduar ta pasqyroj në 4 librat e mi, si tregues të forcës ushtarake të bashkëshortëve tanë, por më tepër të forcës femërore nga koha e plagët e tranzicionit deri tani. Kam shkruar 8 libra. Por vendin më të rëndësishëm në librat e mi ia kam dedikuar jetës së bukur ushtarake, poezive për shoqet e mia, për atë miqësi të pathyeshme që vazhdon deri sot e ruhet nëpërmjet internetit, jo vetëm me to, por dhe me brezat

paraardhës të çdo gjinie dhe me brezat pasardhës, shokë e shoqe që kanë kontribuar në ushtri. Unë ende vazhdoj e shkruaj. Tani kam në dorë një libër për jetën e bashkëshortit tim ushtarak, me mendimet dhe opinionet e shokëve dhe kuadrove me të cilët ai bashkëpunoi gjatë karrierës së tij.

Dua t'u uroj suksese të gjitha grave, femrave shqiptare që ndoqën rrugën tonë dhe sot arritën majat më të larta në ushtrinë shqiptare dhe në botë, gjatë 50 viteve të tjera pas nesh. Gjej rastin të falënderoj dy autorët e dy botimeve, për ushtarakët "Femra ushtarake në rrjedhën e viteve", oficerët z. Kujtim Boriçi dhe znj. Suzana Jahollari për këtë iniciativë të guximshme e me vlera historike dhe letrare në Ushtrinë tonë, sepse ato do t'u mbeten kujtim dhe fëmijëve të vajzave ushtarake, që sot nuk jetojnë më dhe që nuk patën mundësinë të ndjenin kënaqësinë e kësaj kohe. Me këtë rast dua të kujtoj me nderim e respekt ato vajza flamurtare të asaj kohe, të pamposhtura dhe të paharruara në zemrën tonë, që shërbyen me nder e dinjitet si, Doloreza Xhaxhiu, Eliana Dhima, Kalie Llupo, Kristina Andoni, Natasha Nasto, Nevreska Devolli, Zhaneta Tanellari, e Violeta Thimjo. Dhe këto dy ditët e fundit një kolege financiere, emrin e së cilës nuk mund ta përmend përkohësisht. I paharruar kujtimi i tyre!

Po njëkohësisht falënderoj nga zemra organizatorët që krijuan dokumentarin "Ato ishin të parat", të realizuar nga anëtarët e shoqatës me bordin drejtues në krye të SHKURSH, ku iniciatore u bë një nga shoqet tona të mirënjohura dhe të respektuara me përvojë ushtarake, pedagoge e Taktikës e Filozofisë në Shkollën e Bashkuar, znj. Liliana Konomi Mero. Me bëri përshtypje fjala e gjeneral Manushaqe Shehut, e cila pavarësisht nga arritjet e sukseset e saj të panumërta, përmendi në diskutimin e saj aq bukur e me modesti fjalët: "Ne u rritëm me hapat tuaja dhe ecëm me to në rrugën tonë". Ishte një ndjenjë e këndshme, e bukur në zemrën tonë, e lindur nga këto fjalë me dashuri të koleges sonë ushtarake, e cila të shëtit në hapësirë, në horizonte të reja, duke menduar se sa bukur është të dhurosh nga jeta jote, shpirti yt gjithçka që i shërben së ardhmes, duke menduar se ky popull ka nevojë për ndershmeri e përkushtim, pa interes e përfitim, pa u korruptuar dhe diskretuar, por me përkushtim e ndërgjegje të pastër që të transmetohet brez pas brezi.

Edhe njëherë suksese pasardhëseve tona, që sakrificat e tyre të shkruhen në rrjedhën e historisë, duke u bërë flamurtare të denja për të mirën e lirinë e vërtetë të këtij populli të munduar e të shumëvuajtur!

Si do të përparojë TEKNOLOGJIA DERI NË VITIN 2050

Deri në vitin 2050, kompanitë e mëdha të teknologjisë do të kenë nisur projekte zyrtare për të zhvilluar inteligjencën e parë artificiale të përgjithshme në botë. Miliarda dollarë do të investohen në këto projekte dhe një staf i madh me kohë të plotë do t'i përkushtohet kësaj përpjekjeje. Këto projekte shumë komplekse pritet të zgjasin nga 10 deri në 20 vjet për t'u përfunduar.

Shkencëtarët dhe inxhinierët po kuptojnë se si të modelojnë faktorë të tillë si: Kreativiteti i qëllimshëm; Të menduarit strategjik; Emocionet; Arsytimi i ras-tësishëm; Mendje e shëndoshë; Të menduarit kundër fakteve; Vetëdija.

Rasti i menjëhershëm i përdorimit është të kesh një Inteligjencë Artificiale (Artificial Intelligence - AI) të vetëdijshme, me të cilën institucionet mund të konsultohen për të zgjidhur problemet që më parë konsideroheshin të pamundura.

Një rast tjetër përdorimi përfshin transferimin e kopjeve të kësaj Intelligence Artificiale te robotët humanoidë të avancuar që mund të trajtojnë situata të ndryshme në botën reale.

Ky zhvillim parashikohet të çojë në teknologji që nuk dallohen nga magjia në dekadat e ardhshme, veçanërisht kur kombinohen me fuqinë llogaritëse në rritje eksponenciale të kompjuterëve klasikë dhe kuantikë. Megjithatë, ajo e lë të hapur derën për një AI super inteligjente që është duke u zhvilluar nga fundi i shekullit. Nuk ka asnjë kufi të realizueshëm se sa inteligjente mund të bëhet kjo AI. Një AI e tillë mund të jetë më e zgjuar se të gjithë njerëzit që kanë jetuar ndonjëherë në planetin tokë. Menjëherë pas kësaj, ajo mund të bëhet trilionë herë më inteligjente se kaq.

Robotë të ngjashëm me njeriun

Në vitin 2050, robotët do të kenë aftësinë për të zotëruar mjediset e botës reale dhe një gamë gjithnjë e më të larmishme objektesh 3D. Ata mund të përshtaten me situata të reja dhe të zgjidhin probleme gjithnjë e më dinamike. Ata mund të mësojnë nga përvojat e tyre dhe të ndajnë njohuri me njëri-tjetrin për shkak të shpejtësisë



së internetit me valë mijëra herë më të shpejta se 6G dhe sasive në rritje eksponenciale të të dhënave që mblihen nga sensorët e tyre.

Këta robotë mund të identifikojnë objektet, situatat dhe veprimet që duhet të kryejnë më pas në pothuajse kohë reale, gjë që mundëson një përgjigje më të ngjashme me njeriun. Edhe pse ende mbeten disa pengesa teknologjike dhe shkencore, kjo po i afrohet asaj që shumë njerëz do ta konsideronin inteligjencën e përgjithshme artificiale.

Robotët më të avancuar do të jenë të kufizuar në institucionet qeveritare, korporative dhe kërkimore dhe familjet e të pasurve dhe të famshmeve. Përveç aftësisë njohëse, këta robotë më të avancuar do të kenë pamje jashtëzakonisht të gjallë, shprehje të fytyrës dhe gjuhën e trupit. Falë reaguesve të vazhdueshme emocionale nga përdoruesit dhe teknikave të tilla si kapja e lëvizjes dhe rrjetet gjeneruese kundërshtarë, këta robotë pothuajse do të duken dhe veprojnë si njerëz të vërtetë. Dhe ndërsa më shumë të dhëna do t'u jepen këtyre robotëve, gjuha e trupit dhe lëvizjet e tyre do të bëhen më të natyrshme me çdo brez.

Kockat e printuara 3D dhe materialet e reja të zhvilluara për lëkurën dhe muskujt, sy dhe dhëmbë më fleksibël do të ndihmojnë që robotët humanoidë të duken sa më shumë si njerëz që të jetë e mundur.

Për më tepër, modelet më pak të avancuara do të jenë relativisht të zakonshme në shoqëri. Ata do të jenë të popullarizuar mes njerëzve në grupet me të ardhura të mesme - të larta dhe do të jenë të ngjashme në kosto me një makinë të dytë ose një blerje të ngjashme të madhe. Funkcionet e tyre do të përfshijnë punët e shtëpisë si pastrimi, gatimi dhe rregullimi, si dhe kujdesi për fëmijët dhe anëtarët e moshuar të familjes.

Qytetet "smart"

Në vitin 2050, një përqindje e vogël e qyteteve në disa rajone do të jenë bërë qytete "smart". Këto qytete inteligjente do të lidhin automjetet në rrugë me një rrjet qendror që gjurmon vendndodhjet e tyre në kohë reale. Këto lloj rrjetesh marrin terabajtë me informacion nga një numër i madh burimesh si sensorët e rrugëve, semaforët, e kështu me radhë. Këto burime ofrojnë informacione të tilla si numri i makinave në rrugë, bllokimet e rrugëve, modelet e motit, shërbimet e gjendjes së emergjencës dhe më shumë.

Automjetet autonome në rrugë do të komunikojnë dhe do të koordinohen vazhdimisht me njëra-tjetrën për të optimizuar fluksin e trafikut në këto qytete. Falë këtij shkëmbimi të koordinuar informacioni, bllokimet e trafikut do të jenë bërë shumë më pak të rënda në qytetet e mëdha. Mjetet autonome do të lëvizin pas njëra-tjetrës në një distancë prej vetëm 20 centimetrash, gjë që kursen hapësirë në rrugë. Dhe për shkak të këtij koordinimi, automjetet autonome bëjnë kthesa në kryqëzime me shpejtësi pothuajse të plotë me një probabilitet të ulët të aksidenteve.

Parkimi manual i automjeteve do të jetë një gjë e së kaluarës për pronarët e automjeteve autonome. Automjetet autonome mund të programohen për t'i lënë pronarët e tyre diku dhe më pas të kërkojnë për vendet më të lira dhe të disponueshme të parkimit brenda një qyteti. Në një kohë të caktuar, automjetet do të kthehen të marrin pronarët e tyre.

Automjetet autonome gjithashtu mund të kontrollohen nga distanca, duke përdorur pajisje të realitetit virtual. Kjo ndihmon në situata unike që AI nuk është në gjendje t'i trajtojë vetë, siç janë fatkeqësitë e papritura natyrore.

Ndërfaqet tru-kompjuter do të jenë përmirësuar

Në vitin 2050, ndërfaqet tru-kompjuter do të jenë përmirësuar shumë në krahasim me versionet e vitit 2030 dhe ato do të jenë kryesisht të përdorshme për qëllime të përditshme. Shiritat e kokës dhe shiritat e kyçit të dorës me sensorë jo invazivë do të jenë bërë zgjedhjet e preferuara për përdorimin e zakonshëm të ndërfaqes tru-kompjuter. Këto ndërfaqe do të jenë zakonisht aksesore standardë për kufjet e realitetit virtual, duke përfshirë helmetat VR (Virtual Reality) me çmim të lartë që ofrojnë përvoja të plota të zhytjes në VR. Disa ndërfaqe truri-kompjuter do të jenë plotësisht të implantueshme për qëllime mjekësore dhe ushtarake.

Ndërfaqet tru-kompjuter do të ofrojnë një shkëmbim

informacioni dydrejtimësh. Këto ndërfaqe nervore të avancuara dërgojnë valë në tru, duke transmetuar ndjesi vizuale, audio dhe të tjera tek përdoruesi. Imazhet dhe përvojat e krijuara nga këto pajisje janë pothuajse të padallueshme nga realiteti dhe ato janë unike për çdo përdorues, sepse varen nga struktura e trurit.

Kur bëhet fjalë për argëtimin, njerëzit do të mund të përdorin ndërfaqet tru-kompjuter për të kontrolluar objektet në video-lojërat dhe mjediset virtuale me saktësi të lartë.

Për më tepër, këto pajisje do të lejojnë njerëzit në lojëra dhe përvoja të VR të komunikojnë me njëri-tjetrin duke përdorur mendime relativisht të thjeshta. Megjithatë, do të duhen disa dekada të tjera përpara se kjo veçori të rafinohet.

Ashensorët hapësinorë

Në vitin 2050, do të jenë ndërtuar dy ashensorë hapësinorë dhe që do të jenë projektet më të mëdha inxhinierike të ndërmarrja ndonjëherë.

Këta ashensorë hapësinorë janë sisteme transporti nga planeti në hapësirë, secili prej tyre ka një kablo të ankoruar në sipërfaqen e tokës dhe që shtrihet në hapësirë. Ky dizajn do të lejojë që një ashensor të udhëtojë përgjatë kabllos direkt në orbitë, pa përdorimin e raketave të mëdha. Ato do të jenë të vendosura pranë ekuatorit të tokës dhe forcat konkurruese të gravitetit dhe forcës centrifugale të jashtme do t'i mbajnë kabllo nën tension. Materiali i përdorur për krijimin e kabllove do të jenë nanotubat e karbonit, të cilët janë të lehtë dhe qindra herë më të fortë se çeliku. Këta ashensorë hapësinorë do të përdoren shpesh nga institucionet për të dërguar ngarkesën në hapësirë dhe për të kthyer ngarkesën në tokë. Ata do të jenë gjithashtu të aftë të transportojnë astronautë dhe turistë në stacione hapësinore me orbitë të ulët.

Turizmi hapësinor

Sipas "Business Insider", turizmi hapësinor mund të jetë i realizueshëm në vitin 2050, por ka të ngjarë vetëm për ata që janë shumë të pasur. Kompanitë e raketave si "Blue Origin" e Jeff Bezo-s dhe "SpaceX" e Elon Musk do ta shtyjnë rezervimin për udhëtimin në hapësirë deri sa turizmi të jetë i realizueshëm në vitin 2050. Për shembull, dikush që mund të përballojë të paguajë 100 milionë dollarë mund të kalojë një javë në orbitë... por do të ishte vetëm për njerëzit e pasur në vitin 2050.

Marsi do të ketë një prani të përhershme njerëzore

Në vitin 2050, një ekip i përhershëm shkencëtarësh dhe inxhinierësh robotikë do të jetë i pranishëm në Mars. "SpaceX" po udhëheq pjesën më të madhe të kësaj përpjekjeje. Dhe do të kenë shkuar edhe turistët e parë civilë.

Inovacione të rëndësishme në sistemet autonome robotike të minierave janë të nevojshme përpara se njeriu i parë të vërë këmbën në Mars. Robotët autonomë të minierave do të minojnë dhe krijojnë ujë. Robotët autonomë gjithashtu do të nxjerrin hidrogjen nga uji për të krijuar karburant me bazë hidrogjeni. Dhe satelitët që përmbajnë panele diellore rreth Marsit do të sigurojnë energji edhe për bazën e Marsit.

Kjo bazë së shpejti do të zgjerohet me objekte shtesë që ofrojnë më shumë energji, prodhim ushqimi, sisteme riciklimi, pajisje minerare dhe mjete të tjera. Automjetet furnizohen gjithashtu, duke u mundësuar shkencëtarëve të bredhin qindra milje.

Syzet VR do të zëvendësojnë telefonat inteligjentë

Kufjet e realitetit virtual në vitin 2050 do të kenë rezolucion 16k dhe do të jenë zvogëluar në madhësi aq shumë saqë do të ngjajnë me syze. Ato do të kenë mënyra të shumta të shfaqjes. Këto mënyra të shfaqjes përfshijnë: Modaliteti i realitetit të shtuar lejon që lentet të jenë transparente në mënyrë që të mund të shikoni hologramet; Modaliteti i realitetit të përzier lejon që lentet të jenë gjithashtu transparente në mënyrë që të mund të shikoni objekte virtuale hiper-realiste në botën reale që duket se u binden ligjeve të fizikës; Modaliteti i realitetit virtual ka një shtresë të errët argjendi mbi syze, në mënyrë që të mund të zhyteni plotësisht në një botë virtuale

Në mënyrat e realitetit të shtuar dhe të përzier, mund të shikoni një transmetim inteligjent ku mund të manipuloni shumë aplikacione dhe skedarë duke përdorur aktivitetin tuaj të trurit. Është për shkak të këtyre veçorive që syzet VR konsiderohen si hapi tjetër i evolucionit pas smartfonëve. Megjithatë, shumë njerëz do të vazhdojnë të preferojnë telefonat inteligjentë. Lentet e kontaktit VR dhe realiteti i shtuar janë fusha të tjera që do të adoptohen gradualisht.

Realiteti i shtuar dhe i përzier do të jetë kudo

Qytete të tëra do të jenë kthyer në zona të realitetit të shtuar, të cilat mund të përjetohen duke përdorur syze, lente ose pajisje të tjera të realitetit të shtuar. Mbivendosjet e realitetit të shtuar për vendndodhjen specifike do të krijohen nga korporata dhe krijues individualë. Peizazhet urbane do të jenë të mbushura me informacione të të gjitha llojeve, të cilat do të mund të filtrohen sipas nevojës duke përdorur aplikacione të realitetit të shtuar.

Etiketat e çmimeve në dyqane, menutë në restorante dhe oraret në stacionet e transportit publik do të jenë bërë të gjitha virtuale.

Do të jetë bërë gjithashtu i zakonshëm përdorimi i realitetit të shtuar për të aksesuar navigimin nga një vend në tjetrin, për të marrë komente për institucionet aty pranë dhe për të parë animacione dhe video të dukshme 3D të ngjarjeve të kaluara në vende të caktuara.

Në vitin 2050, video-lojërat do të jenë fotorealiste

Video lojërat po bëhen tepër realiste. Përparimet në motorët e lojërave dhe softuerët për ndërtimin e botës e bëjnë më të lehtë dhe më të shpejtë se kurrë për studiot e lojërave dhe krijuesit e pavarur që të ndërtojnë botë virtuale të mëdha dhe realiste. Qytetet brenda këtyre botëve do të jenë plotësisht të eksplorueshme.

Krijuesit e avancuar të personazheve do ta bëjnë relativisht të lehtë ndërtimin e qindra personazheve unikë, të paluajtshëm në një kohë që secili do të ketë një personalitet unik dhe histori jete.

Rrjetet gjeneruese kundërshtare (GANs) mund të gjenerojnë një larmi pothuajse të pafund të çdo atributi fizik

si fytyrat, flokët, llojet e trupit dhe veshjet. Kjo do të jetë bërë e mundur për shkak të sasive të mëdha të të dhënave vizuale që do të furnizohen në këto rrjete. Kjo teknikë do të përmirësojë gjithashtu gjestet, shprehjet dhe veprimet e personazheve, duke i bërë ato më të gjalla. Në këtë fazë, animacionet e personazheve nuk do të jenë ende 100% realiste, por do të jenë tepër afër.

Asistentët virtualë do të kenë zëvendësuar kryesisht motorët e kërkimit

Shumë përpara vitit 2050, shumica e njerëzve në tokë do të kenë akses në një asistent virtual. I njëjti asistent virtual mund të jetë i disponueshëm si një hologram i realitetit të shtuar, karakter i realitetit virtual dhe robot shtëpiak. Dhe i njëjti asistent virtual mund të jetë i disponueshëm si zë në një shtëpi "smart", brenda një automjeti, nga një orë "smart" dhe nga një smartphone.

Këta asistentë virtualë do të jenë trajnuar mbi të dhënat e tekstit nga shumica e faqeve të internetit dhe publikimeve të krijuara në historinë njerëzore. Kështu që ata do të mund t'i përgjigjen pothuajse çdo pyetjeje që ne do t'i bëjmë. Dhe përgjigjet e tyre do të jenë të personalizuar bazuar në qëllimet, interesat përkatëse.

Ata vazhdimisht do të parashikojnë se çfarë mund të duam të bëjmë më pas dhe do të bëjnë sugjerime gjatë çdo dite në vend që ne të na duhet të shkruajmë fraza në motorët e kërkimit. Sa herë që ne kërkojmë për informacion, ata gjithmonë bëjnë sugjerime shtesë që janë të lidhura në mënyrë të paqartë me pyetjet tona për të na ndihmuar të marrim perspektiva të dobishme që nuk i kemi konsideruar kurrë.

Ne gjithashtu do të mund të personalizojmë paraqitjet, zërat dhe aftësitë e veçanta të këtyre asistentëve virtualë.

Në dekadat e ardhshme, inteligjenca e përgjithshme artificiale do ta çojë këtë teknologji në një nivel tjetër.

Një person mesatar do të ketë qasje në teknologjinë kuantike kompjuterike

Për 10-15 vitet e fundit, kompanitë e teknologjisë do të kenë ofruar teknologji të informatikës kuantike me shërbimet e tyre cloud me një kosto të moderuar deri në të lartë. Kompjuterët dhe serverët personalë do të përmbajnë gjithashtu një hibrid të teknologjisë kompjuterike klasike dhe kuantike ose një nga ato teknologji. Teknologjia kuantike do të jetë shumë më e shtrenjtë.

Kompanitë dhe individët do të përdorin teknologjinë kuantike për: të modeluar ndërveprimet e molekulave dhe atomeve; për të shpikur materiale të reja; për të krijuar objekte virtuale komplekse që janë të vështira për t'u konceptuar nga njerëzit; për të zhvilluar ilaçe të fuqishme; për të zhvilluar bateri të automjeteve elektrike me rreze të lartë që i bëjnë automjetet me bazë benzine të vjetruara.

Disa organizata do të përdorin kompjuterët kuantikë më të avancuar në botë për të simuluar nga afër proceset e trurit të njeriut. Kjo do ta bëjë një mundësi reale transferimin e kujtimeve nga njerëzit te makinat. Këto simulime do të ndihmojnë gjithashtu që inteligjenca e përgjithshme artificiale të bëhet realitet.



SULMET KIBERNETIKE TË IRANIT

NATO në solidaritet të plotë me Shqipërinë

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, bisedë telefonike me Kryeministrin Edi Rama

Përshatë: Mimoza Golikja

Pas sulmeve kibernetike të Iranit, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka zhvilluar një bisedë telefonike me kryeministrin shqiptar, z. Edi Rama.

Ka qenë vetë Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, që ka bërë me dije lajmin, teksa thekson se NATO do të ofrojë mbështetje për Shqipërinë. Në një postim në "Twitter", Stoltenberg deklaroi se NATO do të vazhdojë të ofrojë mbështetje dhe qëndron në solidaritet të plotë me Shqipërinë.

"Bisedova me kryeministrin Edi Rama, lidhur me sulmet kibernetike kundër Aleatit tonë në Shqipëri, të cilat shumë aleatë ia kanë atribuar Iranit. NATO do të vazhdojë të ofrojë mbështetje dhe qëndron në solidaritet të plotë me Shqipërinë", - deklaroi Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s.

Kujtojmë se Shqipëria, më 15 korrik, u bë objekt i një sulmi të rëndë kibernetik, i cili kishte si objektiv shkatërrimin e infrastrukturës digjitale të qeverisë

së Republikës së Shqipërisë, paralizimin e shërbimeve publike, si edhe grabitjen e të dhënave dhe të komunikimeve elektronike nga sistemet qeveritare. Sulme u kryen edhe gjatë javës së shkuar në sistemin TIMS.

Kryeministri Edi Rama deklaroi një javë më parë se sulmet kanë ardhur nga Irani, ndërsa njoftoi ndërprerjen e menjëhershme të marrëdhënieve diplomatike me Republikën Islamike të Iranit, duke i kërkuar edhe ambasadës së Republikës Islamike të Iranit në vendin tonë, largimin brenda 24 orëve nga territori i Republikës së Shqipërisë të të gjithë personelit diplomatik dhe tekniko-administrativ, përfshirë edhe personelin e sigurisë.

NATO reagoi përmes një deklaratë zyrtare, pas vendimit të qeverisë shqiptare për të ndërprerë marrëdhëniet me Iranin, vendim që pasoi sulmin kibernetik ndaj institucioneve publike në vend. Në mbrojtje të Shqipërisë ka dalë edhe SHBA, e cila ka bashkëpunuar në kthimin normalitet të sistemeve, madje edhe ka sanksionuar edhe shtetas iranianë, me argumentin se kanë cenuar sigurinë e Amerikës dhe aleatëve të saj.

Deklaratë e Këshillit të Atlantikut të Veriut lidhur me aktivitetet keqdashëse kibernetike kundër Shqipërisë

1. Ne qëndrojmë në solidaritet me Shqipërinë pas sulmit të fundit kibernetik në infrastrukturën e saj kombëtare të informacionit. Aleatët pranojnë deklaratat e Shqipërisë dhe aleatëve të tjerë që ia atribuojnë përgjegjësinë për sulmin kibernetik Qeverisë së Iranit. Ne dënojmë fuqishëm aktivitetet të tilla keqdashëse kibernetike të krijuara për të destabilizuar dhe dëmtuar sigurinë e një aleati dhe për të prishur jetën e përditshme të qytetarëve. NATO dhe aleatët mbështesin Shqipërinë në forcimin e aftësive të saj të mbrojtjes kibernetike për të përballuar dhe zbrapsur aktivitetet të tilla keqdashëse kibernetike në të ardhmen.

2. Aktorët keqdashës kërkojnë të degradojnë infrastrukturën tonë kritike, të ndërhyjnë në shërbimet tona qeveritare, të nxjerrin inteligjencë, të vjedhin pronën intelektuale dhe të pengojnë aktivitetet tona ushtarake. Aleatët janë të përkushtuar të mbrojnë

infrastrukturën e tyre kritike, të krijojnë elasticitet dhe të forcojnë mbrojtjen e tyre kibernetike. Ne do të vazhdojmë të rrisim mbrojtjen tonë kundër aktiviteteve të tilla keqdashëse kibernetike në të ardhmen dhe të mbështesim njëri-tjetrin për të penguar, mbrojtur dhe kundërshtuar spektrin e plotë të kërcënimeve kibernetike, duke përfshirë marrjen në konsideratë të përgjigjeve të mundshme kolektive.

3. Ne promovojmë një hapësirë kibernetike të lirë, të hapur, paqë-

sore dhe të sigurt. Ne ndjekim përpjekjet për të rritur stabilitetin dhe për të zvogëluar rreziqet e konfliktit duke promovuar respektimin e ligjit ndërkombëtar dhe normave vullnetare të sjelljes së përgjegjshme të shtetit në hapësirën kibernetike, siç njihen nga të gjithë anëtarët e Kombeve të Bashkuara. Ne u bëjmë thirrje të gjitha shteteve të respektojnë angazhimet e tyre ndërkombëtare për të mbështetur një qasje të bazuar në norma ndaj hapësirës kibernetike.



NATO dhe aleatët mbështesin Shqipërinë në forcimin e aftësive të saj të mbrojtjes kibernetike për të përballuar dhe zbrapsur aktivitetet të tilla keqdashëse kibernetike në të ardhmen.



Global Gateway: Presidentja von der Leyen shpall financimin për të drejtat e grave dhe të rinjve, sigurinë ushqimore, luftën kundër sëmundjeve dhe biodiversitetin

Presidentja e Komisionit European, Ursula von der Leyen, ka përfunduar një javë intensive diskutimesh me liderët botërorë dhe partnerët ndërkombëtarë në Asambleshën e Përgjithshme të OKB-së në Nju Jork me një sërë premtimesh për të trajtuar krizën aktuale ushqimore, të rënduar nga lufta e Rusisë kundër Ukrainës, kriza urgjente e klimës dhe natyrës dhe për të përmirësuar shëndetin global. Duke folur në Festivalin "Global Citizen" në Nju Jork, presidentja von der Leyen ka përsëritur angazhimin e BE-së për të ndihmuar partnerët tanë më të cenueshëm të merren me pasojat sociale dhe ekonomike të veprimeve të paligjshme të Rusisë dhe të nxisin investimet e qëndrueshme sipas strategjisë "Global Gateway" të BE-së.

Presidenti von der Leyen premtoi 715 milionë euro për Fondin Global për të luftuar SIDA-n, tuberkulozin dhe malarin, gjë që sjell kontributin e përgjithshëm të Ekipit të Europës (BE dhe Shtetet Anëtare) në më shumë se 4.3 miliardë euro. Ajo njoftoi gjithashtu ndarjen e 600 milionë eurove në fonde shtesë për adresimin e krizës globale të sigurisë ushqimore në vendet partnere më të cenueshme në Afrikë, Karaibe dhe Paqësor.

Për më tepër, Presidentja njoftoi një kontribut të ri prej 45 milionë eurosh gjatë gjashtë viteve, për të mbështetur shëndetin seksual dhe riprodhues dhe të drejtat e grave në mbarë botën.

Dhe ajo njoftoi se dyfishimi i financimit të Komisionit për bio-

diversitetin global do të rezultonte në 7 miliardë euro të investuara për të mbrojtur biodiversitetin në mbarë botën. Për më tepër, Presidenti njoftoi se Bashkimi European po përgatit partneritete pyjore me pesë vende: Ugandën, Zambian, Kongon, Mongolinë dhe Guajanën.

Presidentja von der Leyen tha: "Ekipi i Europës po i përgjigjet thirrjes së qytetarëve për të adresuar sigurinë ushqimore, për t'u kujdesur për shëndetin tonë dhe shëndetin e planetit tonë. Pasi bashkuam forcat për të luftuar pandeminë, tani duhet të bashkohemi për t'i dhënë fund sëmundjeve të tjera vdekjeprurëse, për të trajtuar varfërinë dhe për të sjellë barazi. Dhe Europa do të luajë gjithashtu rolin e saj në tranzicionin e gjelbër global. Përpara COP15 në dhjetor, ne po konfirmojmë një investim të paprecedentë në mbështetje të partnerëve tanë. Unë u bëj thirrje të gjithë donatorëve ndërkombëtarë që të përputhen me ambicien tonë për biodiversitetin."

Komisionerja për Partneritetet Ndërkombëtare Jutta Urpilainen tha: "Ne duhet të bashkohemi për të rivendosur Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm në rrugën e duhur. Siç u njoftua në Samitin e Transformimit të Arsimit këtë javë, BE-ja ka rritur ndjeshëm investimet e saj në arsim - përsheptuesi i përparimit në të gjitha SDG-të. Me këto njoftime të reja sot, ne i bëjmë thirrje komunitetit ndërkombëtar që të bashkohet me ne për të investuar më shumë, në mënyrë më të drejtë dhe më efikase në njerëz dhe planet."

Rritja e mbështetjes së BE-së për vendet më të cenueshme afrikane, të Karaibeve dhe të

Paqësorit të goditura nga kriza ushqimore

Komisioni European ka ridrejtuar 600 milionë euro nga Fondi i 10-të dhe i 11-të European i Zhvillimit për të financuar ndihmën e menjëhershme humanitare dhe për të mbështetur prodhimin e qëndrueshëm të ushqimit dhe qëndrueshmërinë e sistemeve ushqimore në vendet partnere më të cenueshme në Afrikë, Karaibe dhe Paqësor. Me këto fonde BE-ja do t'i ndihmojë partnerët e saj të përballen me pasojat e luftës së agresionit të Rusisë kundër Ukrainës, veçanërisht krizën e sigurisë ushqimore dhe tronditjen ekonomike të lidhur me të, duke forcuar autonominë e partnerëve. Nga 600 milionë euro shtesë, 160.5 milionë euro janë ndarë për Afrikën Perëndimore dhe Qendrore, 146 milionë euro për Afrikën Lindore, 76.5 milionë euro për Afrikën Jugore, 36.5 milionë euro për Karaibe dhe 10 milionë euro për Paqësorin.

Një shtesë prej 52.5 milionë eurosh do të fokusohet në financat dhe investimet e qëndrueshme për bujqësi të qëndrueshme dhe zinxhirët e vlerave agro-ushqimore në nivel kontinental dhe rajonal dhe 100 milionë euro të tjera do të ofrojnë mbështetje makroekonomike për vendet e Afrikës, Karaibeve dhe Paqësorit me të ardhura të ulëta, nëpërmjet një kontributi.

Kjo e sjell mbështetjen totale të BE-së për sigurinë globale të ushqimit dhe sistemet ushqimore në mbi 7.7 miliardë euro deri në vitin 2024. Së bashku me 600 milionë euro shtesë, kjo përfshin rreth 2.2 miliardë euro ndihmë të menjëhershme humanitare ushqimore për vendet më të cenueshme



dhe 5 miliardë euro do të investohen në sisteme të qëndrueshme ushqimore në periudhën afatmesme dhe afatgjatë.

Mbështetja e shëndetit dhe të drejtave seksuale dhe riprodhuese në mbarë botën

UNFPA është agjencia e OKB-së për shëndetin seksual dhe riprodhues, aktive në rreth 150 vende në mbarë botën. Misioni i saj është të krijojë një botë ku çdo shtatzëni është e dëshiruar, çdo lindje e fëmijës është e sigurt dhe potenciali i çdo të riu përmbushet.

Partneriteti i Furnizimeve i UNFPA-së mbështet vendet në forcimin e sistemeve të tyre shëndetësore për të ofruar shërbime në shëndetësinë seksuale dhe riprodhuese, duke përfshirë opsionet kontrceptive, për të gjithë personat e moshës riprodhuese. Programi është vendosur të mbulojë 54 vende me shkallë të lartë të vdekshmërisë memësore dhe nevoja të paplotësuara të planifikimit familjar.

Me kontributin shtesë prej 45 milionë eurosh nga Komisioni Europian, Partneriteti i Furnizimeve të UNFPA-së do të ndihmojë në shpëtimin dhe përmirësimin e jetëve duke ofruar kontrceptive moderne dhe ilaçe jetë-shpëtuese për shëndetin

e nënës për gratë dhe adoleshentët që kanë më shumë nevojë për to.

BE-ja mbetet fuqimisht e përkushtuar ndaj shëndetit dhe të drejtave seksuale dhe riprodhuese, si dhe të drejtave të grave, siç parashikohen në Konsensusin Europian për Zhvillimin dhe Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave në Marrëdhëniet e Jashtme.

Lufta kundër HIV, TB dhe malaries dhe për një shëndet më të mirë për të gjithë

Komisioni Europian njoftoi një premtim të ri rekord prej 715 milionë eurosh për Fondin Global për periudhën 2023-2025 në Konferencën e Shtatë të Rimbushjes së Fondit në Nju Jork. Bashkimi Europian dhe Shtetet Anëtare të tij janë një kontribuues i madh në Fondin Global, me premtime të kombinuara prej më shumë se 4.3 miliardë euro për periudhën 2023-2025 që dëshmojnë për angazhimin e fortë të "Team Europe" ndaj Fondit Global për të luftuar SIDA-n, tuberkulozin dhe malarinë.

Në vetëm 20 vjet, partneriteti i Fondit Global ka shpëtuar 50 milionë jetë dhe ka ulur numrin e vdekjeve nga të tre sëmundjet me më shumë se gjysmën. Megjithatë, vetëm malaria ende vret një fëmijë pothuajse çdo minutë.

Në 2023-2025, Fondi Global synon të shpëtojë edhe 20 milionë jetë të tjera, të shmangë më shumë se 450 milionë infeksione, të ulë shkallën e vdekjeve nga HIV, TB dhe malaria me 64% dhe të ndërtojë një botë më të shëndetshme, më të barabartë, duke përfshirë investimet në forcimin e sistemeve shëndetësore dhe rrjeteve të komunitetit.

Financimi global për biodiversitetin

Njoftimi i Presidentes për një investim prej 7 miliardë eurosh në mbrojtjen e biodiversitetit në mbarë botën është një vazhdim konkret i angazhimit që ajo bëri vitin e kaluar për të dyfishuar financimin e biodiversitetit për 2021-2027, veçanërisht për vendet më të cenueshme. Njoftimi i sotëm vjen në një moment kritik përpara Konferencës së OKB-së për Biodiversitetin e dhjetorit në Montreal që do të miratojë një Projekt të Biodiversitetit Global.

Bashkimi Europian dhe Shtetet Anëtare kanë filluar ta përmbushin këtë angazhim në terren. Për shembull, me nismën "NaturAfrica", BE-ja mbështet vendet partnere në Afrikë për të kombinuar ruajtjen e natyrës me zhvillimin socio-ekonomik. Kontributi i BE-së në Iniciativën e Murit të Madh të Gjëlbrë të udhëhequr nga Bashkimi Afrikan është një shembull tjetër i mbështetjes për një mozaik të peizazheve të gjëlbra dhe produktive në të gjithë vendet Sahelian dhe Briri i Afrikës, nga Senegali në Xhibuti dhe Somali. Nëpërmjet projektit të rigjenerimit të Afrikës, BE-ja po mbështet restaurimin e tokës në një milion hektarë, duke përfituar 500 000 familje në Mali, Niger, Senegal, Gana, Etiopi, Kenia, Somali dhe Ruandë.

Komisioni gjithashtu po jep dhe duhet të nënshkruajë Partneritetet e tij të para Pyjore këtë vit për të mbështetur vendet partnere për të menaxhuar, mbrojtur dhe restauruar në mënyrë të qëndrueshme pyjet e tyre për përfitimet e popullatës së tyre dhe zhvillimin afatgjatë.

ALI KASTRATI, sportisti universal, *krenari kombëtare*

L

egjenda e ringut shqiptar, Ali Kastrati, do të mbledhte në 100-vjetorin e lindjes së tij, në auditoriumin e Ministrisë së Mbrojtjes, emrat elitë të sportit shqiptar, të cilët sollën në vëmendjen e brezave të rinj mjeshterin e madh të shumë disiplinave sportive, trajnerin, profesorin, i cili punoi me vrull djaloshtar deri në fund të jetës.

Ali Kastrati, me ngrohtësinë, kujdesin apo këshillat e tij, shpesh nga sportistët thirrej dhe 'baba Aliu'. Kështu do të flisnin në këtë 'ditëlindje' të tij, miq, kolegë dhe nxënës të tij.

Vështirë të gjendet një tjetër sportist a trajner, që të mbajë në gjoksin e tij më shumë trofe të fituara, se Ali Kastrati.

Ali Kastrati, fitues i titullit kampion në boks në vitet 1947, 1948, 1950, 1951.

Në mundje është shpallur pesë herë kampion kombëtar.

Nga 20 takime ndërkombëtare që ka zhvilluar, ka fituar shtatëmbëdhjetë ndeshje, barazuar një dhe humbur dy të tilla.

Në boks, ekipi i "Partizanit" i drejtuar prej tij, është shpallur pesëmbëdhjetë vjet kampion (1947 – 1953, 1956 – 1963).

Në mundje, ekipi i tij është shpallur tetëmbëdhjetë herë kampion.

Në peshëngritje, dymbëdhjetë rekorde dhe ekipi i tij i "Partizanit" ka fituar titullin kampion tetëmbëdhjetë herë radhazi, nga vitet 1949 – 1966.


Ekipet e drejtuara prej tij kanë fituar plot gjashtëdhjetë e pesë tituj kampion kombëtar dhe të gjitha kupat e Republikës që zhvilloheshin atëherë. Ai ka qenë për një kohë shumë të gjatë edhe trajner i ekipit tonë kombëtar. Asnjëherë sportistët që ai ka drejtuar, nuk kanë fyer kundërshtarin, nuk kanë reaguar ndaj arbitrave apo ndaj publikut me fjalë apo gjeste të papëlqyera. Në ato vite, baza materiale mund të ishte e mangët, por Aliu i gjente mënyrat që ta plotësonte atë dhe ta bënte sa më të efektshme.

Në emër të Shoqatës të Veteranëve të Boksit Shqiptar, Shoqatës Kombëtare të Mundjes, të Federatave shqiptare të sporteve boks, mundje, peshëngritje e



futboll si dhe të shoqatave të ushtarakëve në rezervë dhe Skënderbegasve, përshëndeti z. Et'hem Ibrahim, i cili ndër të tjera tha: "Jemi mbledhur sot për të përkujtuar një nga mjeshtrit e mëdhenj të sportit shqiptar, një sportist e trajner që njëherazi, si rrallë në historinë e sportit, ka drejtuar tre disiplina në klubin legjendar "Partizani" si dhe ekipe kombëtare të këtyre sporteve.

Ali Kastrati ka qenë dhe do të mbetet një figurë e



Ali Kastrati në verën e vitit 1944, gjatë stërvitjes, para se të dalë në ring me boksierin gjerman Hufs Jan kampion i Gjermanisë

lantë atdhetare, humanitare dhe një personalitet i shquar i sportit Shqiptar.

Si një veteran i Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare pas përfundimit të saj për kontributin e dhënë, ai mori statusin e veteranit të LANC-it dhe së bashku me shumë shokë të tjerë që ushtroheshin me sport qëndruan në ushtri ku luajtën një rol parësor në zhvillimin e sportit në Shqipërinë e atyre viteve.

Ali Kastrati është një nga themeluesit e KS Partizani. Mes të tjerash zoti Et'hem falënderoi për bashkëpunimin e frytshëm në realizimin e këtij aktiviteti Ministrinë e Mbrojtjes dhe QKMBMFA".

"Ali Kastrati është një nga pionieret e sportit shqiptar, babai i sporteve të rënda. Duke qenë nismëtar i këtyre sporteve fillimisht në ushtri dhe duke e shtrirë atë në të gjithë vendin. Nga shtanga, tapeti apo ringu, ai largohej vetëm kur bindej se objektivat ishin realizuar tërësisht. Dhe sikur të mos mjaftonin të gjitha këto, Ali Kastratin, shumëkush e nje dhe për mjek – masazhator të ekipeve tona në lloje të ndryshme sporti. Të gjithë e mbajnë mend mirë sesi në moshë të thyer ai vraponte duke sfiduar

haptazi moshën e tij, për t'u ardhur në ndihmë sportistëve të dëmtuar në ndeshjet e ndryshme.

Është vështirë të gesh një të dytë me arritjet dhe përkushtimin e tij në të tre disiplinat e sporteve të rënda si Ali Kastrati", - do vijonte në kujtimet e tij Bashkim Mërtiri, sekretar i Veteranëve të Boksit shqiptar.


Bejkush Birçe do të shprehej: "...mjaft të shikosh çfarë medaljesh zbukurojnë gjoksin e Ali Kastratit dhe ke kuptuar punën e palodhur 70-vjeçare të Mjeshtrit të madh.

Ka drejtuar tre disiplina të ndryshme sportive dhe tek të treja ka nxjerrë vetëm kampionë, Aliu ecte me moton "nuk ka pushim në sport".

Në vitin 2003 ai u nderua nga Presidenti i Republikës me titullin "Mjeshtër i Madh".

Në emër të familjes Kastrati, përshëndeti mbesa e tij, e cila mes lotësh falënderoi miqtë, shokët, bashkudhëtarët e tij, për emocionet e ditës së lindjes të mjeshtrit të madh.

Për këto asete, vlerë e krenarisë shqiptare, do të festohen veç ditëlindje, sepse pesha e historisë së tyre i ngre në piedestale, referencë për brezat e rinj.



Në ring me boksierin bullgar Vladimir Kristof, 1947

Pak aromë SHQIPËRIE

DOKE E ZAKONE SHQIPTARE

Në Shqipëri njihen dy grupime të mëdha etnografike, të konsoliduar që nga mesi i shek. XVIII, që janë: Gegëria në veri të lumit Shkumbin dhe Toskëria në jug të tij. Gegëria përbëhet nga Gegëria e mirëfilltë, Dukagjini apo Leknia, Malësia dhe Fushat Bregdetare të Veriut, kurse në Toskëri bënin pjesë: Toskëria e mirëfilltë, Myzeqeja, Labëria e Çamëria. Natyrisht, përbrenda këtyre krahinave etnografike ekzistonin edhe ndarje të tjera më të vogla.

Mënyra e jetesës në fshat – Doke e zakone

Vendbanimet në Shqipëri, qysh në mesjetë, kishin arritur një stabilitet dhe kishin kufij të përcaktuar mirë, që ndanin një fshat nga të tjerët. Kufijtë shënoheshin me gurë të mëdhenj të ngulur në tokë, me grumbuj plisash, me rrjedhën e përrenjve e të lumenjve, me shenja në trungjet e drurëve, atje ku kishte pyll, etj. Lëvizja e këtyre shenjave konsiderohej një faj shumë i rëndë. Çdo fshatar i njihnte mirë kufijtë e fshatit të vet dhe mund t'i tregonte me lehtësi, duke përmendur toponimet përkatëse.

Përbrenda kufijve të fshatit, përfshiheshin trojet e banesave e përfaqësitë e tyre oborret e kopshtet, pastaj vinin arat ose tokat e punuara dhe më tej kullotat pjesa e malit dhe pyllit, që i përkiste fshatit. Kjo ndarje e territoreve të fshatit, në shumë zona të Shqipërisë, ruhej ende mjaft mirë deri në vitet e Luftës së Parë Botërore, sidomos atje ku mbizotëronte fshatarësia e lirë. Pronë plotësisht private, mbi të

cilën fshatari dispononte gjithçka ishin trojet e banesave dhe kopshtet. Pasi mbledhej prodhimi bujqësor, tokat liroheshin dhe kushdo mund të lëshonte bagëtinë për t'i kullotur, të tjera toka që shfrytëzoheshin së bashku, pra fshatçe, ishin toka djerrë, kullotat e mali dhe sidomos burimet ujore për vaditjen e tokave të mbjella, që bëhej sipas një radhe rreptësisht të caktuar për çdo familje.

Vendbanimet fshatare, në përgjithësi, i janë përshtatur klimës dhe relievit ku janë vendosur. Fshatrat më të ulëta janë ato të Fushave Bregdetare, kurse fshatrat më të larta arrijnë deri në 1400 metra mbi nivelin e detit dhe ndodhen në rrethin e Korçës e atë të Kukësit. Banesat e një fshati mund të ishin të grumbulluara ose të shpërndara, madje në disa zona edhe shumë të shpërndara. Sidoqoftë, fshati kishte një qendër shoqërore, rreth së cilës gravitonte aktiviteti i njerëzve në kohën jashtë punës dhe kjo mund të ishte një shesh i vogël pranë një rripi a një lisi shekullor, dyqanet ose oborri i ndërtesave të kulleve fetare (kisha a xhamie). Në gjysmën e dytë të shek. XX, në shumicën e fshatrave, fondi i banesave pothuaj u përtëri, duke ndryshuar tipet e banesave tradicionale të mëparshme. U bënë edhe shumë ndërtime social-kulturale, si shkolla e kopshte fëmijësh, shtëpi e vatra kulture, njësi tregtare, etj.

Nga përlogaritjet e historianëve ka dalë se, në shek. XV, në Shqipëri, mesatarja e shtëpive për çdo fshat, ishte 21; mesataren më të lartë e kishte rrethi i Elbasanit, me 38 shtëpi, i ndjekur nga rrethi i Korçës,

me 28 shtëpi për fshat. Deri në çerekun e parë të shek. XX, rreth 80% e popullsisë punonte e jetonte në fshatra, shumica e të cilave kishin nga 20 shtëpi afërsisht, dhe 3% e fshatrave kishin mbi 1000 banorë. Në 50-60 vitet e fundit, përqindja e popullsisë fshatare ndaj popullsisë së përgjithshme, ra në 64%, megjithëse qeveria e kohës synonte që fshati të mos braktisej. Pra, mund të pohojmë, se pësha e kulturës fshatare ndaj asaj qytetare, është ende e ndjeshme.

Gjatë shek. XX e sidomos pas Luftës së Parë Botërore, mënyra e jetesës në fshatin shqiptar pësoi ndryshime të rëndësishme. E megjithatë, në jetën familjare, si edhe në jetën shoqërore, vazhduan të ruhen festa popullore me forma të ndryshme argëtimi dhe në ndërgjegjen e njerëzve u ruajtën shumë pasuri shpirtërore, të manifestuara në folklorin gojor e muzikor të krahinave të ndryshme, sidomos në epikën legjendare e atë historike, edhe pse hynin vazhdimisht shumë ide e shije të reja, me anë të mjeteve të reja të komunikimit masiv.

Në ambientin fshatar shqiptar, familja ka ende stabilitet të mirë dhe kohezion të bazuar në jetën ekonomike të saj. Për sa i përket strukturës së saj, mund të thuhet se ajo tashmë, është thjeshtuar mjaft. Në pjesën më të madhe të vendit, familja përbëhet nga çifti i të martuarve me fëmijët e tyre beqarë. Vajzat e martuara jetojnë në familjen e burrit. Djemtë e martuar, pak kohë pas martesë, veçohen nga familja e prindërve dhe jetojnë më vete, por në shumë raste, djali më i vogël mbetet



në shtëpinë e prindërve dhe jeton me ta. Kështu, mesatarja e frymëve për familje është 5-6 vetë, por ka fshatra, ku kjo mesatare është më e ulët. Megjithatë, në kujtesën e njerëzve të moshuar, ruhen raste familjesh të mëdha, ku vëllezërit e martuar e fëmijët e tyre jetonin së bashku. Në këto familje kishte detyrimisht një rregull strikte në ndarjen e punëve dhe të detyrave për të gjithë. Atje ruheshin më gjatë edhe doke e zakone të dikurshme të jetës familjare, praktika e rite pagane, etj.

Në ritet e besimet që kanë të bëjnë me ciklin e jetës, pra me lindjen, martesën e vdekjen, studiuesit që janë marrë me to, kanë mundur të hetojnë edhe rite të lashta, të cilat, sado të zbehta, jetojnë aty-këtu. Këto janë kryesisht rite për të ndjellë mbarësi për familjen e çiftuar e çiftet e reja, që të shtohen e të kenë sidomos trashëgimtarë meshkuj. Ndër zakonet e vdekjes, mund të shënojmë se deri në Luftën e Dytë Botërore, në disa krahina ruhej vajtimi me "ligje" (këngë mortore).

Mjaft rite e besime të tjera lidhen me data të caktuara të një kalendari të vjetër popullor dhe sipas studiuesve, kanë të bëjnë me kulte të hershme blegtorale e bujqësore. P.sh.

Dita e verës apo 1 Marsi, shënohej nga një pastrim i përgjithshëm ritual i banesave dhe i oborreve dhe më në fund, jo vetëm u vihej zjarri plehrave të mbledhura gjatë këtij pastrimi, por në atë zjarr hidheshin edhe vetë fshesat e vjetra, për të filluar stinën e re me fshesat e reja, pra është fjala për një rit purifikator. Dikur, në fshatra, Dita e Verës pritej me shumë gëzim, sidomos nga fëmijët. Dita e Shën Gjergjit (23 Prill), ishte gjithashtu një festë e shoqëruar me rite e praktika zbavitëse. Atmosferë gëzimi e hareje në fshat krijonin edhe zjarret e mëdhenj, që ndizeshin nëpër oborre e në kryqëzime të rrugëve më 22 Qershor, Ditën e Shën Gjonit. Rite shumë interesante shoqëronin dikur nëpër malësi festën e "buzmit" në natën e solsticit të dimrit.

Shumë festa lidheshin me javën bujqësore e blegtorale, si ishin përfundimi i korrjeve, qethja e dhenve, kthimi i barinjve nga kullotat verore, etj.

Mite e besime popullore

Një aspekt me interes i kulturës popullore shqiptare kanë qenë padyshim, mitet, supersticionet e besimet fetare. Dihet historikisht, se feja e krishterë filloi të përhapej ilegalisht në Iliri, që në shekullin e parë të erës sonë. Ungjillëzimin e saj e filloi Shën

Pali dhe e përfunduan misionarët latinë. Kjo shpjegon faktin, se përse në gjuhën shqipe, terminologjia fetare e krishterë është e burimit latin, si në Veri e në Jug. Me përhapjen e myslimanizmit, e sidomos nga shek. XVII e këtej, lindën disa fenomene të veçanta, si kriptokristianizmi në disa fshatra në rrethin e Elbasanit (në krahinën e Shpatit), që vazhdoi deri në Shpalljen e Pavarësisë më 1912. Por në shek. XIX, edhe në disa zona të Shqipërisë Veriore (p.sh. në Lurë), kishte familje të përziera në pikëpamje fetare: disa pjesërisht katolikë e disa të tjerë myslimanë. Nga Lufta e Parë Botërore ka ardhur duke u rritur edhe numri i atyre, që nuk i ndjekin rregullisht praktikat fetare. Në këtë kuadër historik, nuk është e vështirë të kuptohet, se si u bë e mundur që të ruhej deri në shekullin tonë një përzierje e traditave të lashta pagane, me elementë të krishterimit e të myslimanizmit.

Ndër mitet më të lashta të ruajtura aty-këtu deri në fillim të shek. XX, ishte sigurisht kulti i diellit, i cili ka lidhje me kultin e zjarrit e të vatrës (sepse vetë dielli është burim drite e ngrohtësie), si edhe me kultet bujqësore e blegtorale (sepse jeta e çdo gjallesë në tokë

varet nga dielli). Ruhej gjithashtu, nderimi për disa maja malesh, që adhuroheshin, si "maja të diellit". Kështu, në data të caktuara, bëheshin pelegrinazhe në disa maja malesh, si Maja e Rumies, Gjalica e Lumës, Çuka e Tomorit, Këndravica, etj. Në këto festa ndizeshin zjarre të mëdhenj në pritje të lindjes së diellit dhe besohej se ata ia shtonin fuqinë diellit. Le të kujtojmë këtu, se mallkimi më i fortë që ndeshim në epikën legjendare për kundërshtarin e heroit, është: "T'u shkimit hisja e diellit".

Në shumë vise shqiptare ka pasur gjurmë të një "kulti të gjarprit", veçanërisht, për gjarprin e bollës së shtëpisë, që konsiderohej si një hyjni mbrojtëse. "Kulti i gjarprit" ka qenë shumë i njohur edhe tek Ilirët e lashtësisë e sidomos tek dalmatët. Në malësitë tona, dikur mendohej se çdo shtëpi e kishte gjarprin e vet mbrojtës. Në epikën legjendare flitet edhe për figura të tjera mitologjike mbrojtëse të njeriut, si ishin orët dhe zanat a shtojzvallet. Ora mund të merrte në mbrojtje personin, familjen, por edhe gjithë fisin. Zanat ishin gra të bukura, por edhe trime e luftëtare. Besohej, se ato banonin në shpella mes pyjesh, pushonin në mrize, pranë burimeve ose në maja malesh. Studuesit e mitologjisë mendojnë, se zana ka lidhje me një perëndi ilire të pyjeve e të burimeve që, në interpretimin romak mori emrin Diana.

Dragoi përfytyrohej si një qenie e mbinatyreshme, me fuqi të jashtëzakonshme. Bëma e tij kryesore ishte të lironte ujërat, që i kishte zënë kuçedra. Besohej, se dragonjtë luftonin sidomos në kohë furtunash të mëdha, duke përdorur topuzët, heshtat, shigjetat, gurët me brima, por sidomos parmendat e zgjedhat.

Ata mund të shkulinin edhe drurë të mëdhenj e gurë të malit.

Kuçedra, përfytyrohej si një qenie mitologjike, që mishëronte forcat e verbra shkatërruese të natyrës. Thuhej, se ajo ishte si një gjarpër i madh me 3, 7, 9 ose 12 koka, që mund të villnin zjarr. Zinte vend pranë burimeve, ndalonte ujin dhe i linte njerëzit të vuanin.

Ka pasur padyshim edhe figura të tjera interesante në mitologjinë shqiptare, që nuk mund të arrijmë t'i përmendim këtu, ashtu si ka pasur

edhe supersticione mbi magjitë, syrin e keq, parashikimin e së ardhmes, etj.

Arti fshatar e zejtaritë artistike

Zhvillimi i artit fshatar dhe i zejtarive artistike në tre-katër shekujt e fundit në Shqipëri, ka qenë i lidhur ngushtë me kushtet historike e shoqërore të vendit, si ishin pushtimi i gjatë osman me pasoja të rënda në plan fetar e kulturor, shtypja kombëtare e shoqërore e ushtruar gjatë këtij sundimi të huaj, etj. Këto kushte të vështira penguan lulëzimin e artit në shumë fusha, si në arkitekturën monumentale, në skulpturë, etj., dhe e ndrydhën për një kohë artin vendas në sfera më të kufizuara si janë artet minore. Në pamundësi për të trajtuar të gjitha fushat e arteve të aplikuara popullore, më poshtë, po flasim shkurtimisht vetëm për disa prej tyre.

Në fshatin shqiptar, tradita e punimit dhe e zbukurimit të objekteve të vogla prej druri nga vetë fshatarët për nevoja të jetës së përditshme, aty-këtu, u ruajt e gjallë edhe në gjysmën e parë të shekullit XX. Kështu, barinjët zbukuronin kërrabat, furka, boshte, etj. Ndërsa të tjerë fshatarë më të stërvitur, punonin karrige me forma tradicionale, si ishin ato të Dukagjinit, të Pukës, të Mirditës, etj., apo djepa për fëmijë, vegla muzikore e sidomos arka për pajë.

Në disa krahina të vendit, punimi i drurit kishte arritur të ngrihej në zejtaritë artistike.

Nga shekujt XIII-XIX, kemi ekzemplarë gdhendjesh në dru, që tërheqin edhe sot admirimin tonë, si interiore ndërtesash kulturi, interiore banesash fshatare e qytetare, etj. Një nga ekzemplarët më të përkryer është padyshim ikonostasi i kishës ortodokse të fshatit Leusë të Përmetit, i punuar në fund të shekullit XVIII. Atje, sfondi vegjetal është mbizotëruar, por me degët e gjethet e shumta, ndërthuren edhe figura kafshësh reale e fantastike, zogj e simbole të ndryshme kristiane.

Punime të shquara në dru gjenden edhe në interiore banesash, kryesisht tavane, dollapë muri. kapakë dritaresh, trapazanë, në qytete si Gjirokastra, Berati, Elbasani, Shkodra, Prizreni, etj.

Traditën e punimit të argjendit e gjejmë në lulëzim të plotë në shekujt XVII-XVIII. Edhe sot, ruhen veçanërisht në koleksione muzeore, objekte argjendi me mbishkrime të datuara e me prejardhje

nga qendra të ndryshme qytetare të vendit, si Shkodra, Elbasani, Berati, Voskopoja, etj. Ato janë shumë herë të cilësisë të lartë artistike, qofshin kulturi, si kryqe, potirë, kapakë ungjijsh, etj., qofshin objekte laike, si stoli trupi, pajisje shtëpiake, etj.

Mjeshtrit e talentuar argjendarë të qyteteve, gjatë shekujve XVIII-XIX, kanë punuar për të veshur me pafta argjendi një numër shumë të madh pushkësh të gjata, koburesh, jataganësh, vezmesh, që konsiderohehin si pajisje të nevojshme të çdo burri, nga të cilat, një numër i mirë ruhet ende nëpër muzetë e vendit. Madje, ka shumë prej tyre, që janë edhe të lara me ar.

Midis të gjitha objekteve prej argjendi të ekzekutuara me teknika të ndryshme (me të rrahur, me të derdhur, etj.), finesë të veçantë paraqesin punimet me filigran, që ishin më fort një specialitet i mjeshtërive argjendarë të qyteteve të veriut se sa i atyre të jugut.

Gratë fshatare në Shqipëri, prej shekujsh janë marrë me endjen e pëlhurave të ndryshme, që shërbenin qoftë si pjesë veshjeje, qoftë si pajisje shtëpiake (dyshekë, peshqirë, shtroje, mbulesa, peceta duarsh, mësalla tryeze, etj.).

Në Shqipëri, pëlhurat e mëndafshata janë punuar e përdorur më shumë se në vende të tjera të Ballkanit, ndoshta sepse edhe klima e favorizonte rritjen e krimbit të mëndafshit, meqenëse në disa zona ishte mjaft i përhapur mani i bardhë.

Tekstilet e leshta, të ekzekutuara me një varg teknikash të ndryshme pune, përdorehin gjerësisht dhe ruanin shumë karakteristika lokale, që i bënin punimet e një krahine të dalloheshin nga ato të krahinave të tjera.

Të tjera punëdore me interes, ishin thurjet e ndryshme me shtiza, ojat e dantellat e sidomos qëndisjet e shumëllojshme, që nga qëndisjet e thjeshta fshatare deri tek qëndisjet e mahnitshme e virtuoze me fije mëndafshi ose ari të mjeshtërive qëndistarë të disa qyteteve, dhe më herët, edhe pranë manastireve të kohës. Midis punëve të tyre, kemi edhe ekzemplarë të rrallë, si është rasti i Epitafit të madh të Glavenicës (pranë Beratit), që mban datën 1373, si dhe të tjera qëndisje laike e fetare me interes të veçantë.



(NË KUADRIN E 80-VJETORIT TË MBAJTJES SË SAJ)

Rëndësia madhore DHE HISTORIKE E Konferencës së Pezës

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ,
(MJESHTËR I MADH)

Konferenca e Pezës në çështjen kombëtare

Konferenca e Pezës e mbajtur më 16 shtator 1942 është ngjarja më madhore e LANÇ-it, për të cilën është shkruar e do të shkruhet në shekuj. Vlera e kësaj konference qëndron në rëndësinë e vendimeve që mori për zhvillimin e luftës në Shqipëri. Detyra e çdo

shqiptari është që kjo ngjarje madhore të nderohet e të përkujtohet në përjetësi. Konferenca e Pezës sjell dhe sot një përvojë të çmuar dhe të vlefshme për shoqërinë shqiptare. Mesazhi dhe mësimi i madh i Konferencës së Pezës qëndron gjithmonë aktual që është dialogu, mirëkuptimi dhe bashkëpunimi mes shqiptarëve e forcave politike. Këto pavarësisht nga bindjet, alternativat e orientimet ideologjike, gjithmonë i bashkon një çështje e madhe e përbashkët, çështja kombëtare, përparimi dhe zhvillimi

i kombit. Konferenca e Pezës gjithmonë përbën një objekt me rëndësi studimi e hulumtimi për historinë tonë shekullore. Në vitet e demokracisë ku mendimi i lirë pluralist, ka përparësi, opinioni publik ka lexuar shkrime me vlerësim të ndryshme për Konferencën e Pezës dhe protagonistët e saj. Koha kërkon që kësaj ngjarje të madhe historike dhe aktorëve që e inicuan, t'u bëhet vlerësimi i duhur dhe i merituar.

Rëndësia e Konferencës së Pezës qëndron në rolin që luajti në ecurinë e procesit e zhvillimit të luftës në vendin tonë, por dhe e lidhur dhe me popujt e tjerë që përkonin përparim dhe çlirim nga pushtuesit nazifashistë. Vendimi për thirrjen e Konferencës, kur situata ishte e rëndë, e vështirë, e mbushur me rreziqe të mëdha, për ekzistencën si popull e si komb, por patriotët, atdhetarët, komunistët ia dolën që të mbanin një mbledhje historike shumë pranë kryeqytetit që e kishte pushtuar fashizmi. Shoqëria shqiptare gjendej në udhëkryq, ndaj kërkohej reflektim i thellë, i shpejtë, mobilizim e angazhim i përgjithshëm i forcave patriotike në vend, për të marrë në dorë fatet e atdheut që vuante nga pushtimi fashist. Shpëtimi dhe çlirimi i vendit do të vinte nga populli, që priste të organizohej e të mobilizohej për luftë. Konceptimi i situatës, ndjenja e përgjegjësisë, preokupimi për zgjidhjen e problemeve të popullit shqiptar, bënë që pas një pune përgatitore, të arrihej marrëveshja midis forcave dhe rrymave të ndryshme që ekzistonin në vend, në thirrjen e Konferencës së Parë Kombëtare Nacionalçlirimtare. Një mbledhje e tillë nuk ishte e lehtë, por preokupacioni e angazhimi i forcave pjesëmarrëse ishte në kohën dhe momentin historik që po kalonte vendi. Në procesin e përgatitjes së mbledhjes u kapërcyen hezitimet, ngurrimet e dyshimet për njeri-tjetrin. U arrit që në tryezën e bisedimeve të ulen njerëz me bindje, me prirje e me orientime të ndryshme ideologjike, për hir të interesave kombëtare. Konferenca siguroi një përfaqësim të gjerë, duke i dhënë të drejtën legjitime për të vepruar me përgjegjësi të lartë përpara historisë, për fatet e popullit që ishte ngritur në luftë për lirinë dhe pavarësinë e atdheut.

Organizimi i luftës së armatosur

Në shtypin e demokracisë shpesh është diskutuar se kush ishte iniciator dhe organizator i Konferencës, ishte ky fryt i preokupimit, i punës dhe i aktivizimit të disa njerëzve të veçantë, me autoritet, me njohje e lidhje të gjëra në rrethet nacionaliste; apo ishte produkt i një mendimi të përpunuar mirë nga një forcë politike e organizuar e serioze që kishte dhe vizion për gjendjen në vend e për rrugët e zgjidhjes. Dihet se e vetmja forcë politike e organizuar në vend në atë kohë ishte Partia Komuniste Shqiptare. Ajo mori përsipër dhe i takon edhe merita e organizimit të Konferencës dhe të dokumenteve të

saj. Në atë kohë Partia Komuniste Shqiptare kishte shpallur hapur qëndrimin ndaj pushtuesit dhe po organizonte masat e para në zhvillimin e luftës së armatosur duke filluar me njësinë bazë embrionale të luftës së armatosur që ishin njësitet guerile dhe deri diku edhe disa çeta partizane. Për organizimin e luftës kundër pushtuesit nuk ishin të interesuar vetëm komunistët. Shqetësim dhe gatishmëri kishin patriotë dhe atdhetarë të ndershëm, të orientimeve dhe besimeve të ndryshme fetare nga mbarë vendi. Kjo përputhje interesash jetike, ky preokupim i përbashkët i forcave atdhetare, krijoi premisat e duhura për kontakt e dialog midis tyre, produkt i të cilave ishte edhe vendimi për thirrjen e Konferencës së Parë Nacionalçlirimtare. Ka pasur dhe ka edhe sot mendime se Konferenca e Pezës ishte makinacion i Partisë Komuniste Shqiptare. Por Partia Komuniste Shqiptare nuk ishte si Partia Fashiste Shqiptare në shërbim të okupatorit. PKSH ishte dhe mbeti deri në fund për luftë të armatosur, e vendosur për të luftuar nazi-fashizmin dhe çlirimin e vendit. Në Pezë kjo forcë kërkoi bashkimin e të gjitha forcave politike të vendit, komunistë e antikomunistë, zogistë e antizogistë, për të rifituar me luftën e armatosur pavarësinë e atdheut dhe për pjesëmarrje të Shqipërisë në koalicionin e madh antifashist.

Në Konferencë me vullnetin e tyre dhe jo se i detyroi kush shkuan dhe nacionalistë. Vetëdija patriotike, ndjenja e përgjegjësisë për fatet e vendit ishte motivi që i nxiti dhe i shtyu ata drejt Pezës. Nacionalistët patriotë pjesëmarrës në Konferencë, ishin dy herë më shumë se komunistët. Për nga pjesëmarrja, Konferenca ishte kuvend i vërtetë pluralist, ku morën pjesë nacionalistë të të gjithë spektrit politik, të të gjitha rrymave kryesore të vendit. Kështu rrymat u përfaqësuan me krenëri e tyre: komunistët me Enver Hoxhën, Ymer Dishnicën, Mustafa Gjinishin, Koço Tashkon, Nako Spiron etj., dhe zogistët me Abaz Kupin e Muharrem Bajraktarin. Gjysma e pjesëmarrësve përfaqësonin rrymat e tjera nacionaliste, të lidhur ose jo deri në atë kohë me komunistët dhe me luftën çlirimtare, si Myslim Peza, Mustafa Xhani, Haxhi Lleshi, Qirjako Harito, D. Çela, Halim Begeja, Skënder Muço, R. Jarani, A. Cami, M. Juniku, Kamber Qafmolla, S. Jegeni. Në Konferencë u përfaqësua dhe gruaja shqiptare me Nexhmie Xhuglinin etj.

Nga kjo pjesëmarrje e gjerë e pluraliste, Konferenca kishte legjitimitetin e plotë për të vendosur për çështje që lidheshin me të ardhmen e vendit.

Vendimet dhe detyrat e Konferencës së Pezës

Vendimi kryesor i Konferencës ishte bashkimi i gjithë shqiptarëve, pavarësisht nga përkatësitë

shoqërore, nga dallimet fetare, nga origjina krahnore dhe nga bindjet politike, në një organizatë të përbashkët me emrin "Fronti Antifashist Nacionalçlirimtar". Referati kryesor që mbajti Enver Hoxha për Frontin Nacionalçlirimtar ishte dhe boshti qendror rreth të cilit u diskutua gjerësisht nga pjesëmarrësit. Ideja kryesore bazë që u shtrua ishte bashkimi i gjithë popullit shqiptar dhe organizimi i tij në luftë kundër pushtuesve. Kështu Fronti mori përsipër dhe u ngarkua me detyra të rëndësishme: të ngrinte popullin shqiptar në luftë kundër okupatorit për të rifituar pavarësinë e atdheut, të udhëhiqte këshillat nacionalçlirimtare që do të formoheshin si organe lufte në zonat e pushtuara dhe si organe pushteti në zonat e çliruara dhe të rreshtonte Shqipërinë dhe luftën e saj në koalicionin anglo-sovjeto-amerikan.

Nga shikimi i procesverbalit të Konferencës si dokumenti bazë, del se aty u hodhën për diskutim probleme të shumta. Por, dy ishin problemet e mëdha, në të cilat u ndal gjerësisht Konferenca: bashkim dhe luftë ose bashkim për luftë. Për nevojën e bashkimit e të organizimit të popullit në luftë, nuk pati kundërshtime parimore. Për këto qysh në fillim u arrit konsensusi e mirëkuptimi i duhur, që siguroi dhe suksesin e punimeve të Konferencës. Delegatët të gjithë u shprehën për bashkim. Në diskutimet e lira u sqarua çështja se si do të bëhej bashkimi. Bashkimi do të arrihej në luftë kundër pushtuesit dhe se do të bëhej pa dallim klase, krahnore, feje e ideje. Fronti i përbashkët kishte një qëllim të vetëm: të luftonte pushtuesin e huaj për çlirimin e vendit dhe për ndërtimin e një shoqërie të re, të lirë e demokratike. Fronti kishte për detyrë të përgatiste popullin për kryengritjen e përgjithshme të armatosur, e cila do të niste e zhvillohej nga njësitet guerile e më pas me çetat partizane. Nga kjo luftë do të dilte Shtabi i Përgjithshëm dhe do të krijoheshin Ushtria e rregullt Nacionalçlirimtare e popullit shqiptar.

Çështja e regjimit politik

Në Konferencë u trajtua dhe çështja e regjimit politik. Të gjithë delegatët u shprehën se regjimi i ri në Shqipëri duhet të ishte regjim demokratik. Në Konferencë u ngrit dhe çështja e Zogut, ku u arrit në përfundimin që kjo çështje duhet t'i lihej në dorë popullit për të vendosur sipas dëshirës dhe vullnetit të tij. Abaz Kupi, që përfaqësonte në Konferencë zogistët, deklaroi se "unë kërkoj Shqipërinë njëherë e jo Zogun. Në qoftë se populli e do, do ta vendosë". Në përfundim u arrit marrëveshja se karakteri demokratik i regjimit,


që kërkohej nga të gjithë delegatët, të shprehej në fjalët në luftë për "Shqipërinë e lirë, të pandashme, indipendente e demokratike". Ndërsa për formën e regjimit, këtë e vendoste populli pas luftës. Qeverisja e vendit gjatë luftës do të kryhej nëpërmjet këshillave nacionalçlirimtare, të cilat do të shërbenin njëkohësisht si organe të pushtetit të ri dhe si organe të bashkimit, të organizimit e të mobilizimit të popullit në luftë.

Konferenca diskutoi dhe çështjen e Kosovës, ku delegatët njëzëri u shprehën për zgjidhjen në bazë të vetëvendosjes së lirë, si e parashikonte Karta e Atlantikut dhe të drejtën e vetëvendosjes, kosovarët dhe shqiptarët e viseve të tjera do ta fitonin duke u hedhur në luftë kundër fashizmit. Lëvizja Nacionalçlirimtare e Shqipërisë nuk do të kursente ndihmën e saj, që në Kosovë të organizoheshin për luftë dhe të krijonin këshillat e tyre nacionalçlirimtare.

Vendimet e Konferencës, patën jehonë në zhvillimet politike në vend. Kështu u rritën me shpejtësi radhët e Frontit Nacionalçlirimtar me patriotë nga i gjithë vendi. U shtuan e u zgjeruan njësitë partizane me luftëtarë të rinj nga të gjitha krahnat. Zhvillimet pozitive patën ndikim dhe në arenën ndërkombëtare. Pas Konferencës së Pezës, në dhjetor 1942, Fuqitë e Mëdha Aleate (SHBA, BS dhe Anglia) njohën zyrtarisht luftën e popullit shqiptar dhe Shqipërinë si pjesëtare të Koalicionit Antifashist Botëror.

Përvojë mësimesh

Konferenca si ngjarja më e madhe e LANÇ-it sjell një përvojë mësimesh me vlerë në ditët tona. Te kjo ngjarje çdo shqiptar e çdo forcë politike gjen mësim për të kontribuar në zgjidhjen e halleve e të problemeve të shumta me të cilat ballafaqohet sot. Peza dhe e gjithë Shqipëria bën thirrje për të respektuar bindjet dhe përkatësitë politike, shoqërore e fetare, duke u ngritur mbi pasionet dhe interesat e vogla, siç u ngritën burra e gra të mençur 80 vjet më parë, për të zgjidhur së bashku hallet e problemet që ka sot vendi. Shqipërisë i duhet sot më shumë se kurrë mirëkuptimi, bashkëpunimi dhe bashkëqeverisja. Për intereset kombëtare duhet të lëmë mënjanë mosmarrëveshjet, grindjet dhe mëritë, çdo gjë që bie ndesh dhe dëmton luftën dhe përpjekjet për stabilitet e zhvillim. Ky mesazh vjen nga Konferenca historike e Pezës. Këtë duhet ta ndiejë si nevojë e si detyrë çdo shqiptar, çdo patriot e çdo forcë patriotike, pavarësisht nga pozicioni dhe orientimi ideologjik që ka. Shqipëria është e të gjithëve dhe të gjithë kanë përgjegjësinë dhe obligimin për ndërtimin dhe përparimin e saj.



Briken Calja, me një rezultat historik u shpall kampion bote në peshën deri 73 kg, në Kampionatin Botëror të Peshëngritjes, në Uzbekistan në vitin 2021. Peshëngritësi që përfaqëson Shqipërinë në mënyrën më dinjitoze është pjesë e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura që nga viti 2020.



Distria KRASNIQI, xhudistja e pamposhtur nga Kosova fitoi medaljen e artë në Lojërat Olimpike "Tokio 2020". E para në botë në kategorinë deri në 48 kilogramë me 5 920 pikë. Distria, është pjesë e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura që nga viti 2021.

Xhudistja Nora GJAKOVA, fitoi medaljen e artë olimpike në kategorinë deri në 57 kilogramë, duke rrëmbyer kështu medaljen e dytë të artë për Kosovën në Lojërat Olimpike "Tokio 2020". Nora është pjesë e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura që nga viti 2021.



Ilirjan SULI, është një nga peshëngritësit më të suksesshëm të vendit tonë. Me mbi 100 rekorde kombëtare, Iliriani është nënkampion bote në peshëngritje, ku në Europeanin e vitit 2000 i dhuroi Shqipërisë medalje bronzi. Është pjesë e Ministrisë së Mbrojtjes që nga viti 2021.

